



SHEMBUJ DETYRASH-PISA nga lexim-kuptimi (teste tëtivit laps-letër)

QENDRA SHETËRORE E PROVIMEVE

Qendra Shtetërore e Provimeve

Drejtore: Dr. Lidija Gjosevska

Redaktor: Dr. Beti Lameva

Redaktor grafik: Qebir Shemshi

SHEMBUJ DETYRASH-PISA nga lexim-kuptimi (teste të tipit laps-letër)

Detyrat në këtë publikim ishin shfrytëzuar në testime provë ose finale në cikle të ndryshme hulumtuese PISA nga viti 2000 deri në vitin 2012.

Falënderime të veçanta për Zyrën UNICEF në Shkup e cila përkrahu financiarisht përkthimin e detyrave.

PËRMBAJTJA

ÇFARË ËSHTË PISA?	5
SHEMBUJ DETYRASH	9
AMANDA DHE DUKESHA	11
MBISHKRIMET	15
LIQENI ÇAD.....	17
PERSONELI	20
DHURATA	22
ARMËT SHKENCORE TË POLICISË	27
SHFAQJA	29
PROGRAMI ACOL PËR VAKSINIMIN VULLNETAR KUNDËR GRIPIT.....	32
PLANI NDËRKOMBËTAR.....	35
FORCA E PUNËS.....	37
TË NDIHESH MIRË ME KËPUCËT E TUA TË SPORTIT	39
TELEKOMUNIKIMI	42
BALONA	44
NDËRTESAT MË TË LARTA.....	46
KOPRACI DHE FLORIRI	48
UDHËTIMI NË AFRIKË	50
GJIRI.....	53
PUNA NË DISTANCË.....	55
DEMOKRACIA NË ATHINË	57
DESTINACIONI BUENOS AIRES	60
NJOFTIM NË SUPERMARKET	62
MOTORI	64
SIGURIA E TELEFONAVE CELULAR	66
NJOFTIM PËR DHURIMIN E GJAKUT	69
BIBLIOTEKA	71
LARJA E DHËMBËVE.....	73
MORELANDI	75
GARANCIA.....	76
GJYKATËSI I DREJTË	79
ME SHIJE TË KEQE.....	83
DHUNA MES FËMIJËVE	84

BLETËT	86
RREGULLA TË REJA	88
MAKONDO	90
QËNDRIME TË NXËNËSVE	92
UDHËZUES PËR VLERËSIM	96
AMANDA DHE DUKESHA	98
MBISHKRIMET	102
LIQENI ÇAD.....	107
PERSONELI	109
DHURATA.....	110
SHFAQJA	117
PROGRAMI I FIRMËS ACOL PËR IMUNIZIM VULLNETAR KUNDËR GRIPIT	119
PLANI NDËRKOMBËTAR.....	123
FORCA E PUNËS.....	126
TË NDIHESH MIRË ME KËPUCËT E TUA TË SPORTIT	129
TELEKOMUNIKIMI	131
BALONA	133
NDËRTESAT MË TË LARTA.....	135
KOPRACI DHE FLORIRI	137
UDHËTIMI NË AFRIKË	139
GJIRI	141
DEMOKRACIA NË ATHINË	145
DESTINACIONI BUENOS AIRES	147
NJOFTIMI NË SUPERMARKET	150
MOTORI	154
SIGURIA E TELEFONAVE CELULAR	155
NJOFTIM PËR DHURIMIN E GJAKUT	157
BIBLIOTEKA	158
MORELANDI	164
GARANCIA.....	165
GJYKATËSI I DREJTË	167
ME SHIJE TË KEQE.....	170
DHUNA MES FËMIJËVE	171
BLETËT	172
RREGULLA TË REJA	174

MAKONDO	176
QËNDRIME TË NXËNËSVE	179

ÇFARË ËSHTË PISA?

PISA (Programme for International Student Assessment) është studim ndërkombëtar i cili i vlerëson aftësitë, dituritë dhe shkathtësitë e nxënësve në zbatimin e asaj që kanë mësuar në shkollë në situata nga jeta në mbarim të arsimit të detyrueshëm në moshë 15 vjeçare në tri fusha:

- kompetencë për lexim-kuptim – dhe qasje kritike në leximin e materialeve të shkruara;
- kompetencë matematikore – lexim, interpretim dhe zgjidhjen e problemit të dhënë me anë të organizimit dhe interpretimit të informacioneve të dhëna dhe përzgjedhjen e metodës për zgjidhje;
- kompetencë në shkencat natyrore – njohje e çështjeve shkencore, përdorimi i diturive shkencore, identifikim i përmbajtjes në studimet shkencore dhe ndërlidhje të të dhënave shkencore me dëshmi dhe përfundime.

PISA është program ciklik i vazhdueshëm i cili jep pasqyrë në politikat dhe praktikat arsimore dhe ndihmon në ndjekjen e prirjeve (trendeve) në fitimin e diturive dhe shkathtësive tek nxënësit në të njëjtën moshë në vende të ndryshme dhe nëngrupe të ndryshme demografike në secilin shtet.

Përmes studimit PISA nxënësit duhet të përgjigjen në dy pyetje:

- Çfarë di?
- Çfarë mund të bëj me diturinë time?

Ky vlerësim nuk konfirmon vetëm se a mund ta riprodhojnë nxënësit diturinë e tyre, por studion dhe sa mirë dinë ta shfrytëzojnë diturinë e tyre nga ajo që kanë mësuar dhe sa mund të zbatojnë atë dituri në situata të panjohura, në shkollë dhe jashtë saj.

Programi për vlerësimin ndërkombëtar të nxënësve – PISA është i organizuar nga ana e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD – Organization for Economic Co-operation and Development). Ky studim për herë të parë filloi të realizohet në vitin 1997 me ciklin e parë të matjes në PISA 2000.

Kjo përmbledhje detyrash, përmban shembuj të ajtemëve të liruara nga të gjitha ciklet e PISA që janë realizuar në letër.

Rezultatet nga studimi i realizuar mundësojnë fitimin e të dhënave valide mbi atë se sa mirë nxënësit janë të përgatitur për jetë në shoqërinë bashkëkohore pas mbarimit të shkollës, duke vënë theksin në zbatueshmërinë e diturive, shkathtësive dhe kompetencave të cilat i kanë fituar gjatë procesit arsimor, e jo sa mirë nxënësit i kanë zotëruar përmbajtjet arsimore që janë të parapara me programet arsimore dhe sa është dituria faktografike e memorizuar. Gjatë matjes me anë të këtij studimi jo vetëm që caktohet se a mund nxënësit ta riprodhojnë diturinë e tyre, por caktohet edhe se a mund nxënësit ta përdorin të mësuarën dhe po të njëjtën ta zbatojnë si dituri në mjedis të panjohur, në dhe jashtë shkollës. Kjo qasje e reflekton faktin që shtetet moderne nuk i shpërblejnë individët për atë që dinë, por për atë që mund të bëjnë me diturinë e tyre. Njëkohësisht fitohen njohuri edhe për faktorët socio-ekonomik dhe arsimor të cilët ndikojnë në arritjet e nxënësve.

Përmes studimit PISA duhet të marrim përgjigje sa nxënësit në moshë pesëmbëdhjetë vjeçare dinë dhe janë të aftësuar ta zbatojnë diturinë personale.

Rezultatet nga PISA u mundësojnë kreatorëve të politikave arsimore në mbarë botën të:

- matin diturinë dhe shkathtësitë e nxënësve në vendin e tyre në krahasim me ata nga vendet e tjera;
- vendosin qëllime të cilat janë të matshme dhe të arritura në sisteme të tjera arsimore;

- mësojnë nga politikat dhe praktikat e zbatuara në një vend tjetër, përkatësisht të mësohet nga politika dhe praktika e shteteve të cilat kanë treguar përmirësim.

Ndonëse PISA nuk mund të identifikojë raportet shkak-pasojë mes politikave/praktikave dhe rezultateve të nxënësve, ajo u tregon edukatorëve, kreatorëve të politikave dhe publikut të interesuar se si sistemet arsimore janë të ngjashme dhe dallojnë – dhe çfarë do të thotë kjo për nxënësit.

Arritjet e nxënësve nga secila fushë në PISA paraqiten në raport me nivelin e diturisë, ku niveli 6 është niveli më i lartë në shkallën e PISA, kurse niveli 1 dhe gjithçka nën të niveli më i ulët.

Tabela 1. Nivelet e arritjeve në fushën lexim-kuptim në PISA

Niveli	Numri më lartë i pikëve	Përshkrimi i nivelit
6	698	Nxënësi nga ky nivel, më së shpeshti mund të bëjë më shumë përfundime, krahasime dhe kontraste të cilat janë të hollësishme dhe precize duke ndërlidhur informacione të fshehura të cilat nuk janë të lidhura direkt me kërkesën e detyrës. Kërkesat në këto detyra lypin demonstrim të kuptimit të tërësishëm dhe të hollësishëm të një ose më shumë teksteve gjatë së cilës mund të përfshijnë integrimin e informacioneve kundërtënëse nga më shumë se një tekst. Nga nxënësi kërkohet të ballafaqohet me ide të panjohura, në prezencë të informacioneve dominante-nxitëse dhe të gjenerojë kategori abstrakte për interpretim gjatë sjelljes së përfundimeve. Këto detyra e nxitin nxënësin të supozojë ose të vlerësojë në mënyrë kritike tekstin kompleks të një teme të panjohur, duke marrë parasysh më shumë kritere ose perspektiva dhe duke zbatuar kuptime dhe dituri të sofistikuara jashtë tekstit. Kusht i rëndësishëm për qasje adekuate gjatë përgjigjes në detyrat e këtij niveli është preciziteti i analizës dhe orientimi i vëmendjes së tërësishme në detajet të cilat janë të pavërejtshme në tekste.
5	626	Në këtë nivel përfshihen informacione të cilat nga nxënësi kërkojnë të gjejë dhe organizojë pjesët e informacioneve të fshehura thellë që të mund të përcaktojnë se cilat nga këto informacione në tekst janë relevante me lëvizje të vazhdueshme nëpër tekst. Nxënësi, po ashtu, mund të përgjigjet në pyetje indirekte ashtu që do ta përmend lidhjen mes pyetjes me pjesë të informacioneve të shpërndara në ose nëpër më shumë tekste dhe burime. Detyrat reflektive (mendore) kërkojnë vlerësim kritik ose formulimin e hipotezës, duke u thirrur në diturinë e specializuar (konkrete). Që të dyja, edhe detyrat interpretative edhe reflektive, kërkojnë kuptim të tërësishëm dhe të hollësishëm të tekstit përmbajtja ose forma e të cilit është e panjohur. Nxënësi mund të caktojë dallimin mes përmbajtjes dhe qëllimit, dhe mes fakteve e mendimit që i referohet, deklaratave

		komplekse ose abstrakte. Nxënësi po ashtu mund të nxjerr konkluzione në lidhje me besueshmërinë e informacioneve ose përfundimeve të ofruara në një pjesë të tekstit. Për të gjitha aspektet e leximit, detyrat në këtë nivel zakonisht përfshijnë ballafaqimeme koncepte të cilat janë të kundërta me pritshmërinë.
4	553	Në këtë nivel nga nxënësi kërkohet të gjejë dhe të organizojë pjesët në tekstin në të cilin gjenden informacione të fshehura (të caktojë kontekstin në përmbajtje). Me këto detyra nxënësi tregon se mund të kuptojë paragrafët e zgjeruar në një ose më shumë tekste. Me disa detyra, të këtij niveli, kërkohet interpretim i rëndësisë së nuancave në gjuhë në pjesë të tekstit në raport me tërësinë e tekstit. Nxënësi i këtij niveli (ose detyrave për interpretim) tregon kuptim dhe zbatim të kategorive dhe informacioneve në tekst të panjohur. Këto detyra nga nxënësi kërkojnë të përdor dituri formale dhe të supozuar që të mund në mënyrë kritike të vlerësojë tekstin. Nxënësi mund të krahasojë dhe kundërshtojë pohimet e bëra në disa tekste dhe të vlerësojë besueshmërinë e burimit bazuar në kriteret e treguara. Që të mund të përgjigjet në këto detyra nxënësi duhet të tregojë kuptim të saktë të teksteve të gjata ose komplekse përmbajtja ose forma e të cilëve mund të jetë e panjohur. Tekstet e nivelit 4 shpesh janë të gjatë dhe kompleks, dhe përmbajtja e tyre ose forma mund të mos jetë standarde dhe po të njëjtët të përmbajnë shenja indirekte ose implicite (të nënkuptuara).
3	480	Nxënësi nga ky nivel mund të gjejë, e në disa raste dhe të njohë përpjestimin mes disa pjesëve të informacioneve të cilat duhet të përgjigjen në më shumë kushte. Nxënësi duhet të integrojë informacione nga disa lloje tekstesh, me qëllim që të identifikohet ideja kryesore, të kuptojë marrëdhënien ose të interpretojë rëndësinë e ndonjë fjale apo fraze. Në këtë nivel pritët që nxënësi të merr parasysh shumë opsione për krahasim, për kundërshtim ose për kategorizimin e informacioneve. Shpesh informacioni i kërkuar nuk është i theksuar ose ka ide të cilat janë të kundërta me pritshmërinë ose janë negativisht të formuluar. Detyrat e nivelit 3 kërkojnë nga nxënësi të merr parasysh shumë karakteristika gjatë krahasimit, kontrastit ose kategorizimit të informacioneve. Informacionet e duhura shpesh nuk janë të theksuara ose mund të ketë më shumë informacione të përafërta sipas kuptimit ose të njëjtat të jenë negativisht të formuluar.

2	407	Në nivelin 2 nxënësi mund të gjejë një apo më shumë pjesë të informacioneve, të cilat ndoshta do të nevojiten për të sjellë përfundim ose do të duhet të përmbushë disa kushte që të zbulojë përgjigjen. Pritet që nxënësi të njohë idenë kryesore në tekst, të kuptojë marrëdhëniet ose interpretimin e rëndësisë në pjesë të kufizuara të tekstit kur informacionet nuk janë të theksuara, dhe nxënësi duhet të bëjë përfundime në nivel të ulët. Detyrat e këtij niveli mund të përfshijnë krahasime ose kontraste në bazë të një karakteristike në tekst. Detyrat tipike refleksive të këtij niveli kërkojnë që nxënësi të bëjë krahasim ose të lidhë tekstin me diturinë e tij joformale, duke përdorur përvojën dhe qëndrimet personale.
1a	335	Nxënësi në këtë nivel mund të gjejë një ose më shumë pjesë të pavarura prej informacioneve të dhëna eksplicite; të njohë temën kryesore ose porositë e autorit të tekstit për temë të njohur, ose të bëjë ndërlidhje të thjeshtë mes informacioneve në tekst duke ndërlidhur diturinë e përditshme. Zakonisht informacionet e dhëna në tekst janë të njohura dhe në qoftë se ka pak informacione, në qoftë se ka, ata janë të ndryshme për nga rëndësia. Nxënësi është në mënyrë eksplicite i orientuar në shqyrtimin e faktorëve relevantë në detyrë dhe tekst. Nxënësi i nivelit 1a mund të mendojë për qëllimin dhe rëndësinë relative të informacioneve (p.sh.: Ideja kryesore kundrejt detajeve jothelbësore) në tekste të thjeshta të cilët përmbajnë indice eksplicite.
1b	262	Nxënësi në këtë nivel mund të përcaktojë një pjesë në informacionin e dhënë eksplicit i cili është në vend të dukshëm në tekst të shkurtër, sintaksor të thjeshtë me kontekst dhe tekst të njohur, siç është narrativ ose listë e thjeshtë. Nxënësi po ashtu mund tekstualisht të interpretojë rëndësinë e teksteve duke bërë ndërlidhje të thjeshta mes pjesëve fqinje nga informacionet në pyetjen dhe / ose tekstin. Teksti zakonisht paraqet mbështetje për nxënësin, sepse ka përsëritje të informacioneve, fotografi ose simbole të njohura. Në tekst ka minimalisht informacione komplekse.
1c	189	Nxënësi i nivelit 1c mund të kuptojë dhe të konfirmojë rëndësinë e fjalive të shkurtra, fjali të thjeshta sintaksore në nivel tekstual dhe të lexojë për qëllim të qartë dhe të thjeshtë në kohë të kufizuar. Detyrat e këtij niveli përfshijnë vokabular dhe struktura të thjeshta sintaksore.

SHEMBUJ DETYRASH

Në dy faqet në vazhdim ndodhen dy tekste. Teksti i parë (teksti 1) është një copëz nga pjesa teatrale Leokadia e Zhan Anuil ; i dyti (teksti 2) jep disa përkufizime të profesioneve të botës së teatrit. Mbështetuni te këto tekste për t'i dhënë përgjigje pyetjeve që vijojnë.

TEKSTI 1

AMANDA DHE DUKESHA

Përmbledhje. Qysh nga vdekja e *Leokadias*, Princi, i cili ishte i dashuruar pas saj, nuk gjen dot ngushëllim. Në një dyqan të quajtur *Réséda Soeurs*, Dukësja, e cila është halla e Princit, ka takuar një shitëse të re në moshë, Amandën, e cila i ngjante jashtëzakonisht *Leokadias*. Dukësja i kërkon Amandës ta ndihmojë për të shkëputur Princin nga kujtimet që e mundojnë.

Një kryqëzim në parkun e kështjellës, një stol i vendosur rrotull një obelisku të vogël... bie mbrëmja...

AMANDA

Nuk po arrij t'ju kuptoj. Çfarë mund të bëj unë për të, zonjë? Nuk arrij ta besoj se ju keni menduar që... Po pse pikërisht unë? Unë nuk jam as e bukur. Po edhe sikur të isha - kush mund të futej kaq lehtë midis tij dhe kujtimit që e mundon?

DUKESHA

Askush tjetër veç jush.

AMANDA, *sinqerisht e befasuar*.

Unë?

DUKESHA

Bija ime, njerëzit janë aq budallenj, nuk u shohin sytë veçse parada, gjeste, dekorata... aq sa nuk u ka shkuar ndër mend t'jua thonë. Por mua zemra nuk më ka gënjer kurrë - herën e parë kur ju pashë te dyqani *Réséda Soeurs* për pak sa nuk bërtita. Për cilindo që ka njohur atë dhe jo fantazmën e saj, ju jeni portreti i gjallë i *Leokadias*.

Heshtje. Zogjtë e mbrëmjes kanë zëvendësuar ata të pasdites. Parku është plot hije dhe murmurima.

AMANDA, *me qetësi*

Megjithatë, besoj se nuk do të mundem, zonjë.

Nuk kam kurrëgjë, jam askushi, dhe ata të

dashurit... ishin vetëm një kapriço e imja, apo jo?

Ajo ngrihet si për t'u larguar dhe merr çantën e vogël.

DUKESHA, gjithashtu me qetësi dhe shumë e lodhur.

Padyshim bija ime. Ju kërkoj ndjesë.

Ajo ngrihet gjithashtu me vështirësi si ndonjë e moshuar. Dëgjohet zhurma e një biçiklete në muzg; ajo dridhet.

E dëgjoni... Është ai? Vetëm shfaqu para tij e mbështetur në këtë obelisk të vogël ku ka takuar atë për herë të parë. Të paktën t'ju shohë një herë, të thotë diçka, të tërhiqet papritur nga ky shëmbëllim, nga ky marifet që po i bëj dhe që do t'ia tregoj nesër dhe për të cilin ai do të më marrë inat, por së paku nuk do të interesohet më për atë të vdekurën që me siguri do të ma marrë me vete ndonjë ditë... (I kap dorën.) Ju do të ma bëni këtë, apo jo? Jua kërkoj me përgjërime zonjushë. (E shikon me përulësi dhe shton:) Siç e shihni edhe vetë. E ndiej se po skuqem duke jua thënë këtë - jeta është vërtet marrëzi! Më ka ndodhur tri herë në gjashtëdhjetë vite, prej të cilave dy herë në këto dhjetë minuta, që të skuqem - ju do ta shihni dhe, fundja - (përse të mos jetë ai, përderisa është edhe i bukur, tërheqës dhe nuk është as i pari?) - Ah sikur më në fund të gjente

edhe ai lumturinë, për veten e tij dhe për mua,
të jetë për një çast - kapriçoja juaj...Zhurma e
biçikletës dëgjohej përsëri, por tani më afër.

AMANDA, me një frymë.

Çfarë duhet t' i them?

DUKESHA, duke i shtrënguar krahun.

Thuaji thjesht: "Më falni zotëri, a mund të më
tregoni rrugën për te deti?"

Ajo u fut nën hijen e pemëve. Është tamam në
kohë. Një hije e bardhë, është princi me
biçikletë. Ai kalon fare pranë imazhit të
vagëllyer të Amandës së mbështetur tek
obelisku. Ajo pëshpërit.

AMANDA

Më falni, zori...

Ai ndalon , zbret nga biçikleta, heq kapelen dhe
e vështron.

PRINCI

Urdhëroni?

AMANDA

A mund të më tregoni rrugën për te deti?

PRINCI

Është e dyta nga e majta, zonjushë.

*(Ai e përshëndet, i trishtuar dhe i sjellshëm,
hipën në biçikletë dhe largohet. Dëgjohej
zhurma e biçikletës nga larg. Dukësja del nga
errësira fare e mplantur).*

AMANDA, butësisht, pas njëfarë kohe.

Nuk më njohu...

DUKESHA

Ishte errësirë... dhe pastaj kushedi se çfarë
imazhi të saj ruan tani në mendje? *(Ajo e pyet
me druajtje:)* Treni i fundit ka ikur, zonjushë. A
nuk qëndroni sot në kështjellë?

AMANDA, me një zë të çuditshëm.

Po, zonjë.

*Nata bie plotësisht. Ato të dyja nuk shihen më
në errësirë, nuk dëgjohej gjë tjetër veç erës mes
pemëve të pafundme të parkut.*

BIE PERDJA

TEKSTI 2

PËRKUFIZIME TË DISA PROFESIONEVE NË BOTËN E TEATRIT

Aktori: luan në skenë një personazh.

Regjisori: kontrollon dhe mbikëqyr të gjithë elementet e një shfaqjeje. Ai merret jo vetëm me vendosjen e aktorëve, me hyrjet dhe daljet e tyre dhe me drejtimin e lojës së tyre, por propozon gjithashtu se si duhet interpretuar pjesa.

Personeli i garderobës: bën kostumet duke u nisur nga një model.

Kostumografi: koncepton rroba sipas një modeli të caktuar.

Skenografi: koncepton maketet e dekorit dhe të kostumeve. Këto modele realizohen më pas nga rrobaqepësi.

Menaxheri i pajisjeve teatrore: është i ngarkuar të gjejë pajisjet e nevojshme ndihmëse. Fjala "pajisje ndihmëse" përdoret për të treguar çdo gjë që është e transportueshme: kolltuqe, letra, llampa, buqeta lulesh etj. Dekori dhe kostumet nuk futen në këtë kategori.

Tekniku i zërit: është përgjegjës për të gjitha efektet e zërit të nevojshme për vënien në skenë. Gjatë gjithë shfaqjes ai është në panelin e kontrollit.

Ndihmësi i ndriçimit ose tekniku i ndriçimit: është përgjegjës për ndriçimin. Edhe ai qëndron në panelin e kontrollit gjatë shfaqjes. Duke qenë se ndriçimi është shumë i ndërlikuar, një teatër i pajisur mirë mund të ketë deri në dhjetë teknike ndriçimi.

Pyetja 1/5

Përse bën fjalë kjo copë nga pjesa teatrale?

Dukesha e sajoi këtë dredhi

- A. që ta bëjë Princin të vijë ta shohë atë më shpesh.
- B. që ta bëjë Princin të vendosë më në fund të martohet.
- C. që ta bëjë Amandën ta ndihmojë Princin të harrojë dhimbjen e tij.
- D. që ta bëjë Amandën të vijë të jetojë në kështjellë me të.

Pyetja 2/5

Në skenarin e kësaj pjese, përveç dialogut që aktorët duhet ta mësojnë përmendsh, ka edhe disa tregues skenikë që duhet ndjekur nga aktorët dhe teknikët e teatrit.

Si mund të dallohen këta tregues skenikë në skenar?

Pyetja 3/5

Tabela e mëposhtme paraqet një listë të teknikëve të teatrit të cilëve u është dashur të punojnë për vënien në skenë të kësaj pjese të shkëputur nga Leokadia. Plotësoni tabelën duke dhënë, për secilin teknik, një tregues skenik nga TEKSTI 1 që kërkon ndërhyrjen e tij.


Rreshti i parë i tabelës është plotësuar për t'u dhënë si shembull.

Teknikë të teatrit	Tregues skenikë
Skenografi	Një stol i rrumbullakët përreth një obelisku të vogël
Menaxheri i pajisjeve teatrale	
Tekniku i zërit	
Tekniku i ndriçimit	

Pyetja 4/5

Regjisori i pozicionon aktorët në skenë. Në një skicë, ai shënon Amandën me shkronjën A dhe Dukeshën me shkronjën D.

Vendosni shkronjat A dhe D në skicën e mëposhtme për të treguar me përafërsi se ku ndodhen Amanda dhe Dukesha në momentin kur mbërrin Princi.



Pyetja 5/5

Nga fundi i pjesës, Amanda thotë, “Nuk më njohu...”.

Çfarë do të thotë ajo me këtë?

- A. Se Princi nuk e pa Amandën.
- B. Se Princi nuk e vuri re që Amanda ishte shitëse.
- C. Se Princi nuk e vuri re se ai e kish takuar më parë Amandën.
- D. Se Princi nuk e vuri re që Amanda i ngjante Leokadias.

MBISHKRIMET

Shqetësohem kur shoh që muret e shkollës janë pastruar dhe lyer për të katërtën herë për të fshirë mbishkrimet dhe vizatimet.

Krijimtaria është për t'u admiruar, por njerëzit duhet të gjejnë mënyra të tjera për t'u shprehur pa i shkaktuar shoqërisë dëme shtesë. Përse doni ta zbehni emrin e mirë të të rinjve duke vizatuar aty ku nuk lejohet? Artistët profesionistë nuk i varin tablotë e tyre nëpër rrugë !

Ata përpiqen të gjejnë financime dhe të bëhen të njohur nëpërmjet ekspozitave të ligjshme. Sipas meje, ndërtesat, gardhet dhe stolat nëpër parqe janë në vetvete vepra arti. Është vërtet për të ardhur keq që prishet kjo arkitekturë me mbishkrime dhe vizatime nëpër mure dhe për më tepër, metoda e përdorur shkatërron shtresën e ozonit.

Vërtet nuk arrij ta kuptoj se përse këta artistë kriminelë mundohen kaq herë.

Helga

Nuk kemi pse t'i vëmë në diskutim shijet. Shoqëria jonë është pushtuar nga mjetet e komunikimit dhe nga reklamat. Simbole ndërrmarrjesh, emra dyqanesh. Afishe të pafundme shihen kudo nëpër rrugë. A janë të pranueshme? Po, shumica. Po mbishkrimet dhe vizatimet nëpër mure, a pranohen nga shoqëria ? Disa thonë po, të tjerët thonë jo. Kush e paguan çmimin e vizatimeve nëpër mure? Në fund të fundit, kush e paguan çmimin e reklamave? E drejtë. Konsumatori. A ju kanë kërkuar ndonjëherë leje, ata që kanë vendosur tabela reklamash? Jo. Atëherë, a duhet të kërkojnë leje autorët e mbishkrimeve dhe të vizatimeve nëpër mure? A nuk është kjo thjesht një çështje komunikimi – emri juaj, emrat e grupeve dhe të veprave të mëdha të artit shfaqen nëpër rrugë? Pa kujtoni pak veshjet me vija dhe me kuadrate që dolën nëpër dyqane para disa vitesh. Kujtoni edhe veshjet dhe pajisjet e skive. Motivet dhe ngjyrat e tyre janë marrë drejtpërsëdrejti nga këto mure plot ngjyra. Është për t'u çuditur që këto motive dhe ngjyra pranohen dhe pëlqehen nga njerëzit, ndërsa mbishkrimet dhe vizatimet nëpër mure të të njëjtit stil quhen si diçka e shëmtuar.

Kanë ardhur kohë të vështira për artin.

Sofia

Dy letrat e mësipërme janë nxjerrë nga Interneti dhe flasin për mbishkrimet dhe vizatimet nëpër mure (piktura ose mbishkrime të bëra ilegalisht mbi mure dhe vende të tjera). Mbështetuni tek këto letra për t'iu përgjigjur pyetjeve në vazhdim!

Pyetja1/4

Qëllimi i secilës prej këtyre letrave është:

- A. të shpjegojnë se ç'janë mbishkrimet dhe vizatimet nëpër mure.
- B. të japin një mendim për mbishkrimet dhe vizatimet nëpër mure.
- C. të tregojnë popullaritetin e mbishkrimeve dhe të vizatimeve nëpër mure.

D. t' u tregojnë njerëzve se sa kushton fshirja e mbishkrimeve dhe e vizatimeve nëpër mure

Pyetja 2/4

Përse Sofia përmend reklamat?

.....

.....

Pyetja 3/4

Me cilën nga dy autoret e letrave jeni në një mendje? Sqaro përgjigjen tënde, duke përdorur fjalët e tua për të përmendur atë çka është shkruar në njërin ose në të dyja letrat!

.....

Pyetja 4/4

Ne mund të flasim për çka thuhet në një letër (përmbajtja e saj).

Ne mund të flasim për mënyrën se si është shkruar një letër (stili i saj).

Pavarësisht se me cilën letër ju përputhet mendimi, sipas jush, cila letër është më e mirë? Justifikoni përgjigjen tuaj duke iu referuar mënyrës se si është shkruar njëra ose të dyja letrat.

.....

LIQENI ÇAD

Figura 1 paraqet ndryshimet që kanë ndodhur në nivelin e ujit të Liqenit Çad në Sahara, në Afrikën e Veriut. Liqeni Çad u zhduk plotësisht rreth 20 000 vjet para Erës Sonë, gjatë periudhës së fundit të akullnajave. Ai u rishfaq përsëri rreth 11 000 vjet para Erës Sonë. Sot, niveli i tij është pothuajse i njëjtë me atë të vitit 1000 të Erës Sonë.





Figura 1

Figura 2 paraqet artin në shkëmb në Sahara (domethënë, piktura të periudhës parahistorike dhe vizatime të gjetura në muret e brendshme të shpellave) dhe evolucionin e faunës.



Përdorni informacionin për Liqenin Çad, dhënë në faqen e mëparshme për t'iu përgjigjur pyetjeve që vijojnë.

Pyetja 1/5

Sa është thellësia e Liqenit Çad sot?

- A. Rreth dy metra.
- B. Rreth pesëmbëdhjetë metra.
- C. Rreth pesëdhjetë metra.
- D. Është zhdukur plotësisht.
- E. Ky informacion nuk është dhënë.

Pyetja 2/5

Rreth cilit vit fillon grafiku i paraqitur në Figurën 1?

.....

Pyetja 3/5

Përse autori ka zgjedhur pikërisht këtë datë pikënisje për grafikun?

.....

.....

Pyetja 4/5

Figura 2 bazohet në hipotezën se:

- A. kafshët e paraqitura në vizatimet mbi shkëmb jetonin në atë zonë në periudhën kur janë vizatuar.
- B. artistët që kanë bërë vizatimet ishin shumë të aftë.
- C. artistët që kanë bërë vizatimet ishin në gjendje të bënin udhëtime të largëta.
- D. nuk bëhej asnjë përpjekje për të zbutur kafshët shtëpiake të paraqitura në vizatimet mbi shkëmb.

Pyetja 5/5

Për t'iu përgjigjur kësaj pyetje, duhet të përdorni si informacionet e Figurës 1 edhe ato të Figurës 2. Zhdukja e rinoqerontëve, hipopotamëve dhe kaut të egër nga arti saharian në shkëmb ndodhi:

- A. në fillim të periudhës më të fundit të akullnajave.
- B. në mes të periudhës kur niveli i Liqenit Çad ishte më i larti.
- C. pasi niveli i Liqenit Çad kishte rënë në më shumë se një mijë vjet.
- D. në fillim të një periudhe të stërgjatur thatësirash.

Çfarë është QLBJ?

QLBJ është shkurtimi i Qendrës për Lëvizjet Brenda dhe Jashtë, një nismë e seksionit të personelit. Një numër punonjësish të këtij seksioni punojnë në QLBJ, së bashku me punonjës nga seksione të tjera dhe këshillues të jashtëm.

QLBJ ndihmon punonjësit që janë të interesuar të gjejnë një vend tjetër pune brenda ose jashtë ndërmarrjes prodhuese Canco.

Çfarë bën QLBJ?

QLBJ u vjen në ndihmë punonjësve që dëshirojnë me të vërtetë të ndërrojnë vend pune, përmes :

- ***Bankës së të dhënave për punësim***

Pas një bisede me punonjësin, të dhënat e marra futen në bankën e të dhënave e cila bën një listë të atyre që kërkojnë punë dhe të vendeve të lira të punës në Canco dhe në ndërmarrje të tjera prodhuese.

- ***Orientimit***

Aftësitë e punonjësit shqyrtohen përmes bisedave të orientimit profesional.

- ***Kurseve***

Organizohen kurse (në bashkëpunim me seksionin e informacionit dhe të kualifikimit) për mënyrat se si të kërkohet punë dhe se si të bëhet planifikimi i karrierës.

- ***Projekteve për riorientim profesional***

QLBJ mbështet dhe bashkërendon projekte që synojnë të përgatisin punonjësit për t'iu përshtatur profesioneve dhe perspektivave të reja.

- ***Ndërmjetësimi***

QLBJ luan rolin e ndërmjetësit për punonjësit që rrezikojnë të humbasin vendin e punës për shkak të riorganizimeve dhe i ndihmon ata, në rast nevojë, të gjejnë një vend tjetër pune.

Sa kushton QLBJ?

Pagesa përcaktohet në konsultim me seksionin ku punoni. Një numër shërbimesh të ofruara nga QLBJ janë falas. Mundet gjithashtu t'ju kërkohet të paguani ose me para në dorë ose me kohë pune.

Si funksionon QLBJ?

QLBJ u vjen në ndihmë punonjësve që interesohen seriozisht për të gjetur një vend pune brenda ndërmarrjes ose jashtë saj.

Hapi i parë fillon me paraqitjen e kërkesës. Një bisedë me konsulentin e personelit mund të jetë gjithashtu e dobishme. Natyrisht, që fillimisht ju duhet t'i thoni atij se çfarë kërkonit dhe të merrni të dhëna prej tij mbi mundësitë për të bërë karrierë brenda ndërmarrjes. Konsulenti i njeh aftësitë tuaja dhe është në dijeni të perspektivave të zhvillimit brenda seksionit tuaj.

Kontakti me QLBJ në çdo rast bëhet përmes këshilluesit të personelit. Ai ose ajo shqyrton kërkesën tuaj dhe më pas ju ftoheni të takoheni me një përfaqësues të QLBJ-së.

Për më shumë informacion

Seksioni i personelit mund t'ju japë më shumë të dhëna.

Përdorni njoftimin e Seksionit të personelit dhënë në faqen e mëparshme për t'u përgjigjur në pyetjet në vazhdim.

Pyetja 1/2

Sipas njoftimit, ku mund të merrni më shumë informacione mbi QLBJ-në?

.....

.....

Pyetja 2/2

Përmendni dy mënyra me anë të të cilave QLBJ ndihmon njerëzit që rrezikojnë të humbasin vendet e tyre të punës për shkak të riorganizimit të shërbimit ku ata punojnë.

.....

.....

Ajo po vriste mendjen se sa ditë kishte ashtu e ulur, duke parë ujin e ftohtë ngjyrë kafe tek ngjitej nga bregu i rrëpirët. Ajo e mbante mend shumë mjegullt fillimin e shiut, i cili kish ardhur nga jugu mbi kënetë dhe godiste muret e shtëpisë së saj. Më pas, niveli i lumit kishte nisur të ngrihej, fillimisht ngadalë, derisa më në fund ndaloi, për t'ia nisur përsëri. Orë pas ore, ai mbushte shtratin e rrëkeve dhe gropat përreth dhe përmbyste vendet e ulta. Natën, teksa ajo flinte, uji kishte zaptuar rrugën dhe e kishte rrethuar nga të katër anët, duke e lënë atë të vetmuar, ndërsa barka i ishte zhdukur dhe shtëpia dukej si një pìrg i ngecur mbi breg. Tashmë uji po arrinte kolonat e drunjta me zift të shtëpisë. Ai ngjitej pa pushim.

Aq larg sa ajo kishte mundësi të shihte, deri tek majat e pemëve, aty ku më parë ndodhej bregu tjetër i lumit, kënetë ishte një det i zbrazët i mbuluar nga shiu, ndërsa lumi kish humbur në shtrirjen e saj. Shtëpia e saj me bazën në formë varke ishte ndërtuar për t'i bërë ballë një përmytjeje të tillë, nëse do të vinte ndonjëherë, por tani ajo ishte e vjetëruar. Ndoshta dërrasat e poshtme ishin kalbur pjesërisht. Ndoshta kabli që lidhte shtëpinë e saj me lisin e vjetër do të këputej dhe ta linte shtëpinë në mëshirën e rrymës së ujit, sikurse kishte ndodhur me varkën e saj, që ishte zhdukur.

Askush nuk mund të vinte dot më. Ajo mund të bërtiste, por do të ishte e kotë, pasi askush nuk do ta dëgjonte. Rreth e rrotull kënetës, të tjerë njerëz po luftonin për të shpëtuar ç'të mundnin, ndoshta vetem jetën e tyre. Ajo pati parë një shtëpi të tërë tek pluskonte në ujë kaq qetë, sa kishte menduar se po merrte pjesë në një funeral. Duke parë këtë skenë, ajo ish kujtuar se e dinte se e kujt kishte qenë ajo shtëpi. Ishte e dhimbshme ta shihje se si e merrte uji, por të zotët e saj duhet t'ia kishin mbathur në drejtim të tokave më në lartësi. Më vonë, kur shiu dhe errësira po bëheshin më të dendur, ajo pati dëgjuar klithmën e një pantere që vinte nga pjesa e sipërme e lumit.

Tashmë shtëpia dukej se dridhej rrotull saj, sikur të ishte diçka e gjallë. Ajo arriti të kapë një llampë që po rrëshqiste nga tavolina dhe e vuri midis këmbëve. Pastaj, duke kërcëllitur dhe oshëtitur me mundim, shtëpia u shkëput nga toka argjilore dhe nisi të tundej, duke vallëzuar mbi ujë si një tapë shisheje dhe duke u lëkundur nga rryma e lumit. Ajo u kap fort pas anëve të krevatit. Duke u lëkundur nga njëra anë në tjetrën, shtëpia u zhvendos deri në fund të kabllit. U ndie një lëkundje dhe një rënkim i trarëve të vjetër dhe më pas një heshtje. Dalëngadalë rryma e lëshoi atë dhe mundësoi që shtëpia të kthehej prapa, drejt pikës që e mbante të lidhur. Ajo mbajti frymën dhe qëndroi ulur për një kohë të gjatë duke ndier lëvizjet e lehta lëkundëse. Errësira ra mbi shiun që nuk pushonte dhe me kokën të mbështetur mbi gjërin krah, atë e zuri gjumi të mbërthyer mbi shtrat.

Dikur nga mesnata një klithmë e zgjoi atë, ishte një klithmë tërë ankth, aq sa e bëri të çohet në këmbë ende pa i dalë gjumi mirë. Në errësirë, ajo u përplas pas krevatit. Zhurma erdhi nga jashtë, nga ana e lumit. Ajo mundi të dëgjonte se diçka lëvizte, diçka e madhe që lëshonte një zhurmë që përhapej dhe ngjasonte me një kërcitje. Ishte ndoshta një shtëpi tjetër. Më pas, ajo diçka nisi të godiste jo drejtpërsëdrejti, por anash, përgjatë shtëpisë së saj. Ishte një pemë. Ajo dëgjoi zhurmën e degëve dhe të gjetheve tek shkëputeshin dheshkonin me rrjedhën, duke lënë vetëm shiun dhe pllaquritjet e përmytjes, që ishin bërë zhurma aq të zakonshme sa dukeshin të ishin pjesë e heshtjes. E mbledhur krupull mbi krevat, atë pothuaj e kish zënë gjumi kur u dëgjua një britmë tjetër, kësaj radhe aq pranë sikur të vinte nga brenda dhomës. Duke shqyer sytë në errësirë, ajo u tërhoq mbi krevat deri sa dora

i preku trupin e ftohtë të pushkës. Pastaj, e strukur pas jastëkut, ajo mbajti pushkën përmes gjunjëve. «Kush është aty?», bërtiti ajo.

Përgjigjja ishte një britmë tjetër, jo aq e mprehtë, si e lodhur, pastaj përsëri një qetësi e thellë. Ajo u mblodh përsëri kruspull në krevat. Çfarëdo që të ishte, ajo mund ta dëgjonte tek lëvizte përgjatë verandës. Dërrasat kërcisnin dhe ajo arrinte të dallonte zhurmën e objekteve që rrëzoheshin gjithkund. U dëgjua një e gërvishtur pas murit, sikur të donin ta çanin për të hyrë brenda. Ajo e kuptoi atëherë se për çfarë bëhej fjalë : ishte një mace e madhe e egër, e hedhur aty nga pema e shkullur që kish rënë pranë shtëpisë. Ajo kishte ardhur së bashku me përmbytjen, një dhuratë.

Në mënyrë të pavetëdijshme, ajo e kaloi dorën mbi fytyrë dhe mbi qafën e saj të ngirë. Pushka iu lëkund nëpër gjunjë. Ajo nuk kishte parë kurrë në jetën e saj ndonjë panterë. Ajo i kishte dëgjuar të tjerët të flisnin për to, i kishte dëgjuar të lëshonin klithmat e tyre, si klithma vuajtjeje, për së largu. Macja e egër vazhdonte të gërvishte murin përsëri, duke trokitur te dritarja pranë derës. Për sa kohë që ajo do të ruante dritaren dhe do të mbante macen të bllokuar midis murit dhe ujit, si në kafaz, asaj nuk mund t'i ndodhte gjë. Jashtë, kafsha pushoi së përplasuri kthetrat e saj mbi rrjetën e jashtme të ndryshkur të dritares. Kohë pas kohe, ajo angullinte dhe hungërinte.

Kur më së fundi, drita çau përmes shiut, duke ardhur si një lloj tjetër errësire, ajo ishte ende e ulur mbi krevat, e tëra e mpirë dhe e akullt. Krahët e saj, të mësuar të mbanin lopatat kur voziste mbi lumë, i dhimbnin nga të ndenjurit për një kohë të gjatë pa lëvizur duke mbajtur pushkën. Ajo nuk kishte guxuar të lëvizte nga frika se mos zhurma do të rigjallëronte panterën. E ngurosur, ajo lëkundej me ritmin e lëkundjeve të shtëpisë. Shiu binte pa pushim sikur nuk do të ndalej kurrë. Përmes dritës ngjyrë gri, ajo arriti të shohë ujrë të përmbytjes që stërpikeshin nga shiu dhe, së largu, dallonte formën e paqartë të majave të pemëve të përmbytura. Në atë moment, pantera nuk po lëvizte. Ndoshta ishte larguar. Pasi la pushkën, ajo rrëshqiti jashtë shtratit dhe iu afrua dritares pa bërë zhurmë. Ajo ishte akoma aty, e mbledhur kruspull në anë të verandës, duke parë lirin e vjetër, që ishte pika ku mbahej shtëpia, sikur donte të maste forcat nëse, duke u hedhur, mund të arrinte të kapej pas një dege që varej. Tani që mund ta shihte, ajo nuk po i dukej më aq e frikshme, me atë gëzof të trashë me qime të ngjitura, me ijet e futura sa të lejonin të shihje brinjët. Ishte fare e lehtë të qëllonte mbi të ashtu siç ishte e ulur, me bishtin e gjatë që e lëvizte poshtë e lart. Ajo po tërhijej prapa për të marrë pushkën, kur pantera u kthye. Pa paralajmërim, pa marrë vrull apo tendosur muskujt, macja kërceu drejt dritares, dhe theu njërin nga xhamat. Ajo u ra mbrapsht, duke mbajtur të bërtiturën, kapi pushkën dhe qëlloi nga dritarja. Tanimë, nuk po ia zinin më sytë panterën, por plumbi nuk e kishte kapur. Macja kishte nisur të ecte poshtë e lart. Ajo arrinte të shihte kokën dhe harkun e kurrizit të saj kur kalonte përpara dritares.

Duke u dridhur, ajo u kthye në shtrat dhe u shtri. Zhurma përkundëse dhe monotone e lumit dhe e shiut, të ftohtit që hynte, ia lëkundën synimin e saj. Ajo ia nguli sytë dritares dhe e mbajti pushkën gati. Pasi kish pritur për një kohë të gjatë, ajo lëvizi përsëri për të vështruar. Panterën e kishte zënë gjumi, me kokën mbi putra, si të ishte mace shtëpie. Për herë të parë qysh kur shiu kish nisur të binte, ajo pati dëshirë të qante, për veten e saj, për të gjithë njerëzit, për gjithçka që ishte prekur nga përmbytja. Ajo u fut në krevat dhe u mbështoll me jorgan. Duhej të ishte larguar me kohë, kur ishte akoma e mundur, kur rrugët ishin ende të hapura, ose përpara se barkën e saj ta kishte marrë uji. Ndërkohë që po lëkundej sa para mbrapa me ritmin e lëkundjeve të shtëpisë, një dhimbje e fortë në stomak e bëri të kujtohej se nuk kishte ngrënë. As që mund të kujtohej se qysh kur. Ashtu si edhe

pantera, ajo ishte e uritur. U fut në kuzhinë, ndezi një zjarr me disa copa drunjsh që kishin mbetur. Nëse përmbytja do të zgjaste, asaj do t'i duhej të digjte karrigen, ndoshta edhe tryezën. Pasi zbriti nga tavani atë çka kish mbetur nga një proshutës e tymosur, ajo preu disa copa të trasha nga mishi në ngjyrë të kuqe të errët dhe i vuri në tigan. Era e mishit që po skuqej e dehu. Kishin mbetur disa biskota bajate nga hera e fundit kur kishte gatuar dhe ajo mund të bënte pak kafe. Ujë kishte sa të donte.

Ndërkohë që po përgatitej për të ngrënë, ajo pothuaj e harroi panterën, deri në momentin kur kjo e fundit lëshoi një rënkim. Edhe macja kishte uri. «Më ler të ha vetë njëherë», i tha ajo, «pastaj do të merrem me ty». Dhe qeshi nën buzë. Ndërkohë që ajo po varte në gozhdë pjesën e mbetur të proshutës, pantera lëshoi një ulurimë të thellë, që e bëri t'i dridhej dora.

Pasi pati mbaruar së ngrëni, ajo u kthye në krevat dhe mori sërish pushkën. Shtëpia ishte ngritur tashmë aq lart saqë kur shtyhej nga lëvizjet e lumit, nuk e cekte më bregun. Ushqimi e kishte ngrohur. Ajo mund ta hiqte qafe kafshën për sa kohë që drita vazhdonte të përshkonte perden e shiut. Ajo rrëshqiti ngadalë drejt dritares. Pantera ishte ende aty, duke hungëritur dhe kishte nisur t'i vinte rrotull verandës. E vëzhgoi për një kohë të gjatë, pa patur frikë. Pastaj, pa u menduar për atë që po bënte, ajo e lëshoi pushkën mënjanë, kaloi rrotull krevatit dhe shkoi në kuzhinë. Prapa saj, pantera lëvizte e shqetësuar. Ajo këputi atë që kish mbetur nga proshuta, kaloi përmes dyshemesë që lëkundej, shkoi në drejtim të dritares dhe e hodhi proshutën përmes xhamit të thyer. Nga ana tjetër, dëgjohej një hungërimë e uritur dhe u duk sikur një valë goditëse kaloi midis saj dhe kafshës. E habitur nga ajo që kishte bërë, ajo u kthye në shtrat. Arrinte të dëgjonte zhurmën që bënte pantera tek shqyete mishin. Shtëpia lëkundej rreth saj.

Kur u zgjua sërish, e kuptoi menjëherë se çdo gjë kishte ndryshuar. Shiu kishte pushuar. U përpoq të ndiente lëvizjen e shtëpisë, por ajo nuk po lëkundej më mbi ujë. Duke hapur portën ajo pa, pas rrjetës së telit të shqyer, një botë krejt tjetër. Shtëpia qëndronte mbi bregun e rrëpirët, aty ku kishte qenë gjithmonë. Disa hapa më tutje, lumi rridhte gjithnjë rrëmbyeshëm, por nuk e mbulonte më distancën e vogël që ndante shtëpinë nga lisi i vjetër. Edhe pantera ishte zhdukur. Duke u larguar nga veranda në drejtim të lisit dhe duke u futur pa dyshim në drejtim të kënetës, gjurmët e hapave të padukshme po zhdukeshin tashmë në baltën e butë. Dhe aty, mbi verandë, gjendeshin, të brejtura deri në kockë, ato ç'ka kishin mbetur nga proshuta

Mbështetuni në tregimin «Dhurata» dhënë në tre faqet e mëparshme për t'iu përgjigjur pyetjeve të mëposhtme. (Shënim: numrat e rreshtave të vendosura në anën e majtë të tekstit do t'ju ndihmojnë për të gjetur pasazhet me të cilat lidhen pyetjet.)

Pyetja 1/7

Cila është gjendja e gruas në fillim të tregimit ?

- A. Pasi ka kaluar ditë të tëra pa ngrënë, ajo ndjehet shumë e dobët për t'u larguar nga shtëpia.
- B. Ajo e mbron veten nga një kafshë e egër.
- C. Shtëpia e saj u rrethua nga uji për shkak të përmbytjes.
- D. Lumi i dalë nga shtrati i rrëmbëu shtëpinë.

Pyetja 2/7

Kur gruaja shprehet: «pastaj do të merrem me ty » (rreshti 106), ajo kërkon të thotë:

- A. se ajo është e sigurtë se macja nuk do t'i bëjë ndonjë gjë të keqe.
- B. se ajo po përpiqet të frikësojë panterën.
- C. se ajo ka qëllim të qëllojë mbi panterën.
- D. se ajo mendon ta ushqejë panterën.

Pyetja 3/7

A mendoni se fjalia e fundit e tregimit «Dhurata» është një mbyllje e përshtatshme e tregimit ?

Shpjegoni përgjigjen tuaj duke treguar se si e kuptoni lidhjen midis fjalisë së fundit dhe kuptimit të tregimit.

.....

.....

.....

Pyetja 4/7

« Pastaj, duke kërcëllitur dhe oshëtitur me mundim, shtëpia u shkëput nga ... » (rreshtat 27-28)

Çfarë po i ndodhte shtëpisë në atë moment të tregimit?

- A. Ajo u shemb.
- B. Ajo nisi të lëkundej mbi ujë.
- C. Ajo u përplas me lisin.
- D. Ajo u fundos në fund të lumit

Pyetja 5/7

Ja disa nga përshkrimet e para që lidhen me panterën në tregim.

« një klithmë e zgjoi atë, ishte një klithmë tërë ankth ... » : (rreshti 37).

« Përgjigjja ishte një britmë tjetër, jo aq e mprehtë, si e lodhur, ... » (rreshti 50).

« Ajo i kishte...dëgjuar të lëshonin klithmat e tyre, si klithma vuajtjeje, për së largu. » (rreshtat 60-61).

Duke patur parasysh atë ç'ka ndodh në vijim të tregimit, përse mendoni se autori e vendos ta paraqesë panterën nëpërmjet këtyre përshkrimeve ?

.....

.....

Pyetja 6/7

Sipas asaj që na sugjeron tregimi, cila ishte arsyeja që e shtyu gruan për t'i dhënë panterës për të ngrënë ?

.....

.....

Pyetja 7/7

Ja një pjesë nga dialogu midis dy personave që kanë lexuar tregimin «Dhurata».

Gjeni në tregim disa elemente që secili nga bashkëbiseduesit e mësipërm mund t'i përdorë për të justifikuar pikëpamjen e tij.



Bashkëbiseduesi 1:.....

.....

Bashkëbiseduesi 2 :

.....

ARMËT SHKENCORE TË POLICISË

Në skenën e krimit, hetuesit, kanë mbledhur çdo copëz të mundshme të provave që mund të imagjinohet: fije pëlhure, flokë, shenjat e gishtërinjve, bishtat e cigareve... Disa fije floku, të gjetura në xhakatën e viktimës janë të kuqe. Dhe ngjajnë me flokët e të dyshuarit. Nëse do të mund të provohet se këto flokë janë me të vërtetë të tij, atëherë kjo do të ishte dëshmi që ai në të vërtetë e ka takuar në fakt viktimën.

Çdo individ është unik

Specialistët i vihen punës. Ata ekzaminonë disa qeliza të rrënjës së këtyre fijeve të flokut dhe disa prej qelizave të gjakut të të dyshuarit. Në bërthamën e secilës qelizë të trupit tonë, ka ADN. Çfarë është kjo? ADN është si varëse e bërë me fije të përdredhura të veshura me perla. Imagjiloni që këto perla janë në katër ngjyra të ndryshme dhe se mijëra perla të ngjyrosura (të cilat formojnë një gjen) renditen në një mënyrë shumë specifike. Në secilin individ, kjo renditje është e njëjtë në secilën qelizë të trupit të tij: si në ato të rrënjës së

flokëve, ashtu edhe në ato të gishtit të madh të këmbës; si në ato të mëlçisë, ashtu edhe në ato të stomakut apo gjakut. Por rendi i perlave ndryshon nga njëri person në tjetrin. Duke mbajtur parasysh numrin e perlave të lidhura në këtë mënyrë, ekzistojnë fare pak mundësi që të ketë dy njerëz me të njëjtën ADN, me përjashtim të binjakëve identikë. Unikë për çdo individ, ADN-ja është, pra, njëllëj karte gjenetike e identitetit. Pra, gjenetistët janë në gjendje ta krahasojnë kartën gjenetike të identitetit të të dyshuarit (e përcaktuar nga gjaku i tij) me atë të personit me flokë të kuq. Nëse karta gjenetike është e njëjtë, ata

do ta dinë se i dyshuari në të vërtetë ka shkuar pranë viktimës, gjë për të cilën ka thënë se nuk e ka vepruar kurrë.

Vetëm një dëshmi

Sa vjen e më shumë, në rastet e sulmeve seksuale, vrasjeve, vjedhjeve apo krimeve të tjera, policia kryen analiza gjenetike. Përse? Për të gjetur dëshmi të kontaktit midis dy njerëzve, dy objekteve apo një personi dhe një objekti. Ofrimi i dëshmive për një kontakt të tillë shpeshherë është shumë i dobishëm për hetimin.

Por nuk ofron medoemos prova për krimin. Është vetëm një dëshmi mes shumë të tjerave.

Anne Versailles

jashtëm dhe një bërthamë në të cilën gjendet ADN-ja.

Çka është gjenetika?

AND-ja përbëhet nga një numër i gjeneve dhe secili përbëhet nga mijëra "perla". Së bashku këto gjene formojnë kartën gjenetike të identitetit të një personi.

Si zbulohet karta gjenetike e identitetit?

Gjenetistët marrin disa qeliza nga rrënja e flokëve të gjetura tek viktimë, apo nga pështyma që ka mbetur në bishtin e një cigare. I vendosin ato në një produkt i cili shkatëron çdo gjë rreth AND-së së qelizave. Pastaj ata bëjnë të njëjtën gjë me disa analiza të marra nga gjaku i të dyshuarit. Pastaj ADN-ja përgaditet në mënyrë të veçantë për të analizuar. Pas kësaj vendoset në një xhel të veçantë dhe në të kalon rrymë elektrike. Pas disa orëve, dalin shirita të ngjashëm me barkodin (si ato barkodet tek gjërat që blejmë) të cilat ajnë të dukshme nëse ndryshohen me një llambë të veçantë. Barkodi i ADN-së së të dyshuarit krahasohet me atë të flokëve të gjetur tek viktimë.

Mikroskopi në një laborator policie



Ne përbehem nga miliarda qeliza

Çdo qenie e gjallë përbëhet nga shumë qeliza. Qeliza është vërtetë shumë e vogël. Mund të thuhet madje se është mikroskopike sepse mund të shihet vetëm duke përdorur një mikroskop i cili e zmadhon shumë herë. Secila qelizë ka një çip të

Referojuni artikullit të gazetës në faqen tjetër për t'iu përgjigjur pyetjeve të mëposhtme.

Pyetja 1/4

Për të shpjeguar strukturën e ADN-së, autorja flet për varësen me perla. Si ndryshojnë këto varëse me perla nga njëri individ në tjetrin?

- A. Ndryshojnë në gjatësi.
- B. Renditja e perlave është e ndryshme.
- C. Numri i varësive është i ndryshëm.
- D. Ngjyra e perlave është e ndryshme.

Pyetja 2/4

Cili është qëllimi i kutisë me titull "Si zbulohet karta gjenetike e identitetit"?

Për të shpjeguar:

- A. çfarë është ADN-ja.
- B. çfarë është barkodi.
- C. mënyrën e analizimit të qelizave për të gjetur modelin e ADN-së.
- D. mënyrën se si mund të sigurohen prova se ka ndodhur një krim i caktuar.

Pyetja 3/4

Cili është qëllimi kryesor i autores?

- A. Të paralajmërojë.
- B. Të dëfrejë.
- C. Të informojë.
- D. Të bindë.

Pyetja 4/4

Në fund të hyrjes (pjesa e parë e errët) shkruhet: “Por si ta dëshmojmë?” Sipas paragrafit, hetuesit përpiqen t’i gjejnë një përgjigje kësaj pyetje duke:

- A. marrë në pyetje dëshmitarë.
- B. kryer analiza gjenetike.
- C. e pyetur të dyshuarin deri në imtësi.
- D. iu kthyer sërish rezultateve të hetimit.

Vendoset në një kështjellë pranë plazhit në Itali.

AKTI PARË

Dhomë luksoze mysafirësh në një kështjellë shumë të bukur pranë plazhit. Derë në të djathtë e në të majtë. Dhoma e vendosur në mes të skenës: një divan, tavolinë dhe dy fotelje. Dritare të mëdha nga ana e pasme. Natë me yje. Në skenë terr. Kur ngritet perdja, dëgjojmë që njerëzit zëshëm po bisedojnë pas derës në të majtë. Hapet dera dhe hyjnë tre zotërinj. Njëri menjëherë e hap dritën. Ata shkojnë në qendër në qetësi dhe qëndrojnë rreth tavolinës. Ata ulen së bashku, Gali në foteljen në të majtë, Turai në atë në të djathtë, Adami në divanin në mes. Qetësi shumë e gjatë, pothuajse e pakëndshme. U rehatuan mirë. Qetësi atëherë:

Gali

Pse je aq i menduar?

Turai

Po mendoj se sa e vështirë është të fillojë shfaqja. Të inkuadrohen të gjithë personazhet kryesor në fillim, kur gjithçka fillon.

Adami

Supozoj duhet të jetë vështirë.

Turai

Ashtu është – djallëzisht vështirë. Shfaqja fillon. Publiku është i qetë. Aktorët hyjnë në skenë dhe fillon mundimi. Kjo është përjetësi, ndonjëherë madje një çerek ore para se publiku të zbulojë se kush është kush dhe çka iu përgjigjet.

Gali

Keni një tru mjaftë të pazakonshëm. Nuk mund ta harroni profesionin tuaj as një minutë?

Turai

Kjo është e pamundur.

Gali

Nuk kalon as gjysëm ore pa diskutuar për teatrin, aktorët, shfaqje. Ka edhe punë të tjera në këtë botë.

Turai

S'ka. Unë jam dramaturg. Ky është mallkimi im.

Gali

Ju nuk duhet të bëheni një rob i tillë i profesionit tuaj.

Turai

Në qoftë se nuk e mposhtni, ju jeni rob itij. Nuk ka nivel të mesëm. Më beso, nuk është asnjë lloj shakaje të fillojë mirë shfaqja. Ky është një nga problemet më të vështira të mekanikës skenike. Menjëherë inkuadrimi i karaktereve tuaj. Ta shikojmë këtë skenë këtu, të tre ne. Tre zotërinj në smoking. Thonë që nuk nuk hyjnë në këtë ambient në këtë kështjellë zotëri, por më shumë në skenë, kur fillon shfaqja. Do të duhet të bisedojnë për tema të tëra jointeressante derisa të të paraqitet dikush se kush jemi ne. A nuk do të ishte më lehtë të fillohet me atë që do të ngritemi dhe do të prezantohemi? Ngritet. Mesditë e mirë. Të tre ne jemi mysafirë në këtë kështjellë. Sapo arritëm nga dhoma e bukës ku patëm një darkë të shkëlqyer dhe pimë dy shishe shampanjë. Unë quhem Sindor Turai, jam dramaturg, tridhjetë vjet shkruaj shfaqje, ky është profesioni im. Pikë. Ti e ke radhën.

Gali

Ngritet. Unë jam Gali, po ashtu jam dramaturg. Edhe unë shkruaj shfaqje, të gjithë nga shoqëria e këtij zotërisë. Na jemi duo e njohur dramaturgjike. Lexojnë të gjitha reproduksionet e komedive të mira dhe operetave: të shkruara nga Gali dhe Turai. Gjithsesi, ky është profesioni im.

Gali dhe Turai

Bashkë. Dhe ky zotëria i ri ...

Adami

Ngritet. Ky njeri i ri është, nëse më lejoni, Albert Adami, njëzet e pesë vjeç, kompozitor. E kam shkruar muzikën për të këtillë xhentëlmenë për operetën e tyre më të fundit. Kjo është puna ime e parë për në skenë. Këta dy engjëj më të vjetër më zbuluan dhe tani, me ndihmën e tyre, do doja të bëhem i famshëm. Ata më ftuan në këtë kështjellë. Ata ma bënë mantelin dhe smokingun e veshur. Me fjalë të tjera, unë jam i varfër dhe i panjohur, tani për tani. Përveç kësaj, unë jam jetim dhe gjyshja ime më ka rritur. Gjyshja ime vdiq. Tani jam i vetëm në këtë botë. Nuk kam emër nuk kam para.

Turai

Por ti je i ri.

Gali

Dhe i talentuar.

Adami

Dhe i dashuruar në solistin.

Turai

Nuk duhej ta shtojë këtë. Të gjithë në publikë do ta kuptonin këtë...

Të gjithë u ulën.

Turai

E tani, a nuk do të ishte kjo mënyra më e thjeshtë për të nisur shfaqja?

Gali

Nëse do të na lejohej ta bënim këtë, do të ishte lehtë të shkruhen shfaqje.

Turai

Më besoj, nuk është aq vështirë. Vetëm mendoni në tërë këtë punë si...

Gali

Mirë, mirë, mirë, vetëm mos filloni përsëri të flasim për teatrin. Unë jam i kënaqur nga kjo. Do të bisedojmë nesër, nëse doni.

"Shfaqja" është fillimi i shfaqjes së dramaturgut hungarez Ferenc Molnik.

Përdoren "Shfaqja" në dy faqet e mëparshme për t'u përgjigjur në pyetjet në vijim. (Shënoni që numrat në vijë janë dhënë në margjinë të skenarit që t'u ndihmojnë të gjeni pjesët të cilët përmenden në pyetjet).

Pyetja 1/4

Çfarë bënin personazhët në shfaqjen pak ara se të ngritet perdja?

Pyetja 2/4

"Kjo është përjetësi, ndonjëherë madje edhe çerek ore..." (reshti 29-30)

Sipas turait, pse çereku i orës është "përjetësi"?

- A. E gjatë është kohe të presësh nga publiku të rijë i qetë në teatrin e stërmbushur
- B. Siç duket duhet që përgjithmonë për situatën të sqarohet në fillim të shfaqjes.
- C. Gjithmonë duket sikur i duhet shumë kohë dramaturgut të shkruajë në fillim të shfaqjes.
- D. Duket sikur koha ngadalë po kalon kur një ngjarje e rëndësishme po ndodh në shfaqje.

Pyetja 3/4

Një lexues tha: "Adami është me siguri më emocionuesi nga të tre personazhet në kështjellë."

Çfarë mund të thotë lexuesi që ta mbështesë këtë mendim? Përdoreni tekstin që të jepni shkakun e përgjigjes tuaj.

.....

.....

Pyetja4/4



Përgjithësisht, çfarë bën dramaturgu Molnar në këtë fragment?

- A. Ai e tregon mënyrën në të cilën secili protagonist do të zgjidhë problemet e tij.
- B. Ai i detyroi protagonistët e tij të tregojnë se si është përjetësia në një shfaqje.
- C. Ai jep shembull për skenë tpipe dhe tradicionale në hapjen për shfaqje.
- D. Ai i shfrytëzon protagonistët që të realizojë një nga problemet e tij kreative.

PROGRAMI ACOL PËR VAKSINIMIN VULLNETAR KUNDËR GRIPIT

Ju padyshim e dini se gripi mund të godasë shpejt dhe fuqishëm gjatë periudhës së dimrit. Viktimat e tij mbeten për javë të tëra mbërthyer në shtrat.

Mënyra më e mirë për të luftuar virusin është të kesh një trup të shëndetshëm dhe të jesh në formë. Për të ndihmuar sistemin imunitar që të luftojë kundra futjes së virusit këshillohen ushtrimet e përditshme gjimnastikore dhe një regjim ushqimor me përmbajtje të pasur me fruta dhe perime.



ACOL ka vendosur t'i japë personelit të vet mundësinë për t'u vaksinuar kundër gripit duke e quajtur këtë si një masë plotësuese për parandalimin e përhapjes së këtij virusi tinzar. Me kërkesën e ACOL, një infermiere do të kryejë vaksinimin paradite, gjatë orarit të punës, javën e 17 nëntorit. Ky program është falas dhe vlen për të gjithë pjesë tarët e personelit

Pjesëmarrja është e lirë. Nëpunësve, të cilët duan të përfitojnë nga vaksinimi, do t'u kërkohej të firmosin një formular ku të japin pëlqimin e tyre dhe të thonë se nuk vuajnë nga ndonjë lloj alergjie dhe se janë të ndërgjegjshëm për pasojat e vogla dytësore që mund të shkaktojnë vaksinimi.

Sipas treguesve mjekësorë, gripi nuk mund të shkaktohet nga vaksina. Megjithatë, vaksina mund të sjellë disa pasoja dytësore si lodhje, pak temperaturë dhe dhembje të lehta të krahut.

KUSH DUHET TË VAKSINOHET?

Të gjithë personat që dëshirojnë të mbrohen nga virusi.

Vaksina u këshillohet, veçanërisht të gjithë personave të moshuar nga 65 vjeç e sipër. Megjithatë, pa marrë parasysh moshën, vaksina u rekomandohet të GJITHE PERSONAVE që vuajnë nga ndonjë sëmundje kronike, veçanërisht nga çrregullime të zemres, të mushkërive, të rrugëve të frymëmarrjes ose nga diabeti.

Në një mjedis si zyra, të GJITHE anëtarët e personelit rrezikojnë t'i zerë gripi.

KUSH NUK DUHET TË VAKSINOHET?

Personat që janë shumë të ndjeshëm ndaj vezëve, ata që vuajnë nga sëmundje që shoqërohen me temperatura të larta, si edhe gratë shtatzëna.

Nëse jeni duke përdorur barna ose nëse ju ka ndodhur më parë të keni patur reaksion nga ndonjë vaksinë kundër gripit, ju duhet të këshilloheni me mjekun.



Në qoftë se dëshironi të vaksinoheni gjatë javës së 17 nëntorit, jeni të lutur të kontaktoni nëpunësen e personelit, Besa Mero, përpara ditës së premte, 7 nëntor. Data dhe ora do t'ju përcaktohen sipas disponueshmërisë së infermieres, numrit të pjesëmarrësve dhe orëve që i përshtaten shumicës së personelit. Nëse doni të vaksinoheni për këtë dimër, por e keni të pamundur të paraqiteni në orën e caktuar, ju lutemi t'ia bëni të ditur Besës. Nëse ka një numër të mjaftueshëm kandidatësh, mund të organizohet edhe një seancë tjetër vaksinimi. Për më shumë informacion, lutemi të kontaktoni Besën (numri 5577).

Paçi shëndet të mirë!

Besa Mero, nëpunëse e personelit në një ndërmarrje të quajtur ACOL, ka përpiluar lajmërimin e mësipërm për pjesëtarët e personelit të kësaj ndërmarrjeje. Duke u mbështetur te të dhënat e këtij lajmërimi, përgjigjuni pyetjeve që vijojnë.

Pyetja 1/5

Cili nga pohimet në vazhdim përshkruan një aspekt të programit ACOL për vaksinimin kundër gripit?

- A. Gjatë dimrit do të organizohen përditë kurse gjimnastike.
- B. Do të bëhen vaksinat në orarin e punës.
- C. Pjesëmarrësve do t'ju jepet një shpërblim i vogël.
- D. Injeksionet do t'i bëjë një mjek.

Pyetja 2/5

Ne mund të flasim për përmbajtjen e një pjese të shkruar (për atë ç'ka thuhet).

Ne mund të flasim për stilin e saj (mënyra se si është paraqitur).

Besa ka dashur të përdorë një stil miqësor dhe nxitës në lajmërimin e saj.

A mendoni se ajo ia ka arritur kësaj ?

Shpjegoni përgjigjen tuaj duke u bazuar në detaje të caktuar të paraqitjes së këtij lajmërimi, të stilit të të shkruarit, të ilustrimeve dhe elementeve të tjerë grafikë.

.....

.....

.....

Pyetja 3/5

Sipas lajmërimin, nëse doni të mbroheni nga virusi i gripit, vaksina është:

- A. më e efektshme nga ushtrimet fizike dhe nga një regjim ushqimor i përshtatshëm, por ajo paraqet më shumë rrezik.
- B. një ide e mirë, por që nuk mund të zëvendësojë ushtrimet fizike dhe regjimin ushqimor të përshtatshëm.
- C. po aq e efektshme sa edhe ushtrimet fizike dhe regjimi ushqimor i përshtatshëm dhe kërkon më pak impenjim.
- D. pa asnjë interes, nëse do të bëni përditë ushtrime fizike dhe do të ushqeheni si duhet.

Pyetja4/5

Në një nga pjesët e lajmërimit thuhet :

KUSH DUHET TË VAKSINOHET?

Të gjithë personat që duan të mbrohen nga virusi.

Pas nxjerrjes së lajmërimit, një koleg i tha Besës se do të bënte mirë sikur t'i hiqte fjalët «Të gjithë personat që duan të mbrohen nga virusi», sepse ato mund të sillnin çorientim.

A jeni edhe ju të mendimit se këto fjalë mund të sjellin çorientim dhe se ato duhen hequr nga lajmërimi ?

Shpjegoni përgjigjen tuaj.

.....

.....

.....

Pyetja 5/5

Mbi bazën e informacioneve të dhëna në lajmërim, cili prej nëpunësve të mëposhtëm duhet të marrin kontakt me Besën?

- A. Arturi, i magazinës, i cili nuk dëshiron të vaksinohet sepse ka besim të plotë tek imuniteti i tij natyral.
- B. Juli, e sektorit të shitjeve, e cila dëshiron të dijë nëse programi i vaksinimit është i detyrueshëm.
- C. Lola, e shërbimit të postës, e cila dëshiron të vaksinohet për këtë dimër, por që pret një fëmijë pas dy muajsh.
- D. Miri, i sektorit të llogarisë, i cili dëshiron të vaksinohet, por që do të jetë me leje gjatë javës së 17 majit.

PLANI NDËRKOMBËTAR

Rezultatet e Programit për Vitin Financiar 1996

Rajoni i Afrikës Lindore dhe Jugore										
RALJ										
	Egjipt	Etiopia	Kenia	Malavi	Sudan	Tanzani	Ukanda	Zambia	Zimbavi	TOTAL
Rritja e shëndetshme										
Ngritja e qendrave shëndetësore me 4 ose më pak dhoma	1	0	6	0	7	1	2	0	9	26
Punonjës të shëndetit të kualifikuar për 1 ditë	1 053	0	719	0	425	1 003	20	80	1 085	4 385
Fëmijë të cilëve u është dhënë ushqim plotësues > 1 javë	10 195	0	2 240	2 400	0	0	0	0	251 402	266 237
Fëmijë të cilëve u është dhënë ndihmë financiare me kurim shëndetësor/dentar	984	0	396	0	305	0	581	0	17	2 283
Të mësuarit										
Mësues të kualifikuar për 1 javë	0	0	367	0	970	115	565	0	303	2 320
Libra shkolle me ushtrime të blera/të dhuruara	667	0	0	41 200	0	69 106	0	150	0	111 123
Tekste shkollore të blera/të dhuruara	0	0	45 650	9 600	1 182	8 769	7 285	150	58 387	131 023
Uniforma të blera/të bëra/të dhuruara	8 897	0	5 761	0	2 000	6 040	0	0	434	23 132
Fëmijë të ndihmuar me para/me bursa	12 321	0	1 598	0	154	0	0	0	2 014	16 087
Banka shkolle të ndërtuara/të blera/të dhuruara	3 200	0	3 689	250	1 564	1 725	1 794	0	4 109	16 331
Klasa të përhershme të ndërtuara	44	0	50	8	93	31	45	0	82	353
Klasa të riparuar	0	0	34	0	0	14	0	0	33	81
Të rritur që marrin mësim për shkrim e lexim këtë vit financiar	1 160	0	3 000	568	3 617	0	0	0	350	8 695
Vendbanimi										
Kanalizime ose tualete të hapura/të ndërtuara	50	0	2 403	0	57	162	23	96	4 311	7 102
Shtëpi të lidhura me një sistem të ri kanalizimi	143	0	0	0	0	0	0	0	0	143
Puse të hapura/të përmirësuara (ose burime të mbyllura)	0	0	15	0	7	13	0	0	159	194
Gropa të reja të hapura	0	0	8	93	14	0	27	0	220	362
Ndërtim i sistemeve për pastrimin e ujit të pijshëm	0	0	28	0	1	0	0	0	0	29
Riparim/përmirësim i sistemeve të ujit të pijshëm	0	0	392	0	2	0	0	0	31	425
Shtëpi të përmirësuara me projektin PLAN	265	0	520	0	0	0	1	0	2	788
Ngritja e shtëpive të reja për përfituesit	225	0	596	0	0	2	6	0	313	1 142
Salla për komunitetin të ndërtuara ose të përmirësuara	2	0	2	0	3	0	3	0	2	12
Drejtues të komunitetit të kualifikuar për një ose më shumë ditë	2 214	95	3 522	232	200	3 575	814	20	2 693	13 365
Numri i kilometrave rrugë të përmirësuara	1.2	0	26	0	0	0	0	0	53.4	80.6
Ura të ndërtuara	0	0	4	2	11	0	0	0	1	18
Familje që kanë përfutur drejtpërsëdrejti nga mbajtja nën kontroll e erozionit	0	0	1 092	0	1 500	0	0	0	18 405	20 997
Shtëpi që kanë përfutur nga projekti i elektrifikimit	448	0	2	0	0	0	0	0	44	494

Tabela në faqen e mëparshme është pjesë e një raporti të botuar nga PLAN Ndërkombëtar, një organizatë humanitare ndërkombëtare. Ajo jep informacione për punën e PLAN-it në një nga rajonet e veprimit të tij (Afrikën Lindore dhe Jugore). Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme duke iu referuar tabelës.

Pyetja 1/1

Çfarë tregon tabela për nivelin e veprimtarive të PLANIT Ndërkombëtar në Etiopi në vitin 1996, në krahasim me vendet e tjera të rajonit?

- Niveli i veprimtarive në Etiopi ishte i lartë.
- Niveli i veprimtarive në Etiopi ishte i ulët.
- Ishte pothuajse i njëjtë me vendet e tjera të rajonit.
- Ishte i lartë në kategorinë Vendbanimi dhe i ulët në kategoritë e tjera.

Pyetja 2/2

Në vitin 1996, Etiopia ishte një nga vendet më të varfëra në botë.

Duke marrë parasysh këtë fakt dhe të dhënat që jepen në tabelë, si mendoni se mund të shpjegohet niveli i veprimtarive të PLAN NDËRKOMBËTAR në Etiopi në krahasim me veprimtaritë e tij në vendet e tjera?

.....


.....

.....

FORCA E PUNËS

Diagrami i mëposhtëm në formë peme paraqet strukturën e popullsisë aktive për punë të një vendi, domethënë "të popullsisë në moshë për punë". Numri i përgjithshëm i popullsisë së këtij vendi në vitin 1995 ishte rreth 3.4 milionë banorë.

Struktura e popullsisë aktive për punë më 31 mars 1995



Shënime:

1. Numri i njerëzve është shprehur në mijë (000).
2. Popullsia në punë është përcaktuar si tërësia e personave nga mosha 15 deri në 65 vjeç .
3. Personat që “nuk janë në tregun e punës” janë ata që nuk janë në kërkim të një pune ose që nuk janë në gjendje. për punë.

Përdorni informacionin mbi popullsinë aktive për punë të një vendi e dhënë në faqen e mëparshme për t'iu përgjigjur pyetjeve të mëposhtme.

Pyetja 1/4

Cilët janë dy grupet kryesore ku është shpërndarë popullsia në moshë për punë?

- A. Të punësuar dhe të papunë.
- B. Personat në moshë për punë dhe personat që nuk janë në moshë për punë.

- C. Punonjës me kohë të plotë dhe punonjës me orë.
- D. Personat që janë në tregun e punës dhe personat që nuk janë në tregun e punës.

Pyetja 2/4

Sa persona në moshë për punë nuk janë në tregun e punës? (Shkruani numrin e njerëzve, jo përqindjen.)

Pyetja 3/4

Në cilën pjesë të diagramit të degëzuar të "pemës" do të përfshihej secili nga njerëzit (nëse ka), të cilat renditen në tabelën më poshtë?

Vini një "x" për të treguar se në cilën kategori të diagramës bëjnë pjesë personat e mëposhtëm, nëse ka një kategori që iu përshtatet?

Rreshti i parë i tabelës është plotësuar për t'u dhënë si shembull.


	"Në tregun e punës: i punësuar"	"Në tregun e punës: i papunë"	"Nuk janë në tregun e punës "	"Nuk përfshihen në asnjë kategori"
Një kamarier 35 vjeçar që punon me orë	☒	☐	☐	☐
Një biznesmene, 43 vjeç, që punon 60 orë në javë	☐	☐	☐	☐
Një student 21 vjeçar që punon me kohë të plotë	☐	☐	☐	☐
Një burrë 28 vjeç, që, kohët e fundit, ka hequr dorë nga tregtia dhe kërkon punë	☐	☐	☐	☐
Një grua 55 vjeç, që nuk ka punuar kurrë dhe as ka dashur të largohet nga shtëpia	☐	☐	☐	☐
Një gjyshe 80 vjeç, që punon ende disa orë në ditë në tezgën që familja e saj ka ngritur në treg	☐	☐	☐	☐

Pyetja 4/4

Informacioni mbi strukturën e popullsisë aktive paraqitet në formën e një diagrami, por mund të ishte paraqitur edhe me mënyra të tjera, si me anën e një përshkrimi, një grafiku ose një tabelle.

Është zgjedhur diagrama sepse është veçanërisht e përshtatshme për të treguar

- A. ndryshimet me kalimin e kohës.
- B. numrin e përgjithshëm të popullsisë së një vendi.
- C. kategoritë brenda secilit grup.
- D. madhësinë e secilit grup.



Për 14 vjet rresht Qendra e Mjekësisë Sportive e Lionit (Francë) ka studiuar dëmtimet që pësojnë të rinjtë që merren me sport dhe sportistët profesionistë. Studimi ka nxjerrë si përfundim se gjëja më e mirë që mund të bëhet është parandalimi ... dhe këpucët e mira.

Goditje, rrëzime, grisje, prishje...

Tetëmbëdhjetë për qind e sportistëve nga 8 deri në 12 vjeç vuajnë tashmë nga dëmtime të thembrave të këmbëve. Kërci i kavigjës së futbollistëve nuk arrin të reagojë mirë ndaj goditjeve dhe kjo është vërtetë pika e dobët e 25% të profesionistëve. Kërci i kyçit të gjurit, i cili është shumë delikat, dëmtohet gjithashtu në mënyrë të pariparueshme dhe nëse nuk kurohet qysh në fëmijëri (10-12 vjeç), mundet të shkaktojë një mahisje të parakohshme. Nuk i shpëtojnë dëmtimit as kofshët dhe, duke shtuar edhe lodhjen e tepërt,

lojtarët kanë rrezik për frakturë, për shkak të rrëzimeve ose përplasjeve.

Sipas këtij studimi, futbollistët që kanë luajtur më shumë se dhjetë vjet praktikë paraqesin deformime të kockave në kërcë ose në thembra. Është ajo që quhet «këmba e futbollistit», një deformim i shkaktuar nga këpucët me shuall dhe qafa shumë të përkulshme.

Të mbrojtë, të mbajë mirë, të japë stabilitetin e duhur, të amortizojë

Kur janë shumë të forta, këpucët pengojnë lëvizjet. Kur janë shumë të buta, rritet rreziku i plagosjeve ose i ndrydhjeve. Një këpucë

sporti e mirë duhet të plotësojë katër kritere:

Së pari, të mbrojtë nga mjedisi i jashtëm: nga goditjet e topit ose të një lojtari tjetër, të mbrojtë nga terrenet e paniveluara, si dhe të mbajë këmbën të ngrohtë dhe të thatë pavarësisht nga ngricat ose nga shiu.

Ajo duhet ta mbajë mirë këmbën dhe mbi të gjitha kyçin e kavigjës, në mënyrë të tillë që të evitohet ndrydhjet, mahisjet dhe dëmtimet e tjera, madje edhe të gjurit.

Gjithashtu, ajo duhet t'u sigurojë lojtarëve stabilitet të mirë në mënyrë që ata të mos rrëshqasin mbi një terren të lagur ose të mos

pengohen në lëvizje kur
terreni është shumë i thatë.
Së fundi, ajo duhet të
amortizojë goditjet, sidomos

ato që pësojnë lojtarët e
volejbollit dhe të
basketbollit, të cilët
kërcejnë pa pushim.

Këmbët e thata

Pyetja 1/4

Çfarë synon të tregojë autori në këtë tekst ?

- A. Që cilësia e shumë prej këpucëve sportive është përmirësuar mjaft.
- B. Që ia vlen më mirë të mos luash futboll nën moshën 12 vjeç.
- C. Që të rinjtë kanë gjithnjë e më shumë plagë për shkak të gjendjes së tyre jo të mirë fizike.
- D. Që është shumë e rëndësishme për sportistët e rinj që të veshin këpucë sporti të mira.

Pyetja 2/4

Sipas artikullit, përse këpucët e sportit nuk duhet të jenë shumë të forta ?

.....

Pyetja 3/4

Në një pjesë të artikullit thuhet «Një këpucë sporti e mirë duhet të plotësojë katër kritere». Cilët janë këta kritere?

.....

.....

.....

Pyetja 4/4

Shqyrtoni fjalinë në vazhdim, e cila figuron nga fundi i artikullit. Ajo është paraqitur e ndarë në dy pjesë:

«Për të mënjeluar telashet e vogla, por të dhimbshme, si flluskat, enjtjet madje edhe plasaritjet apo mykozat (kërpudha myku) ...»

(pjesa e parë)

«...këpuca duhet të lejojë avullimin e djersës dhe të pengojë futjen e lagështisë nga jashtë.»

(pjesa e dytë)

Cila është marrëdhënia midis pjesës së parë dhe të dytë të fjalisë?

Pjesa e dytë e fjalisë

- A. bie në kundërshtim me pjesën e parë.
- B. përsërit pjesën e parë.
- C. ilustron problemin e përshkruar në pjesën e parë.
- D. jep zgjidhjen për problemin e përshkruar në pjesën e parë.

Mënyra e së ardhmes

Imagjinoni se sa mrekullueshëm është të “telekomunikohet” dhe të punoni në autostradë elektronike, ndërsa e tërë puna të jetë në kompjuter ose në telefon! Tanimë nuk do të duhet të ngecni trupin tuaj në autobusë ose trena të tejmbushur ose të shpenzoni orë e orë duke udhëtuar deri dhe nga puna. Mund të punoni kudo që të dëshironi – vetëm mendoni për të gjitha mundësitë për punë që me këtë do të hapen!

Moli

Katastrofë gjatë bërjes

Shkurtimi i kohës së udhëtimit dhe ulja e shpenzimit të energjisë së kyçur është qartas një ide e mirë. Mirëpo, qëllimi i tillë duhet të arrihet me përmirësimin e transportit publik ose nëpërmjet të sigurimit të vendeve të punës të gjenden pranë vendit ku jetojnë njerëzit. Ideja ambicioze që telekomunikimet duhet të jenë pjesë e secilës mënyrë të jetës, vetëm do t'i detyrojë njerëzit të bëhen gjithnjë e më shumë të fokusuar në veten e tyre. A dëshirojmë me të vërtetë që ndjenja e të qenurit pjesë e komunitetit akoma më shumë të përkeqësohet?

Riçardi

“Telekomunikimi” është term i shpikur nga Xhek Nils i në fillim të viteve 1970-të për të përshkruar situatën në të cilën punëtorët punojnë në kompjuter larg zyrës qendrore (p.sh. në shtëpi) dhe transmetojnë të dhëna dhe dokumente deri te zyra qendrore përmes linjave të telefonit.

Përdoreni

“Telekomunikimi” nga më lartë që të përgjigjeni në pyetjet në vijim.

Pyetja 1/3

Cila është lidhja mes “Mënyrës së të ardhmes” dhe “Katastrofë gjatë bërjes”?

- A. Ata përdorin argumente të ndryshme për të ardhur në konkludimin e njëjtë.
- B. Janë të shkruara në stilin e njëjtë, por bëhet fjalë për tema krejtësisht të ndryshme.
- C. Ata shprehin një pikëpamje të përgjithshme të njëjtë, mirëpo vijnë nga konkludime të ndryshme.
- D. Ata shprehin pikëpamje të kundërta për temën e njëjtë.

Pyetja 2/3

Cila është puna për të cilën do të ishte vështirë të telekomunikohet? Jepni shkakun e përgjigjes tuaj.

.....


.....

Pyetja 3/3

Me cilën deklaratë do të pajtohen Moli dhe Riçardi?

- A. Popullit i duhet lejuar të punojë aq orë sa do.
- B. Nuk është e mirë ideja që njerëzit të kalojnë shumë kohë duke udhëtuar për në punë.
- C. Telekomunikimet nuk do të funksiononin për secilin.
- D. Formimi i marrëdhënieve sociale është pjesa më e rëndësishme e punës.

BALONA



Mbështetu në tekstin “Balona”, dhënë në faqen e mëparshme, për t’ju përgjigjur pyetjeve që vijojnë.

Pyetja 1/4

Vijaypat Singhanian përdori teknologji të gjetura në dy lloje të tjera transporti. Cilët tipa transporti?

1.
2.

Pyetja 2/4

Cili është qëllimi i përfshirjes së vizatimit të një jumbo jet në këtë tekst?

.....

.....

Pyetja 3/4



Përse vizatimi tregon dy balona?

- A. Për të krahasuar përmasat e balonës Singhanias para dhe pasi ajo u fry.
- B. Për të krahasuar përmasat e balonës Singhanias me atë të balonave të tjera me ajër të nxehtë.
- C. Për të treguar se balona Singhanias duket e vogël nga toka.
- D. Për të treguar se balona Singhanias gati sa nuk u përplas me një balonë tjetër.

Pyetja 4/4

Cila është ideja kryesore e tekstit?

- A. Singhanias ishte në rrezik gjatë udhëtimit të tij me balonë.
- B. Singhanias theu një rekord të ri botëror.
- C. Singhanias udhëtoi edhe mbi det edhe mbi tokë.
- D. Balona e Singhanias ishte gjigante.

NDËRTESTAT MË TË LARTA

“Ndërtesat më të larta” është artikulli në një revistë norvegjeze i publikuar në vitin 2006.


Grafiku 1: Ndërtesat më të larta në botë

Grafiku 1 paraqet numrin e ndërtesave prej së paku 30 katesh të cilat janë ndërtuar ose janë në ndërtim. Ai i përfshin të gjitha ndërtesat të cilat janë propozuar nga ...viti 2001.



Grafiku 2: Disa nga ndërtesat më të larta në botë

Pritet që me 700 metrat e saj Kulla Burxh në Dubai, kur të jetë e përfunduar në vitin 2008 të jetë ndërtesa më e lartë në botë.



Me ndihmën e artikullit “Ndërtesat më të larta” nga faqja e mëparshme përgjigjuni në pyetjet në vijim:

Pyetja 1/4

Në kohën kur është publikuar artikulli, cila ndërtesë sipas Grafik-ut 2 ka qenë ndërtesa më e lartë e përfunduar?

Pyetja 2/4

Çfarë tipi të dhënash jep Grafik-u 1?

- A. Krahasimi i lartësive të ndërtesave të ndryshme
- B. Numri i përgjithshëm i ndërtesave në qytete të ndryshme
- C. Numri i ndërtesave mbi një lartësi të caktuar në qytete të ndryshme
- D. Të dhëna për stilet e ndërtimit në qytete të ndryshme

Pyetja 3/4

Radison SAS Plaza Oslo, është e lartë vetëm 117 metër. Pse është përfshirë në Grafik-un 2?

.....

.....

Pyetja 4/4

Parmendoni që për njëzet vjet, të dhënat për ndërtesat e larta janë treguar përsëri në një artikull si ky.

Më poshtë janë dhënë tre karakteristika të artikullit origjinal. Përmendni se a do të ndryshojnë ndoshta këto karakteristika për njëzet vjet duke rrethuar “po” ose “jo” në tabelën më poshtë:

Karakteristikat e artikullit	A thua vallë do të ndryshojnë për njëzet vjet?
Qytetet e paraqitura në Grafiku 1	po /jo
Titulli në Grafiku 1	po /jo
Numri i ndërtesave në Grafiku 1	po /jo

KOPRACI DHE FLORIRI

fabulë nga Ezopi

Një koprrac shiti gjithçka që kishte dhe bleu një copë flori, të cilin e groposi në tokë, në anën e një muri të vjetër. Ai shkonte çdo ditë për ta parë. Një nga punëtorët e tij i vuri re vizitat e shpeshta që ai bënte tek ai vend dhe vendosi ta përgjonte. Shumë shpejt ai zbuloi sekretin e thesarit të fshehur dhe duke gërmuar gjeti copën e floririt dhe e vodhi atë. Kur vajti herën tjetër, koprraci e gjeti gropën bosh dhe filloi të shkulte flokët e të ankohej me zë lë lartë. Një fqinj i tij, kur e pa të mbushur me hidhërim dhe mësoi shkakun, i tha: "Të lutem, mos u mërzit kaq shumë, por shko e merr një gur, vendose në gropë dhe përfytyro sikur floriri është akoma atje. Ai do të jetë njësoj i dobishëm për ty: pasi kur ishte aty, ti nuk e kishe, sepse nuk e përdore asnjëherë."

Përdor fabulën "Koprraci dhe floriri", dhënë në faqen e mëparshme, për t'iu përgjigjur pyetjeve që vijojnë.

Pyetja 1/5

Lexo fjalitë e mëposhtme dhe vendosu atyre numra sipas rrjedhës së ngjarjeve në tekst.

Koprraci vendosi që t'i kthente të gjitha paratë e tij në një copë flori. ☐

Një burrë vodhi floririn e koprracit. ☐

Koprraci gërmoi një gropë dhe fshehu në të thesarin e tij. ☐

Fqinji i koprracit i tha atij ta zëvendësonte floririn me një gur. ☐


Pyetja 2/5

Cili është mesazhi kryesor këtij tregimi?

- A. Mos grumbulloni pasuri që mund të vidhet.
- B. Të kesh besim tek njerëzit e tjerë nuk është në rregull.
- C. Të mos e përdorni atë që keni është njëjtë sikur të mos e keni.
- D. Mos u pikëlloni për atë që s'mund ta ndryshoni.

Pyetja 3/5

Ja një pjesë e një bisede ndërmjet dy njerëzve që kanë lexuar fabulën “Koprraci dhe Floriri i tij”.



Ç'mund të thotë Folësi 2 për të mbështetur këndvështrimin e tij?

.....

.....

Pyetja 4/5

Pse koprraci e groposi arin?

.....

.....

Pyetja 5/5

Si arriti koprraci të kishte një copë floriri?


.....

UDHËTIMI NË AFRIKË

Shetitja në anën veriore të Drakenbergut:

Afrika Jugore /Lesoto

Të dhënat elementare




Pasqyra e përgjithshme

- Udhëtimi në anën veriore të Drakenbergut përfshin kalimin në shpatin verior të Drakenbergut në lartës të madhe mbidetare. Udhëtimi, i cili është i gjatë rreth 65 kilometra, shtrihet përtej kufirit mes Afrikës së jugut dhe Lesotos dhe zgjat 5 ditë të mundimshme. Udhëtimi është plot me atraksione, nga pejzazhi i mrekullueshëm nga Amfiteatri i Dhëmbëve të Djallit teksa po lëviz ndaj Shkallës së Lanxhirit, deri në perëndimin që duket nga Mponjuana, që e bën të vlefshme kurdisjen e orës së zgjimit.
- Nisja: Parkingu Roja në Parkun Nacional Natali Mbretëror
- Kthimi: Hoteli Maja e Katedralës
- Vështirësitë dhe lartësia mbidetare: Kjo është ecje në mal të lartë në një nga rajonet më të largta të masivit malor Drakenberg. Ecja mund të jetë mjaft e mundimshme, kurse ditët e gjata. Duhet orientim i mirë për kalim të sigurt.

MOT DHE SEZON I VOLITSHËM I VITIT

- Muaj të rekomanduar për vizitë: prill, maj, qershor OSE shtator, tetor, nëntor
- Klima: Vera në Drakenberg mund të jetë shumë e nxehtë dhe e lagësht. Dimrat janë mjaft të thatë, por gjithmonë ka mundësi për reshje, shpesh në formë të borës në pjesët e larta. Në pranverë dhe vjeshtë, temperaturat e ditës janë ideale (mes 60°F/15°C dhe 70°F/20°C), por natën ata shpesh bien në pikën e ngrirjes.

Temperaturat dhe reshjet												
Temperatura mesatare ditore më e lartë												
(°F)	72	70	70	66	63	60	60	63	66	68	70	70
(°C)	22	21	21	19	17	15	15	17	19	20	21	21
Temperatura mesatare ditore më e ulët												
(°F)	55	55	54	48	46	41	41	43	46	48	52	54
(°C)	13	13	12	9	8	5	5	6	8	9	11	12
Të rreshura mesatare mujore												
(inç)	9,3	8,5	7,7	3,1	1,1	0,6	0,5	1,3	2,4	4,0	6,5	7,9
(mililitra)	237	216	196	78	29	14	12	33	62	101	165	201
	JAN	SHKU	MARS	PRI	MAJ	QER	KOR	GUS	SHTA	TET	NËNT	DHJET



Teksti “Udhëtimi në Afrikë”, i cili gjendet më lartë dhe në faqen paraprake, është shkëputje nga libri Udhëtimet klasike.

Me ndihmën e tekstit “Udhëtimi në Afrikë”, përgjigju në pyetjet në vijim:

Pyetja 1/4

Në cilën lartësi mbidetare gjendet parkingu Roja? Jepni përgjigjen tuaj në hapa dhe metër:

.....hapa

.....metër

Pyetja 2/4

Sipas informacioneve të mësipërme, ku do të kishit buajtur pas ditës së dytë të ngjitjes në mal?

- A. Në parkingun Garda.
- B. Në shpellën Ifidi.
- C. Në shpellën Ruvanka.
- D. Në shpellën Mponjvane.
- E. Në shpellën Bineqët.
- F. Në hotelin Maja e Katedralës.

Pyetja 3/4

Çfarë mendoni, cila ditë e ngjitjes do të ishte më e vështirë? Sqaroni përgjigjen tuaj duke i përdorur informacionet e dhëna:

.....


.....

Pyetja 4/4

Cilën ditë të udhëtimit në mëngjes mund të shikoje lindjen e diellit në pamjen e përgjithshme?

- A. ditën 1
- B. ditën 2
- C. ditën 3
- D. ditën 4
- E. ditën 5

GJIRI



Teksti “Linjat e metrosë” nga faqja e mëparshme jep informacione për sistemin e hekurudhës nëntokësore, përkatësisht metrosë.

Me ndihmën e tekstit “Linjat e metrosë” përgjigjuni në pyetjet në vijim:

Pyetja 1/ 4

Në cilin stacion të metrosë është e mundur të hipni në autobusët ndërrurban dhe trenat ndërqytetas?

.....

Pyetja 2/ 4

Në qoftëse jeni në stacionin Kopshti zoologjik dhe doni të shkoni në stacionin Ura e gurit, në cilin stacion duhet të kaloni në linjën tjetër?

- A. Kuvendi i qytetit
- B. Bregu i lumit
- C. Gjiri
- D. Limani i vjetër

Pyetja 3/ 4

Disa stacione siç janë Hyrja perëndimore, Kopshti zoologjik dhe Sheshi i pavarësisë janë paraqitur me rrathë gri. Çfarë domethënie kanë rrathët gri për ato stacione?

.....

Pyetja 4/ 4

Duhet të gjeni shtegun më të shkurtër të hekurudhës nëntokësore nga stacioni në rrugën Sato deri në rrugën Forest.

Vizato në hartë rrugën nëpër të cilën do lëvizje.

PUNA NË DISTANCË

Rruga e së ardhmes

Vetëm paramendoni se sa e mrekullueshme do të ishte të shkoni të “punoni në distancë” në autostradë elektronike dhe ta kryeni tërë punën në kompjuter ose telefon! Tanimë nuk duhet të zhubroseni në autobusët ose trenat e tejmbushur ose të humbisni orë duke udhëtuar nga dhe deri në punë. Ju do të mund të punoni kudo që dëshironi – vetëm mendoni për të gjitha mundësitë për punësim që do të hapeshin!

Maja

Katastrofë në horizont

Shkurtimi i orëve të kaluara në udhëtim dhe ulja e konsumit të energjisë që nevojitet është padyshim ide e mirë. Për ta arritur tërë këtë, duhet të përmirësohet transporti publik ose të sigurohen vende pune pranë vendit ku jetojnë njerëzit. Ideja ambicioze që puna nga distanca duhet të bëhet pjesë përbërëse e jetës së secilit, vetëm do të sjellë deri aty që njerëzit të bëhen gjithnjë e më të zënë me veten e tyre. A duam me të vërtetë që të përkeqësohet ndjenja jonë se jemi pjesë e komunitetit?

Roberti

“Puna në distancë” është shprehje e shpikur nga Xhek Nils i në fillim të viteve 1970-ta për të përshkruar formën e punës në të cilën punonjësit punojnë larg nga zyra qendrore (për shembull, në shtëpi) dhe dërgojnë të dhëna dhe dokumente pranë zyrës përmes linjave telefonike.

Me ndihmën e tekstit të përmendur më lartë “Puna në distancë” përgjigjuni në pyetjet në vijim:

Pyetja 1/3

Cila është lidhja mes “Rruga e së ardhmes” dhe “Katastrofë në horizont”?

- A. Ata përdorin argumente të ndryshme për të ardhur në të njëjtin konkludim të përgjithshëm.
- B. Janë të shkruara në stilin e njëjtë, por kanë tema krejtësisht të ndryshme.
- C. Ata shprehin një pikëpamje të përgjithshme të njëjtë, mirëpo vijnë nga konkludime të ndryshme.
- D. Ata shprehin pikëpamje të kundërta për temën e njëjtë.

Pyetja 2/3

Përmendni një punë e cila do të jetë vështirë të kryhet me punën në distancë? Sqaroni përgjigjen tuaj:

.....

.....

Pyetja 3/3

Me cilën nga këto deklaratat do të pajtoheshin **që të dy**, Maja edhe Roberti?

- A. Njerëzve iu duhet lejuar të punojnë aq orë sa të duan.
- B. Nuk është e mirë që njerëzit të kalojnë shumë kohë duke udhëtuar për në punë.
- C. Puna në distancë nuk do të ishte adekuate për secilin.
- D. Vendorsja e marrëdhënieve sociale është pjesa më e rëndësishme e punës.

PJESA A

Tukididi është historian dhe ushtar i cili ka jetuar në shekullin e pasë para erës së re, në kohën e periudhës klasike greke. Ka lindur në Athinë. Gjatë kohës së luftës së Peloponezit mes Athinës dhe Spartës (nga 431 deri 404 p.e.r.), ai ka komanduar me flotën detyra e së cilës ishte ta mbrojë qytetin Amfipolis në Thraki. Ai nuk ja kishte dalë të mbërrijë në kohë në qytet. Qyteti kishte rënë në duart e Brazidës, gjeneral i Spartës, i cili e kishte dëbuar Tukididin në njëzet vjet ekzil. Kjo i dha mundësi të mbledhë të dhëna të hollësishme nga të dyja anët ndërluftuese dhe mundësi të realizojë një studim për punën e tij *Historia e Luftës së Peloponezit*.

Tukididi konsiderohet si një nga historianët më të mëdhenj të kohës antike. Ai e përshkruan zhvillimin e historisë duke u fokusuar te shkaqet natyrore dhe sjelljet e secilit individ, në vend të fatit ose mediacionit të perëndive. Në veprën e tij, faktet nuk janë sqaruar si anegdota të zakonshme, por si përpjekje të zbulohen shkaqet që i çuan protagonistët kryesorë të veprave në atë mënyrë siç kishin vepruar. Për shkak të rëndësisë që ia kushtonin sjelljes së individëve, Tukididi nganjëherë inkadron fjalime të trilluara – ata e ndihmojnë që t'i sqarojë motivet e figurave historike.

PJESA B

Fjalimin vijues për nder të ushtarëve të vrarë në vitin e parë të Luftës së Peloponezit, Tukididi ia përshkruan sundimtarit të Athinës, Periklit (shekulli pesë p.e.r):

Sistemi ynë i udhëheqjes nuk i imiton ligjet e shteteve fqinje; ne jemi shembull për të tjerët në vend se të jemi imitues. Sistemi ynë quhet demokraci, sepse udhëheqja nuk varet nga pakica, por nga shumica. Ligjet tona u japin të gjithëve të drejta të barabarta në jetën private, ndërsa autoriteti në jetën publike varet nga merita, e jo nga statusi social.

Po ashtu, statusi social nuk e pengon askënd të vijë në çfarëdo pozite publike (...). Njëjtë siç nuk po përzihemi në jetën private, ne nuk i shkelim ligjet kur bëhet fjalë për çështjet publike. Ne i dëgjojmë ata që i kemi vënë në pushtet dhe i repektojmë vetë ligjet, posaçërisht ata që kanë të bëjnë me mbrojtjen e të shtypurve dhe ato ligje të pashkruar shkelja e së cilëve është turp i përgjithshëm.

Përveç kësaj, ne sigurojmë shumë mundësi për kënaqësitë e shpirtit. Gjatë tërë vitit festojmë me lojëra dhe sakrifica, ndërsa sofistikimi i shtëpive tona është burim i përditshëm i kënaqësisë që na ndihmon të shmangim të gjitha brengat; ndërsa shumë banorë mbajnë në Athinë produkte nga e gjithë bota, kështu që Athinasit i dinë frytet e shteteve të tjera, si dhe të tyre.

*Tukididi, Historia e Luftës së Peloponezit
(e adaptuar)*

Përdorni tekstin “Demokracia në Athinë” nga faqja e mëparshme për t’u përgjigjur në pyetjet në vijim:

Pyetja 1/5

Pse ishte dëbuar Tukididi në ekzil?

- A. Ai nuk ia doli që t'u sjellë fitoren Athinasve tek Amfipolisi.
- B. Ai mori komandën me flotën në Amfipolis.
- C. Ai kishte mbledhur të dhëna nga të dyja palët ndërluftuese.
- D. I kishte lënë Athinasit të luftojnë kundër Spartanëve.

Pyetja2/5

Një nga qëllimet e fjalimit në pjesën B ishte t'u bëhej homazh ushtarëve të cilët kanë vdekur në vitin e parë të Luftës së Peloponezit.

Cili është qëllimi TJETËR i atij fjalimi?

.....

.....

Pyetja 3/5

Kush e ka shkruar fjalimin nga pjesa B? Sqaroni përgjigjen tuaj duke iu referuar tekstit:

.....

.....

Pyetja 4/5

Sipas tekstit, si dallohej Tukididi nga historianët e tjerë nga koha e tij?

- A. Ai shkruante për njerëzit e rëndomtë, jo për heronjtë.
- B. Ai përdorte anegdota në vend që të përdorte vetëm fakte.
- C. Ai i sqaroi ndodhitë historike duke shkruar për shkaqet e tyre mbinatyrore.
- D. Ai ishte i fokusuar në shkaqet që i çuan njerëzit të silleshin në atë mënyrë siç kishin vepruar.

Pyetja 5/5

Shikojeni këtë pjesë të tekstit, i cili është në fund të pjesës B:

“Përveç kësaj, ne sigurojmë shumë mundësi për kënaqësitë e shpirtit. Gjatë tërë vitit festojmë me lojëra dhe sakrifica, ndërsa sofistikimi i shtëpive tona është burim i përditshëm i kënaqësisë që na ndihmon të shmangim të gjitha brengat”.

Cila nga fjalitë vijuese më së miri e përmbledh atë pjesë të tekstit?

- A. Sistemi drejtues i Athinës ua mundëson të gjithë njerëzve të sjellin ligje.
- B. Pushimi dhe bukuria janë pjesë përbërëse e jetës luksoze që mund të bëhet në Athinë.
- C. Athinasit jetojnë tepër kot dhe nuk mund ta kuptojnë jetën seriozisht.
- D. Jeta private dhe publike konsiderohen si gjë e njëjtë.

DESTINACIONI BUENOS AIRES

Dhe kështu, tre avionë postar nga Patagonia, Kili dhe Paraguaji po ktheheshin nga jugu, perëndimi dhe veriu. Atje i priste ngarkesa që rreth mesnatës të ngrihet avioni për në Evropë.

Tre pilotë, secili pas trupit të motorit të rëndë tërheqës, të humbur gjatë natës, patën menduar për fluturimin e tyre dhe duke iu afruar qytetit të stërmadh, kishin dashur që ngadalë të aterrojnë nga qielli i trazuar ose i qetë, si fshatarë të çuditshëm që zbresin nga mali i tyre.

Rivieri, i cili ishte përgjegjës për tërë procesin, ecte para-mbrapa në pistën e Buenos Airesit. Ai qëndronte i heshtur, sepse derisa erdhën tre avionët, dita e tij që e mbushur me ndjenjë tmerri. Nga minuta në minutë, teksa telegramet vinin te ai, Riveri ndjeu që ai ka fituar edhe në një betejë kundër fatit, duke e zvogëluar të panjohurën dhe ta nxjerrë ekuipazhin e tij nga nata, në breg.

Njëri nga punëtorët pat ardhur te Rivieri dhe i kishte dhënë një radio mesazh:

Posta e Kilit njofton se i kanë parë dritat e Buenos Airesit.

Mirë.

Për një çast Riveri do ta dëgjonte atë avion; këtë natë ai e kishte dorëzuar një prej tyre, njëjtë siç deti, i fryrë nga batica dhe sekretet, e dorëzonte në breg pasurinë që shpërndahej rrethepërqark aq gjatë. Dhe më vonë do t'ia dorëzojnë edhe dy të tjerët.

Atëherë ai do ta mbarojë punën e sotme. Atëherë punëtorët e raskapitur do të shkojnë në pushim dhe do të zëvendësohen me ekuipazh të pushuar. Mirëpo, Rivera nuk do të ketë pushim: posta nga Evropa edhe njëherë do ta mbush me frikë. Dhe gjithmonë do të jetë kështu. Gjithmonë.

AntoinedeSaint-Exupéry.VoldeNuit.©ÉditionsGallimard

“Destinacioni Buenos Aires” nga faqja e kaluar është fragment nga romani i shkruar në vitin 1931. Romani bazohet në përvojën e autorit si pilot i postës në Amerikën e Jugut.

Përdoreni këtë pasazh për t’u përgjigjur në pyetjet në vijim:

Pyetja 1/5

Cila kohë e ditës zhvillohet në tregim? Mbështeteni përgjigjen tuaj duke e përdorur tekstin:

.....

.....

Pyetja 2/5

Si ndihet Rivier në punë? Sqaroni përgjigjen tuaj duke iu referuar tekstit:

.....

.....

Pyetja 3/5

“Destinacioni Buenos Aires” është shkruar në vitin 1931. A mendoni që Rivier do të ishte njëjtë i brengosur edhe sot? Sqaroni përgjigjen tuaj:

.....

.....

Pyetja 4/5

Çfarë po ndodh me personazhin kryesor në këtë tekst?

- A. Ai përjeton një befasi të pakëndshme.
- B. Ai vendos ta ndryshojë punën.
- C. Pret që të ndodh diçka.
- D. Ai mësoi t’i dëgjojë të tjerët.

Pyetja5/5

Si ngjasojnë nata dhe deti sipas paragrafit të parafundit të tekstit (“Për një çast...”)?

- A. Të dy fshehin se çfarë ka në to.
- B. Të dy janë të zhurmshëm.
- C. Të dy ishin zbutur.
- D. Të dy janë të rrezikshëm për njerëzit.
- E. Të dy janë lutës.



Njoftimi nga faqja e kaluar ishte treguar në një supermarket.

Përdorni njoftimin për t'u përgjigjur në pyetjet në vijim:

Pyetja 1/5

Cili është qëllimi i këtij njoftimi?

- A. Raklamimi i biskotave me krem limoni
- B. Informimi i njerëzve mbi atë se kur janë prodhuar biskotat
- C. T'u jepet njerëzve paralajmërim për biskotat
- D. Sqarim se ku mund të blihen biskotat me krem limoni

Pyetja 2/5

Si quhet fabrika e cila i prodhon biskotat?

.....

Pyetja 3/5

Cili është qëllimi i pjesës nën titullin **Detaje**?

- A. Reklamimi i llojeve të ndryshme të biskotave
- B. Përshkrimi i ofertës speciale të biskotave
- C. Përmendja e përbërësve të biskotave
- D. Sqarim se çfarë nuk është në rregull me biskotat

Pyetja 4/5

Si do të veproje në qoftë se ti do të kishe blerë biskota?

.....

Përse do të veproje ashtu?

Konfirmo përgjigjen tënde me të dhëna nga teksti.

.....

.....

Pyetja 5/5

Pse është përmendur “data e përdorimit” në njoftim?

.....

.....

MOTORI

A jeni zgjuar ndonjëherë me ndjenjën se diçka nuk është në rregull?
Kjo ishte për mua pikërisht një ditë e tillë.
U drejtova në shtrat.
Pak më vonë e tërhoqa perden.
Moti ishte i tmerrshëm – binte shi.
Pastaj shikova në oborr.
Ah po! Atje qëndronte motori.
I thyer njëjtë si natën e kaluar.
Dhe filloi të më dhimbte këmba.

Me ndihmën e tregimit më lartë “Motori” përgjigju në pyetjet në vijim:

Pyetja 1/4

Diçka i ka ndodhur personit në tregim natën paraprake. Çfarë ka ndodhur?

- A. Moti i keq e ka dëmtuar motorin.
- B. Kushtet e këqija të motit e penguan atë person të del jashtë.
- C. Ai person kishte blerë motor të ri.
- D. Ai person kishte përjetuar aksident me motor.

Pyetja2/4

Në vargun e shtatë shkruan: “Ah po!”

Përse personi nga tregimi e thotë këtë?

- A. Ky person ka pasur sukses të arrijë diçka të vështirë.
- B. Ky person tani e kuptoi që dita nuk do të jetë aq e keqe.
- C. Këtij personi iu kujtua se përse i dukej se diçka nuk është në rregull.
- D. Ky person është i lumtur që përsëri e sheh motorin.

Pyetja3/4

“Kjo ishte për mua pikërisht një ditë e tillë”.

Si ishte dita në fund?

- A. E mirë
- B. E keqe
- C. Emocionuese
- D. E mërzitshme

Pyetja4/4

Përse shkrimtari e nis tregimin me pyetje?

- A. Sepse shkrimtari do ta dijë përgjigjen
- B. Që ta bëjë lexuesin kurioz për tregimin
- C. Sepse në këtë pyetje është vështirë të përgjigjet
- D. T'ua rikujtojë lexuesve që diçka e tillë ndodh shpesh

SIGURIA E TELEFONAVE CELULAR

A janë të rrezikshëm telefonat celular?

Përparësia kyçe

Nga fundi i viteve të 90-ta u paraqitën raporte kundërthënëse nga rreziqet mbi shëndetin e telefonave celularë.

Përplasja kyçe

Miliona denarë deri më tani janë investuar në hulumtime shkencore për të studiuar ndikimin e telefonave celular.

Po	Jo
1. Radio valët që i emitojnë telefonat celular mund ta nxehin indin e trupit, që ka veprim të dëmshëm.	Radio valët nuk janë mjaft të fuqishme që të shkaktojnë dëmtim të trupit për shkak të nxehjes.
2. Fushat magnetike të gjeneruara nga telefonat celular mund të kenë ndikim të dëmshëm ndaj punës së qelizave në trupin tonë	Fushat magnetike janë jashtëzakonisht të dobëta, prandaj është pak e sigurt të ketë efekt dëmtues ndaj qelizave në trupin tone.
3. Njerëzit të cilët gjatë kohë flasin në telefon celular, nganjëherë po ankohen nga lodhja, kokëdhimbja dhe humbja e përqendrimit.	Një efekt i tillë kurrë nuk është vënë re gjatë kohës së eksperimenteve laboratorike, prandaj mund të shkaktohen nga faktorë të tjerë në mënyrën bashkëkohore të të jetuarit.
4. Përdoruesit e telefonave celular kanë 2,5 herë rrezik më të madh pr zhvillimin e kancerit të trurit në rajonet pranë veshëve të cilët janë në kontakt me telefonin celular.	Shkencëtarët e pranojnë se nuk është e sigurt që kjo rritje është e ndërlidhur me përdorimin e telefonave celular.
5. Agjencia ndërkombëtare për studimin e kancerit zbuloi lidhje mes paraqitjes së kancerit te fëmijët dhe largpërçuesve elektrik. Si dhe telefonat celular, largpërçuesit elektrik po ashtu rrezatojnë.	Rrezatimi i prodhuar nga largpërçuesit është lloj i ndryshëm rrezatimi, me më shumë energji nga ajo që vjen nga telefonat celular.
6. Radio valët me frekuenca të ngjashme me ata të telefonave celular e ndryshuan shprehjen e gjeneve në format e krimbave.	Krimbat nuk janë krijesa njerëzore, kështu që nuk mund të thuhet me siguri që qelizat tona do të reagojnë në të njëjtën mënyrë.

Në qoftë se përdorni telefon...

<i>Përplasja kyçe</i> <i>Duke pasur parasysh numrin e madh të përdoruesve të telefonave celular, madje edhe efektet e vogla dëmtuese ndaj shëndetit do të mund të kishe pasoja të mëdha ndaj shëndetit publik.</i>	<table> <tr> <th>Sigurisht</th><th>Në asnjë rast</th></tr> <tr> <td>Bisedat le të jenë të shkurtra.</td><td>Mos e përdorni telefonin tuaj celular kur pranimi është i dobët sepse telefonit i duhet fuqi më e madhe për komunikim me stacionin bazë, kështu që radio rrezatimi është më i madh.</td></tr> </table>	Sigurisht	Në asnjë rast	Bisedat le të jenë të shkurtra.	Mos e përdorni telefonin tuaj celular kur pranimi është i dobët sepse telefonit i duhet fuqi më e madhe për komunikim me stacionin bazë, kështu që radio rrezatimi është më i madh.
Sigurisht	Në asnjë rast				
Bisedat le të jenë të shkurtra.	Mos e përdorni telefonin tuaj celular kur pranimi është i dobët sepse telefonit i duhet fuqi më e madhe për komunikim me stacionin bazë, kështu që radio rrezatimi është më i madh.				
<i>Përpëasja kyçe</i> <i>Në vitin 2000, raporti i Stevartit (një raport britanik) nuk zbulon problem shëndetësorë të shkaktuar nga telefonat celular, por rekomandon kujdes, posaçërisht tek të rinjtë, derisa të realizohen studime të mëtejshme. Raporti i ri nga viti 2004 i konfirmoi këto konkluzë.</i>	<table> <tr> <td>Mbajeni telefonin celular larg trupit tuaj kur nuk është aktiv.</td><td>Mos bleni telefona celular të cilët kanë vlerë të lartë "SAR"¹. Kjo do të thotë se rrezaton më shumë.</td></tr> <tr> <td>Bleni telefon celular me "kohë për bisedë" të gjatë. Ka efikasitet dhe më pak rrezatim.</td><td>Mos bleni pajisje mbrojtëse, vetëm në qoftë se kanë qenë të testuara në mënyrë të pavarur</td></tr> </table>	Mbajeni telefonin celular larg trupit tuaj kur nuk është aktiv.	Mos bleni telefona celular të cilët kanë vlerë të lartë "SAR" ¹ . Kjo do të thotë se rrezaton më shumë.	Bleni telefon celular me "kohë për bisedë" të gjatë. Ka efikasitet dhe më pak rrezatim.	Mos bleni pajisje mbrojtëse, vetëm në qoftë se kanë qenë të testuara në mënyrë të pavarur
Mbajeni telefonin celular larg trupit tuaj kur nuk është aktiv.	Mos bleni telefona celular të cilët kanë vlerë të lartë "SAR" ¹ . Kjo do të thotë se rrezaton më shumë.				
Bleni telefon celular me "kohë për bisedë" të gjatë. Ka efikasitet dhe më pak rrezatim.	Mos bleni pajisje mbrojtëse, vetëm në qoftë se kanë qenë të testuara në mënyrë të pavarur				

¹SAR (shkalla e absorbimit specifik) është masë për sasinë e rrezatimit elektromagnetik që indet e trupit e absorbojnë teksa e përdorni telefonin celular.

Teksti "Siguria e telefonave celular" nga dy faqet e mëparshme është marrë nga një ueb-faqe. Përdoreni tekstin "Siguria e telefonave celular" për t'u përgjigjur në pyetjet në vijim:

Pyetja 1/4

Cili është qëllimi i **detajeve kyçe**?

- A. Të përshkruhen rreziqet nga përdorimi i telefonave celular
- B. Të sugjerohet në atë që vazhdimisht po diskutohet për sigurinë e telefonave celular
- C. Të përshkruhen masat e kujdesit që duhet të ndërmarrin njerëzit të cilët përdorin telefona celular
- D. Të sugjerohet se nuk janë zbuluar probleme shëndetësore të shkaktuara nga telefonat celular

Pyetja2/4

“Vështirë është të provohet që një gjë padyshim shkakton diçka tjetër.”

Cila është marrëdhënia mes këtij pohimi dhe pohimit edhe **po** edhe **jo** nën pikën 4 të tabelës. **A janë të rrezikshëm telefonat celular?**

- A. Kjo e mbështet pohimin “po” mirëpo nuk e provon.
- B. Kjo e provon pohimin “po”.
- C. Kjo e mbështet pohimin “jo” mirëpo nuk e provon.
- D. Kjo tregon që pohimi “jo” është i gabuar.

Pyetja3/4

Mendo për pikën 3 të kolonës Jo në tabelë. Çfarë mund të jetë një nga “faktorët e tjerë” në atë kontekst? Sqaroni përgjigjen tuaj

.....

Pyetja4/4

Studiojeni tabelën me titulin **Në qoftë se përdorni telefon...**

Në cilin nga këto supozime bazohet tabela?

- A. Nuk ka rrezik nga përdorimi i telefonave celular.
- B. Ka një rrezik të provuar lidhur me përdorimin e telefonave celular.
- C. Nuk është e njohur se a ka rrezik nga përdorimi i telefonave celular ose jo, por duhet marrë masa kujdesi.
- D. Nuk është e njohur se a ka rrezik nga përdorimi i telefonave celular ose jo, mirëpo ato nuk duhet përdorur derisa nuk jemi plotësisht të sigurt.
- E. Udhëzimet në kolonën **Sigurisht** janë të dedikuara për ata që seriozisht e kuptojnë rrezikun, kurse udhëzimet në kolonën **Në asnjë rast** janë të dedikuara për të gjithë të tjerët.

NJOFTIM PËR DHURIMIN E GJAKUT



Të dhurosh gjak është diçka shumë e rëndësishme.

Nuk ka asnjë produkt që mund ta zëvendësojë plotësisht gjakun e njeriut. Për këtë arsye dhurimi i gjakut është unik dhe i qenësishëm për shpëtimin e jetëve njerëzore.

Në Francë, çdo vit, rreth 500 000 pacientë përfitojnë nga transfuzioni i gjakut.

Instrumentet për marrjen e gjakut janë sterilë dhe përdoren vetëm një herë (shiringat, tubat, qeset).

Nuk ka asnjë rrezik kur dhuroni gjakun.

Dhurimi i gjakut:

Është një nga llojet e dhurimit të njohura më mirë nga mjekësia dhe zgjat nga 45 minuta deri në 1 orë.

Bashkë me një qese prej 450 ml gjak merren edhe disa kampione të vogla të tij, të cilat testohen dhe kontrollohen paraprakisht.

- Një burrë mund të dhurojë gjak deri në pesë herë në vit, kurse një grua deri në tri herë.
- Dhuruesit mund të jenë nga 18 deri në 65 vjeç.

Midis dhurimeve të gjakut është i detyrueshëm një interval kohor prej 8-javësh.

“Njoftim për Dhurimin e gjakut”, i dhënë në faqen e mëparshme, është një njoftim i marrë nga një faq e franceze e internetit. Mbështetu në “Njoftim për Dhurimin e gjakut” për t’ju përgjigjur pyetjeve që vijojnë.

Pyetja 1/ 3

Cili është qëllimi kryesor “I njoftimit për dhurimin e gjakut”?

- A. T’i inkurajojë njerëzit të dhurojnë gjak.
- B. T’i përshkruajë rreziqet nga dhurimi i gjakut.
- C. Të sqarojë sa ku mund të dhurohet gjak.
- D. Të tregojë se shumë njerëz rregullisht dhurojnë gjak.

Pyetja 2/ 3

Një vajzë tetëmbëdhjetë vjeçare, e cila kishte dhuruar gjak dy herë brenda dymbëdhjetë muajsh, kërkoi të jepte gjak përsëri. Sipas “Njoftim për Dhurimin e Gjakut”, në çfarë kushtesh mund të lejohet ajo të japë përsëri gjak?

.....


.....

Pyetja 3/ 3

Në tekst shkruan: “Pajisja për marrje të gjakut është sterile dhe njëpërdorimshe .” Pse është dhënë ky informacion në tekst?

- A. Që të na bindin se dhurimi i gjakut është i sigurt.
- B. Të potencohet se duhet dhuruar gjak.
- C. Të sqarohet për se do të përdoret gjaku ynë.
- D. Të sigurohen detaje për testet dhe kontrollet.

BIBLIOTEKA



Në këtë faqe ndodhet harta e një biblioteke. Përdoreni atë për t'iu përgjigjur pyetjeve në vazhdim.

Pyetja 1/4

Në shkollë ju kërkohet të lexoni një roman në anglisht. Qarkoni në hartën e bibliotekës seksionin ku mendoni se do të gjeni një libër të përshtatshëm për ta huazuar.

Pyetja 2/4

Rruga më e shkurtër nga hyrja e bibliotekës deri te gazetat kalon pranë:

- revistave.
- sportelit të huazimit.
- seksionit të referencave.

D. seksionit për fëmijë.

Pyetja 3/4

Ku ndodhen Librat e rinj?

- A. Në seksionin artistik.
- B. Në seksionin joartistik.
- C. Pranë hyrjes.
- D. Pranë sportelit të informacionit.

Pyetja 4/4


Shpjegoni pse është zgjedhur ai vend për të vendosur Librat e rinj.

.....

LARJA E DHËMBËVE

A bëhen dhëmbët tanë gjithnjë e më të pastër nëse i lajmë më gjatë dhe më fort me furçë? Kërkuesit britanikë thonë që jo. Në fakt ata kanë provuar shumë alternativa të ndryshme dhe kanë gjetur mënyrën e përkryer për larjen e dhëmbëve. Një larje prej 2 minutash, pa i fërkuar fort dhëmbët, jep rezultatin më të mirë. Nëse i fërkoni fort dhëmbët, dëmtoni smaltin dhe mishrat pa hequr mbeturinat e ushqimit dhe gurëzat.

Bente Hansen, një eksperte për larjen e dhëmbëve, thotë se është ide e mirë ta mbash furçën ashtu siç mban stilografin. “Fillo në një qoshe dhe laj të gjithë rreshtin,” thotë ajo. “Mos harro edhe gjuhën! Mund të përmbajë shumë baktere, që mund të shkaktojnë erën e keqe të gojës.”



„Larja e dhëmbëve” është një artikull i marrë nga një revistë norvegjeze. “Përdor “Larja e dhëmbëve” për t’ju përgjigjur pyetjeve që vijojnë.

Pyetja 1/4

Për çfarë flet artikulli?

- A. Mënyrën më të mirë për të larë dhëmbët.
- B. Llojin më të mirë të furçës së dhëmbëve për përdorim.
- C. Rëndësinë e dhëmbëve të mirë.
- D. Mënyrën me të cilën njerëz të ndryshëm lajnë dhëmbët e tyre.

Pyetja 2/4

Çfarë rekomandojnë kërkuesit britanikë?

- A. Që t’i lash dhëmbët sa më shpesh që të jetë e mundur.
- B. Që të mos e lash gjuhën me furçë.
- C. Që të mos i fërkosh dhëmbët fort.
- D. Që ta lash gjuhën më shpesh sesa dhëmbët.

Pyetja 3/4

Sipas Bente Hansen, pse duhet ta lash gjuhën?

.....

.....

Pyetja 4/4

Pse përmendet stilografi në tekst?

- A. Për të të ndihmuar të kuptosh sesi të mbash një furçë dhëmbësh.
- B. Sepse edhe me stilograf edhe me furçë dhëmbësh fillohet në një qoshe.
- C. Për të të treguar se mund t'i lash dhëmbët në shumë mënyra të ndryshme.
- D. Sepse duhet ta marrësh larjen e dhëmbëve po aq seriozisht sa edhe të shkruarin.

MORELANDI

Biblioteka Moreland, anëtarëve të rinj u jep një fletushkë që tregon kohën e punës. Përdorni fletushkën për t'u përgjigjur në pyetjet e mëposhtme:

KOHA E PUNËS vlen nga 1 shkurti 1998.					
	Biblioteka Brunsvik	Biblioteka Kembel Turnbul	Biblioteka Koburg	Biblioteka Fokner	Biblioteka Glenroj
E diel	13:00 -17:00	Mbyllur	14:00 -17:00	Mbyllur	14:00-17:00
E hënë	11:00 -20:00	11:00 -17:30	13:00 -20:00	11:00-17:30	10:00-17:30
E martë	11:00 -20:00	11:00 -20:30	10:00 -20:00	11:00-20:00	10:00-20:00
E mërkurë	11:00 -20:00	11:00 -17:00	10:00 -20:00	11:00-17:00	10:00-20:00
E enjte	11:00 -20:00	11:00 -17:30	10:00 -20:00	11:00-17:30	10:00-20:00
E premte	11:00 -17:00	11:00 -17:00	10:00 -20:00	11:00-17:00	10:00-17:30
E shtunë	10:00 -13:00	10:00 -13:00	09:00 -13:00	10:00-13:00	09:00-13:00



Rrjeti i bibliotekave

Pyetja 1/2

Sa kohë mbyllet biblioteka Fokner të mërkurën?

.....

Pyetja 2/ 2

Cila bibliotekë është akoma hapur në orën 6 në mëngjes të premten mbrëma?

- A. Biblioteka Kembel Turnbull
- B. Biblioteka Koburg
- C. Biblioteka Fokner
- D. Biblioteka Glenroj
- E. Biblioteka Brunsvik

GARANCIA

Garancia - teksti 1

Video pajisje

Jane Sandanski 89-2/15

Telefoni: 02 2432 123

Faksi: 02 2432 124

<http://www.camerashots.com.mk>

KLIENTI

Sara Sadiku

Rruga 15 numër 10

1000 Shkup

Video pajisje Jane Sandanski 89-2/15 1000 Shkup 02 2432 123		
FATURA 26802	DATA: 18/10/1999	KOHA: 12:10
LLOGARIA195927	SHITËSI: 24 Roberti	REGJ.: 16

PRODUKTI	PËRSHKRIMI	NUMRI SERIK	LISTA	SASIA	NETO	GJITHSEJ	EX
150214	ROLLY FOTONEX 250 3OOM	30910963		1		968,99den.	X
33844	Trekëmbësh			1		190,00den.	X
Llog.transaksionale..... Shuma..... Mbetur				Shuma 1.158,99den			
Kartela kreditore/VISA 1.158,99den.				Gjithsej 1.158,99den			

Ju faleminderit për mirëbesimin!

Në faqen paraprake është fatura të cilën Sara e mori kur e bleu kamerën e re. Më poshtë është paraqitur kartela e garancisë për fotoaparatin. Përdorni këto dokumente për të dhënë përgjigje në pyetjet në vijim:

Pyetja 1/3

Plotësojeni garancinë me ndihmën e të dhënave të llogarisë. Emri dhe adresa e pronarit tanimë janë të regjistruara.

Pyetja 2/3

Sa kohë ka Sara për të kthyer garancinë?

.....

Pyetja 3/3

Fjalët "Ju faleminderit për mirëbesimin!" janë printuar në fund të faturës. Një shkak i mundshëm është sepse duan të jenë të sjellshëm. Cili është shkak tjetër i mundshëm?

.....

Një mbret algjerian me emrin Bauakas dëshironte të dijë nëse është e vërtetë, se në një nga qytetet e tij ka një gjykatës të drejtë, i cili menjëherë e kuptonte të vërtetën dhe se asnjë mashtrues i vetëm nuk mund të fshihej prej tij. Bauakasi e ndërroi veshjen me një tregtar dhe me kalë hyri në qytetin ku jetonte gjyqtari.

Në hyrje të qytetit, mbretit iu afrua një lypës dhe filloi të kërkonte lëmoshë. Duke i dhënë lëmoshë, Bauakas dëshitë shkante më tej, por lypësi e kapi për rrobash.

Çfarë po do? e pyeti Bauakasi.

“A nuk të dhashë para?”

“Ju dhatë lëmoshë,” tha lypësi, “por mëshirohuni akoma - më çoni në kalin tuaj në sheshin e qytetit, kështu që kuajt dhe devetë nuk do të më shtypin”.

Bauakas e uli lypësin pas vetes dhe e çoi në shesh. U ndal me kalin në shesh, mirëpo lypësi nuk donte të zbresë nga kali.

“Ja ku jemi në shesh, përse nuk po zbret?” e pyeti Bauakasi.

“Pse” u përgjigj lypësi. “Kali është i imi. Në qoftë se nuk e dorëzoni kalin, do të duhet të shkojmë në gjykatë” Njerëzit u tubuan rreth tyre dhe i dëgjonin se si po arsyetoheshin, të gjithë bërtitnin:

“Shkoni te gjykatësi, ai do t’ju gjykojë!”

Bauakas shkoi me lypësin te gjykatësi. Në gjykatë kishte edhe të tjerë, kurse gjyqtari i thirrte një nga një. Para se të vinte radha te Bauakasi dhe lypësi, gjykatësi thirri shkencëtarin dhe fshatarin. Ata kishin ardhur në gjykatë për shkak të një gruaje: fshatari pohonte që ishte gruaja e tij, dhe shkencëtari, që ishte gruaja e tij. Pasi i dëgjoji ata, gjykatësi heshti një kohë dhe tha: “Lëreni gruan te unë dhe nesër ejani vetë”. Kur këta u larguan, hyri kasapi dhe vajbërësi. Kasapi ishte i mbuluar me gjak, kurse vajbërësi i lyer me vaj. Kasapi mbante para në dorë, kurse vajbërësi, dorën e kasapit. Kasapi tha: “Bleva vaj nga ky person dhe siç e nxora qesen, për të paguar, ai e kapi dorën time dhe deshi të më vidhte paratë. Paratë janë të miat, ai është një hajdut.

Ndërsa vajbërësi tha: “Kjo nuk është e vërtetë, kasapi erdhi tek unë për të blerë vaj. Teksa e mbushja kavanozin, ai më luti që t’ia thyej vorbën. I nxora paratë, i vendosa në tavolinë, ndërsa ai i mori dhe donte të ikte. Unë e kapa për dore, dhe, ja me të jemi këtu”.

Gjykatësi heshti për një moment dhe më pas tha: “Lërimi paratë këtu dhe kthehuni nesër”.

Kur erdhi radha e Bauakasit, ai tregoi gjithçka siç kishte ndodhur. Gjykatësi e dëgjoji dhe e pyeti lypësin. Lypësi tha: “E gjithë kjo nuk është e vërtetë. Unë po kalëroja nëpër qytet. Ai rinte ulur në tokë dhe më luti që ta marr me mua. E hipa mbi kalë dhe e çova aty ku donte, por ai nuk donte të zbriste, dhe, tha që kali është i tij, e kjo nuk është e vërtetë”. Gjykatësi mendoi për këtë dhe tha: “Lërimi kalin këtu dhe kthehuni nesër”. Të nesërmen u mbledhën njerëzit për të dëgjuar se si do të gjykonte gjyqtari.

Të parët erdhën shkencëtari dhe fshatari.

“Merre gruan” i tha gjyqtari shkencëtarit, “kurse fshatari do të fitojë pesëdhjetë shkopinj.”

Shkencëtari mori gruan e tij, kurse fshatari u ndëshkua menjëherë.

Atëherë gjyqtari e thirri kasapin dhe i tha. “Janë paratë e tua”, duke treguar vajbërësin, urdhëroi: “Jepni pesëdhjetë shkopinj.”

Më në fund e thirri Bauakasin dhe lypësin.

“A e njeh kalin tënd nga njëzet të tjerë?” e pyeti gjykatësi Bauakasin.

“Unë, po” u përgjigj.

“Kurse ti?” e pyeti lypësin.

“Unë, po” u përgjigj lypësi.

“Eja me mua”, i tha gjykatësi Bauakasi.

Ata shkuan në stallë. Bauakasi menjëherë e tregoi kalin e tij mes njëzet kuajve të tjerë. Atëherë gjyqtari e thirri lypësin te stalla dhe e urdhëroi që të tregonte kalin. Lypësi e njohu kalin dhe e tregoi. Atëherë gjyqtari u ul në vendin e tij dhe i tha Bauakasi: “Kali është i juaji, merreni atë, dhe jepni lypësit pesëdhjetë shkopinj”. Pas gjyqit, gjyqtari shkoi në shtëpi, e Bauakasi vajti pas tij.

“Çfarë do”, e pyeti gjyqtari. “Apo nuk jeni i kënaqur me vendimin tim?”

“Jo, unë jam i kënaqur”, tha Bauakasi, “Unë vetëm do të doja ta dija, si e dinit se gruaja ishte e shkencëtarit, dhe jo e fshatarit, se paratë ishin të kasapit, e jo të vajbërësit, dhe se kali ishte i imi e jo i lypësit?”

“Ja se si mësova për gruan: e thirra atë në mëngjes tek unë dhe i thashë:” Derdhni bojë në shishen time të bojës. “Ajo e mori bojën, e lau shpejt shishen, dhe me shkathtësi e derdhte bojën. Kështu që, ajo ishte e mësuar me punën. Sikur të ishte gruaja e një fshatari, ajo nuk do të dinte se si ta bënte këtë punë. Shkencëtari kishte të drejtë për këtë”.

Kështu mësova për paratë: Paratë i futa në një gotë të mbushur me ujë, dhe në mëngjes shikova se a kishte dalë yndyrë në sipërfaqe. Në qoftë se paratë do të kishin qenë të vajbërësit, do të ishin yndyrosur nga duart e tij. Në ujë nuk kishte vaj, kështu që kasapi po tregonte të vërtetën”.

“Ishte më e vështirë të gjykoje për kalin. Lypësi ashtu si ju e tregoi kalin nga njëzet kuajt menjëherë. Por, nuk ju çova të dyve në stallë për të parë nëse e njihni kalin, por për të parë se cilin nga të dy prej jush e njeh kali. Kur ju iu afruat, ktheu kokën, dhe u shtri ndaj jush, ndërsa kur lypsari e preku, i uli veshët dhe ngriti thundrën. Nga kjo mësova se ju jeni pronari i vërtetë i kalit”.

Në këtë çast Bauakasi tha: “Unë nuk jam tregtar, por, mbreti Bauakas.” Unë erdha këtu për të parë nëse atë që thonë për ju është e vërtetë. Unë shoh tani që ju jeni një gjykatës i mençur. Më thuaj se çfarë dëshiron, do të të shpërblej”.

“Nuk më duhen shpërblime”, u përgjigj gjykatësi. “Jam i lumtur që mbreti im më lëvdoi”.

Burimi: “Gjykatësi i drejtë”, Llav Nikollajeviq Tollstoj

Pyetja 1/6

Në fillim të tregimit është shkruar që Bauakasi ka ndërruar rrobat me një tregtar. Pse Bauakasi nuk kishte dëshirë ta njohin?

- A. Ai dëshironte të dijë se a do ta dëgjojnë madje edhe kur është njeri “i rëndomtë”.
- B. Ai planifikonte të paraqitej para gjykatësit i maskuar si tregtar.
- C. Ai dëshironte të maskohej që të mund të lëvizte lirshëm dhe të lozte me vartësit e tij.
- D. Ai ka dashur të shikojë se si gjykatësi zakonisht e kryen punën pa qenë nën ndikimin e prezencës së mbretit.

Pyetja 2/6

Si e dinte gjyqtari, se gruaja është e shkencëtarit?

- A. Duke e parë pamjen e saj, ai përfundoi se ajo nuk ngjason me gruan e një fshatari.
- B. Pra, shkencëtari dhe fshatari i rrëfyn tregimet e tyre në gjyq.
- C. Pra, ajo reagonte para fshatarit dhe shkencëtarit.
- D. Duke i testuar shkathtësitë e saj në punën që kryente për bashkëshortin e saj.

Pyetja 3/6

A mendoni se gjykatësi ishte “fer” kur shqiptonte dënime TË NJËJTA për të gjitha veprat penale? Sqaroni përgjigjen tuaj duke përmendur ngjashmëritë dhe dallimet mes tre rasteve në tregim:

.....

.....

.....

.....

Pyetja 4/6

Për çfarë bëhet fjalë në tregim?

- A. Për krime serioze.
- B. Për gjykim të mençur.
- C. Për sundimtarin e mirë.
- D. Për truk të zgjuar.

Pyetja 5/6

Në lidhje me këtë pyetje duhet t’i krahasoni ligjet dhe gjyqësinë në vendin tuaj dhe gjyqësinë e paraqitur në tregim.

Veprat e këqija në tregim dënohen. Përmendni edhe një mënyrë në të cilën ligjet dhe gjyqësia në vendin tuaj janë të NGJASHME me ligjet dhe gjyqësinë e paraqitur në tregim?

.....

.....

Në tregim, gjykatësi për të gjitha krimet i gjykoi me nga pesëdhjetë shkopinj. Përveç llojit të dënimit, në ç'mënyrë ligjet dhe gjyqi në vendin tuaj janë NDRYSHE nga ligjet dhe gjyqi në tregim?

.....

.....

Pyetja 6/6

Cili nga zhanret letrare i përgjigjet më mirë këtij tregimi?

- A. Tregim popullor
- B. Udhëpërshkrim
- C. Tregim historic
- D. Tragjedi
- E. Komedi

ME SHIJE TË KEQE

Nga: Arnold Jago

A e dinit se në vitin 1996 konsumonim pothuaj të njëjtën sasi të çokollatës sa qeveria jonë shpenzonte jashtë vendit për të ndihmuar të varfrit? A mos ka diçka që nuk shkon me prioritetet tona? Çfarë po bën ti për këtë?

Po, ty po të pyes!

Arnold Jago, Mildura

Burimi: Gazeta "The Age", Melburn, Australi, 1 prill 1997.

Letra më sipër është publikuar në një gazetë australiane në vitin 1997. Referojuni letrës për t'iu përgjigjur pyetjeve të mëposhtme.

Pyetja 1/ 2

Qëllimi i Arnold Jagos në letër është të nxisë:

- A. faj.
- B. dëfrim.
- C. frikë.
- D. kënaqësi.

Pyetja 2/2

Çfarë lloj reagimi apo veprimi mendoni ju se do të dëshironte Arnold Jago që të shkaktonte letra e tij?

.....

.....

.....

PRINDËRIT NUK DINË PËR DHUNËN NË SHKOLLË

Sipas studimit të Ministrisë së Arsimit të publikuar të mërkurën, vetëm një nga tre prindër është i vetëdijshëm për dhunën në të cilën janë të përfshirë fëmijët e tyre.

Studimi, i realizuar mes dhjetorit të vitit 1994 dhe janarit të vitit 1995, përfshiu rreth 19 000 prindër, mësimitdhënës dhe fëmijë në shkollat fillore dhe të mesme ku ka ndodhur dhunë.

Ky studim, i pari i këtij lloji i realizuar nga Ministria, përfshin nxënës nga klasa e katër e më lartë. Sipas studimit, 22% e fëmijëve të anketuar nga shkolla fillore deklaruan se ballafaqohen me dhunë fëmijësh, kundrejt 13% e fëmijëve nga paralelet e ulëta në shkollat e mesme dhe 4% e fëmijëve në klasat e larta të shkollave të mesme.

Nga ana tjetër, rreth 26% e fëmijëve në shkollat fillore deklaruan se kanë qenë agresiv ndaj fëmijëve të tjerë, ndërsa kjo përqindje është ulur në 20% për fëmijët në klasat e ulëta të shkollave të mesme dhe në 6% për fëmijët në klasat e larta të shkollave të mesme.

Nga ata që ishin përgjigjur se kanë qenë agresiv ndaj fëmijëve të tjerë, mes 39% dhe 65% prej tyre kanë deklaruar se edhe vetë kanë qenë viktimë e dhunës ndaj fëmijëve në shkollë.

Studimi tregoi se 37% e prindërve të fëmijëve të shkollës fillore të cilët janë viktimë e dhunës në shkollë e dinë për dhunën në shkollë të drejtuar ndaj fëmijëve të tyre. Për prindërit e fëmijëve në klasat e ulëta në shkollat e mesme, ai numër ishte 34%, kurse për prindërit e nxënësve të klasave të larta në shkollë të mesme 18%.

Nga prindërit të cilët dinë për dhunën në shkollë, nga 14% deri 18% kanë thënë se për

dhunën kanë mësuar nga mësimitdhënësi. Sipas studimit, vetëm nga 3% deri 4% e prindërve kanë mësuar për dhunën nga fëmijët e tyre.

Studimi po ashtu tregoi se 42% e mësimitdhënësve në shkollat fillore nuk janë të vetëdijshëm për dhunën në shkollë të drejtuar ndaj nxënësve të tyre. Pjesëmarrja e mësimitdhënësve të tillë ishte 29% në klasat e ulëta të shkollave të mesme dhe 69% në klasat e larta në shkollat mesme.

Kur i patën pyetur për shkaqet e dhunës në shkollë, rreth 85% e mësimitdhënësve kanë përmendur mungesën e mësimit shtëpiak. Si shkak kryesor, shumë prindër veçuan mungesën e drejtësisë dhe dhembshurisë tek fëmijët. Një përfaqësues i Ministrisë së Arsimit tha se rezultatet sugjerojnë që prindërit dhe mësimitdhënësit duhet të kenë kontakte më të afërta me fëmijët që të pengojnë dhunën në shkollë.

Dhuna mes fëmijëve është u bë temë kryesore në Japoni pasi që trembëdhjetëvjeçari Kijoteru Okuçi u var në qytetin Nishio, provinca Aiçi, në vjeshtën e vitit 1994 dhe la një letër në të cilën thuhej se bashkëmoshatarët vazhdimisht e hidhnin në lumin pranë dhe ia merrnin paratë me dhunë.

Vetëvrasja e shkatuar nga dhuna e fëmijëve e nxiti Ministrinë e Arsimit të publikojë raportin për dhunën në shkollë në mars të vitit 1995 në të cilin ata u dhanë udhëzime mësimitdhënësve të sigurohen që dhunuesit nuk vijnë në shkollë.

Burimi: Japonia Times Ltd.,
Tokio, 23 mars 1996





Artikulli në faqen e mëparshme u botua në një gazetë japoneze në 1996. Përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme me ndihmën e artikullit:

Pyetja 1/2

Pse në artikull përmendet vdekja e Kijoteru Okuçit?

Pyetja 2/2

Sa për qind e mësimitdhënësve në secilën lloj shkolle nuk e kishin ditur që nxënësit e tyre kanë qenë viktimë e dhunës në shkollë? Rrethoni përgjigjen (A, B, C ose D) e cila më mirë e ilustron atë!



BLETËT

MBLEDHJA E NEKTARIT

Bletët bëjnë mjaltë për të mbijetuar. Ky është ushqimi kryesor i tyre. Në qoftë se në koshere ka 60 000 bletë, pothuajse një e treta e tyre do të jenë të kyçura në procesin e mbledhjes së nektarit të cilin punëtorët pastaj e shndërrojnë në mjaltë. Një numër i vogël bletësh punojnë si mbledhës ose gjurmues. Ato e gjejnë burimin e nektarit dhe më pas kthehen në koshere që t'u tregojnë bletëve të tjera se ku është.

Bletët që gjurmojnë i njoftojnë bletët e tjera se ku është burimi i nektarit duke realizuar vallëzimin me të cilin dërgojnë informacione për drejtimin dhe distancën që bletët duhet ta kalojnë. Gjatë kohës së këtij vallëzimi, bleta tund pjesën e pasme nga njëra në anën tjetër teksa po lëviz në rrathë në formë të numrit 8. Vallëzimi zhvillohet sipas modelit të paraqitur në figurën më poshtë:




Figura paraqet bletën e cila vallëzon në koshere nga ana vertikale e hojes. Në qoftë se pjesa e mesme e numrit 8 është e drejtuar lartë, kjo do të thotë se bletët mund të gjejnë ushqim në qoftë se fluturojnë direkt ndaj Diellit. Në qoftë se pjesa e mesme e numrit 8 tregon djathtas, ushqimi është djathtas nga Dielli.

Distanca e ushqimit nga kosherja është e shënuar me gjatësinë e kohës kur bleta e tund pjesën e pasme. Në qoftë se ushqimi është pothuajse afër, bleta për shkurt kohë e tund prapancën. Në qoftë se është larg, më gjatë kohë e tund prapancën.

PRODHIMI I MJALTIT

Kur bletët fusin nektarin në koshere, ata ua dorëzojnë punëtorëve. Punëtorët e përhapin nektarin në nofullën e poshtme, duke ia ekspozuar ajrit të thatë të ngrohtë të kosheres. Gjatë kohës së mbledhjes së parë, nektari përmban sheqer dhe minerale të përziera me rreth 80% ujë. Pas dhjetë deri njëzet minutash, kur pjesa më e madhe e ujit të tepërt avullon, punëtorët e vendosin nektarin në hoje ku

vazhdon avullimi. Pas tre ditësh, mjalti në hoje përmban rreth 20% ujë. Atëherë bletët i mbulojnë hojet me kapakë të bërë nga dylli i bletës.

Në çdo kohë, bletët në koshere zakonisht mbledhin nektar nga lule të llojit të njëjtë dhe në rajonin e njëjtë. Disa nga burimet kryesore të nektarit janë drurët e pemëve, tërfili dhe drurët lulorë.

FJALOR

punëtor: bletë që punon në koshere

mandibula: pjesë e nofullës

Pyetja 1/4

Cili është qëllimi i vallëzimit të bletëve?

- A. Festë për suksesin në prodhimin e mjaltit.
- B. Të tregojnë se çfarë bime kanë gjetur gjurmuesit.
- C. Festë për lindjen e bletës amë të re.
- Ç. Të tregojnë se ku bletët gjurmuese kanë gjetur ushqim.

Pyetja 2/4

Shkruaj tre burimet kryesore të nektarit:

- 1.
- 2.
- 3.

Pyetja 3/4

Cili është dallimi kryesor mes nektarit dhe mjaltit?

- A. Proporcioni i ujit në substancë.
- B. Përmbajtja e ujit në raport me mineralet në substancë.
- C. Tipi i bimës nga e cila është mbledhur substanca.
- D. Lloji i bletës e cila e përpunon substancën.

Pyetja 4/4

Çfarë bën blea gjatë kohës së vallëzimit për të treguar se sa larg është ushqimi nga kosherja?

.....

.....

HYRJE

Teknologjia krijon nevojën për rregulla të reja

SHKENCA ka prirjen t'u dalë përpara ligjeve dhe etikës. Kjo është vërtetuar në mënyrë spektakolare me shkatërrimin e jetës nga shpërthimi i bombës atomike, më 1945, dhe po vërtetohet sërish me krijimin e jetës me anën e teknikave që kanë si qëllim të luftojnë sterilitetin tek njerëzit.

Shumica nga ne, së bashku me familjen angleze Braun, u gëzuan kur lindi Luiza, bebja e parë nga epruveta. Po ashtu, ne jemi mrekulluar përpara njërës prej arritjeve më të mëdha të para pak kohëve, lindjes së bebeve që gëzojnë shëndet të plotë prej embrioneve të ngrira, të cilat u prit momenti i volitshëm për t'i implantuar tek nëna e ardhshme.

Ishin pikërisht dy embrione të ngrira që ngritën një furtunë çështjesh juridike dhe etike në Australi. Këta embrione duhet të implantoreshin në uterusin e Elsa Rios, gruas së Mario Rios. Një implantim i mëparshëm kishte dështuar dhe çifti Rios dëshironte të provonte sërish nëse mund të bëhej me fëmijë. Mirëpo ata vdiqën në një aksident avioni pa arritur ta bënë edhe një herë provën.

Çfarë duhej të bënte spitali australian me embrionet e ngrira ? A mund t'i vendoste në uterusin e një gruaje tjetër ? Vullnetaret ishin të shumta. A kishin këta embrione të drejta ligjore mbi pasurinë e madhe të çiftit Rios? Apo duhej që embrionet të shkatërroheshin? Çifti Rios, siç mund të kuptohet, nuk kishte marrë asnjë vendim për sa i përket të ardhmes së këtyre embrioneve.

Australianët krijuan një komision për ta studiuar këtë çështje. Javën që shkoi, ky

komision publikoi raportin e tij. Sipas anëtarëve të tij, embrionet duhej të shkriheshin, sepse dhurimi i tyre personave të tjerë do të kërkonte dhënien e pëlqimit nga ana e «dhuruesve» ; mirëpo ky pëlqim nuk ishte dhënë. Për më tepër, komisioni pohon se embrionet, në gjendjen e tyre aktuale, nuk kanë as jetë, as të drejta dhe se ato mund të shkatërrohen.

Anëtarët e komisionit ishin të ndërgjegjshëm se ndodheshin në një terren të vështirë për nga pikëpamja ligjore dhe etike. Për këtë shkak, ata kërkuar një afat prej tre muajsh për t'i dhënë mundësinë publikut të reagojë ndaj rekomandimeve të komisionit. Nëse shkatërrimi i embrioneve do të shkaktojte një protestë të përgjithshme, komisioni do ta rishikonte pozicionin e tij.

Qysh atëherë, çiftet që regjistrohen në programin e fekondimit in vitro të spitalit Queen Victoria në Sidnej, duhet të saktësojnë se ç'duhet të bëhet me embrionet e tyre nëse ju ndodh ndonjë gjë.

Kjo garanton se një situatë e ngjashme me atë të Rios-ve nuk do të ndodhë më. Por ç'ndodh me çështje të tjera të ngatërruara ? Në Francë, një grua i ka kërkuar kohët e fundit gjykatës autorizimin për të lindur një fëmijë me ndihmën e spermës së ngrirë të burrit të saj të vdekur. Si duhet vepruar me një kërkesë të tillë? Dhe ç'duhet bërë nëse një nënë bartëse nuk e respekton kontratën e saj të shtatzanisë dhe refuzon ta japë fëmijën, të cilin ajo ka premtuar ta lindë për dikë tjetër?

Deri më sot shoqëria jonë nuk ka arritur të krijojë rregulla për të kufizuar fuqinë shkatërruese të bombës atomike. Ne po vjelim tashmë frytet e këtij dështimi. Mundësitë për ta përdorur shkencën kuturu, për të shpejtuar

ose ngadalësuar procesin e krijimit të embrioneve, janë të shumta. Është e nevojshme të vendosen kufizime etike dhe juridike përpara se të jetë tepër vonë.

Mbështetuni në artikullin e titulluar «Teknologjia krijon nevojën për rregulla të reja», dhënë në faqen e mëparshme për t'iu përgjigjur pyetjeve në vazhdim

Pyetja 1/2

Nënvizoni fjalinë ku shpjegohet se çfarë bënë australianët për të arritur të vendosnin se ç'duhej bërë me embrionet e ngrira, të cilat i përkisnin një çifti të vdekur në një aksident avioni.

.....

.....

Pyetja 2/2

Citoni dy shembuj të përmendur në kryeartikull të cilët ilustrojnë se në çfarë mënyre teknologjitë moderne, si ajo e përdorur për implantimin e embrioneve të ngrira, krijojnë nevojën për rregulla të reja.

.....

.....

MAKONDO

Të magjepsur nga tërë ato shpikje fantastike, banorët e Makondos nuk dinin se për çfarë duhet të çuditeshin më parë. Ata e gdhinin për netë të tëra duke soditur llampat e zbehta që ushqeheshin nga një grup elektrogjen, që pati sjellë Aureliano Triste në kohën e udhëtimit të dytë të trenit, me çëf-çëfin e bezdisshëm të të cilit u mësuan me vështirësi vetëm pas një kohe të gjatë. Ata u zemëruan nga imazhet e gjalla që tregtari i pasur Don Bruno Krespi projektonte në teatrin me biletari në formë luani, për shkak të një personazhi, i cili vdiq dhe u varros në një nga filmat, dhe për të cilin u hidhëruan pa masë, ndërkohë që papritur ai u shfaq përsëri i gjallë dhe i transformuar në arab në filmin tjetër. Publiku që kish paguar dy centavos për të ndjekur peripecitë e personazheve, nuk mund ta duronte këtë tallje që i bëhej dhe theu të gjitha ndenjëset e kinemasë. Kryetari i bashkisë, i cili u dorëzua përpara ndërhyrjeve të Don Bruno Krespit, u desh të bënte një shpallje publike për të shpjeguar se kinemaja nuk ishte gjë tjetër veçse një makinë me iluzione, e cila nuk i meritonte këto shpërthime pasionante të publikut. Pas këtij shpjegimi zhgënjyes, shumë prej tyre ishin të mendimit se kishin qenë viktima të një biznesi të ri ciganësh shumë spektakolar, kështu që vendosën të mos shkonin më kurrë në kinema, duke menduar se u mjaftonin hallet e tyre dhe s'kishin përse të shqetësoheshin për fatkeqësitë e disa qenieve imagjinare.

Burimi: Gabriel Garsia Marquez, Njëqind vjet vetmi
përkthyer nga spanjollishtja nga Gregory Rabassa
(përshtatur), Pan Books 1978

Teksti në faqen e mëparshme është nxjerrë nga një roman. Në këtë pjesë, tregohet se në qytetin imagjinar të Makondos sapo qenë shfaqur hekurudhat dhe elektriciteti, dhe sapo ishte hapur e para kinema.

Mbështetuni në fragmentin dhe përgjigjuni në pyetjet më poshtë:

Pyetja 1/4

Cili element i filmave i zemëroi banorët e Makondos?

.....

Pyetja 2/4

Në fund të fragmentit, përse banorët e Makondos vendosën të mos shkonin më në kinema?

- A. Ata donin të dëfreheshin dhe të zbaviteshin, por panë që filmat ishin realistë dhe brengosës.
- B. Nuk kishin para për të blerë biletat.
- C. Ata dëshironin t'i ruanin emocionet për ngjarjet e jetës reale.
- D. Ata dëshironin të kënaqnin anën emocionale, por filmat iu dukën të mërzitshëm, fare pak bindës dhe me cilësi të keqe.

Pyetja 3/4

Kush janë “Qeniet imagjinare” për të cilat flitet në dy rreshtat e fundit të pasazhit?

- A. Fantazmat.
- B. Shpikjet në panair.
- C. Personazhet në filma.
- D. Aktorët.

Pyetja 4/4

A jeni në një mendje me gjykimin përfundimtar të banorëve të Makondos në lidhje me vlerën e filmave? Shpjegoni përgjigjen tuaj duke e krahasuar qëndrimin tuaj me qëndrimin e tyre ndaj filmave.

.....

.....

.....

.....

QËNDRIME TË NXËNËSVE

Aq shumë njerëz në botë po vdesin nga uria dhe sëmundjet, kurse ne më shumë brengosemi për përparimin në të ardhmen. Këta njerëz i lëmë anash duke u përpjekur të harrojmë dhe të nisim përpara. Çdo vit, kompanitë e mëdha shpenzojnë miliarda dollarë për eksplorimin e gjithësisë. Në qoftë se paratë e shpenzuara në eksplorimin e gjithësisë do të ishin përdorur për të mirën e varfanjakëve, mund të zbuteshin vuajtjet e miliona njerëzve.

Ada

Sfida për eksplorimin e gjithësisë është burim i frymëzimit për shumë njerëz. Me mijëra vjet ëndërronim për universin, kishim mallë t'i arrijmë dhe prekim yjet, kishim mallë të komunikojmë me diçka ekzistencën e së cilës mund vetëm ta paramendonim, duke u mallëngjyer të dimë...A jemi të vetëm në gjithësi?

Eksplorimi i universit është metaforë e dëshirës për dituri, kurse dëshira për dituri është ajo që e lëviz botën tonë. Ndërsa realistët vazhdimisht na rikujtojnë në problemet aktuale, ëndërrimtarët e lëvizin shpirtin tonë. Dhe, vizionet, shpresat dhe dëshirat e ëndërrimtarëve janë ata që do të na shpiejnë në ardhmëri.

Bardha

Ne i shkatërrojmë pyjet sepse ka naftë poshtë tyre, gërmojmë miniera në vend të shenjtë duke gjurmuar uranium. A do të ishim të gatshëm të shkatërrojmë një planet tjetër që t'i zgjidhim problemet që vetë i shkaktojmë? Sigurisht!

Eksplorimi në gjithësi e përforcon besimin e rrezikshëm se problemet e njeriut mund të zgjidhen me rritjen e dominimit ndaj mjedisit jetësor. Njerëzit akoma do të ndjejnë se kanë të drejtë që t'i keqpërdorin burimet natyrore si lumenjtë dhe pyjet në qoftë se e dinë se gjithmonë ka një planet tjetër aty pranë dhe pret të fillojmë ta eksploatojmë. Kemi bërë mjaft dëme në Tokë. Duhet ta lëmë të qetë universin.

Ditmiri

Burimet natyrore të Tokës shpenzohen shpejtë. Popullata e Tokës rritet me shpejtësi dramatike. Jeta nuk mund të mbahet në qoftë se vazhdojmë të jetojmë në këtë mënyrë. Ndotja shkaktoi vrimë në

mbështjellësin e ozonit. Toka pjellore po zvogëlohet, andaj burimet tona të ushqimit së shpejti do të zvogëlohen. Mbipopullimi tanimë shkaktoi raste të urisë dhe epidemi.

Universi është rajon i madh i shkretë që mund ta përdorim në dobinë tonë. Duke i mbështetur eksplorimet e gjithësisë, një ditë mund të gjejmë planet ku do të mund të jetojmë. Tani kjo tingëllon e paparamendueshme, mirëpo edhe mendimi për të udhëtuar në gjithësi dikur konsiderohej si i perealizueshëm. Ndërprerja e eksplorimit të gjithësisë për zgjidhjen e problemeve aktuale është vizion shumë i kufizuar dhe afatshkurtër. Ne duhet të mësojmë të mendojmë jo vetëm për këtë gjeneratë, por edhe për gjeneratat e ardhshme.

Flori

Injorimi i asaj që mund të ofrojë studimi i gjithësisë do të ishte humbje e madhe për gjithë njerëzimin. Mundësitë për të përfituar një kuptim më të mirë për universin dhe prejardhjen e tij po ashtu janë të shtrenjta për t'u anashkaluar. Eksplorimi i trupave të tjerë qiellor tanimë na ka ndihmuar të bëhemi më të ndërgjegjshëm për problemin e mjedisit dhe të ardhmen që mund ta gjejë Tokën në qoftë se nuk mësojmë të menaxhojmë me aktivitetet tona.

Por, ka edhe dobi të tërthortë nga eksplorimi i gjithësisë, udhëtimet. Përmirësimi i teknologjisë së lazerit dhe metoda të tjera të mjekimit mund t'i adresohen eksplorimit të gjithësisë. Substancat kakoteflon janë fryt i studimeve të njeriut për udhëtimet në gjithësi.

Prandaj, teknologjitë e reja të krijuara për eksplorimin e gjithësisë mund të sjellin dobi të drejtpërdrejtë për të gjithë.

Kaltrina

Tekstet nga dy faqet paraprake janë të shkruar nga nxënës të shkollave të mesme. Përdorni tekstet për t'u përgjigjur në pyetjet vijuese:

Pyetja 1/4

Në cilën nga pyetjet vijuese mendohet se nxënësit sikur janë përgjigjur?

- A. Cili është problemi më i rëndësishëm me të cilin po ballafaqohet bota sot?
- B. A e mbështetni eksplorimin e gjithësisë?
- C. A besoni se ka jetë në planete të tjerë?
- D. Cilët janë ngjarjet më të reja në eksplorimet e gjithësisë?

Pyetja 2/4

Cili prej nxënësve **më drejtpërdrejtë** kundërshton argumentet e Florit?

- A. Ditmiri
- B. Ada
- C. Kaltrina
- D. Bardha

Pyetja 3/4

Duke pasur parasysh mendimet kryesore të shprehura nga pesë nxënësit, me cilin nxënës jeni më shumë dakord? Emri i nxënësit:

Sqaroni zgjedhjen tuaj me fjalët tuaja, duke përmendur mendimin personal dhe mendimet kryesore që ai nxënës i ka theksuar:

.....

.....

.....

.....

Pyetja 4/4

Disa deklarata janë çështje mendimi dhe bazohen në qëndrimet dhe vlerat e personit që i shpreh. Disa pohime janë fakte që mund objektivisht të hetohen dhe provohen që janë të sakta apo të pasakta.

Qarkoni “mendim” ose “fakt” pranë secilit citat të përmendur më poshtë prej teksteve të shkruar nga nxënësit.

I pari është shembull i zgjidhur:

Citat nga tekstet e nxënësve	Mendim apo fakt?
“Ndotja shkakton vrimë në mbështjellësin e ozonit”. (Flori)	mendim /fakt
“Çdo vit, kompanitë e mëdha shpenzojnë miliarda dollarë për eksplorimin e gjithësisë”. (Ada)	mendim /fakt
“Studimi i gjithësisë e përforcon besimin e rrezikshëm se problemet e njeriut mund të zgjidhen me rritjen e dominimit ndaj mjedisit jetësor”.(Ditmiri)	mendim /fakt
“Ndërprerja e eksplorimit të gjithësisë për zgjidhjen e problemeve aktuale është vizion shumë i kufizuar dhe afatshkurtër”.(Flori)	mendim /fakt

UDHËZUES PËR VLERËSIM

Pyetja 1/5

Pikë të plota

D Kodi 1: C. që ta bëjë Amandën ta ndihmojë Princin të harrojë dhimbjen e tij.

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje tjetër

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 2/5

Pikë të plota

Kodi 1: Janë të dhëna në italik. Lejojnë përshkrime jo-teknike. Mund të përmenden në kllapa si dhe në italik.

- Ato janë në italik.
- Me shkrim të pjerrët.
- Si kjo: (Imiton stilin italik.)
- Me dorëshkrim.
- Të shkruajtura me italik poashtu duke përdorur kllapat.
- Ata janë një lloj shkrimi i hollë.

Asnjë pikë

Kodi 0: Jep përgjigje të pamjaftueshme OSE të paqartë.

- Regjia skenike është në kllapa. (Orientimi në kllapa është i saktë për një lloj të regjisë skenike, mirëpo përgjigja nuk i referohet italikut.)
- Janë të shkruajtura me stil të ndryshëm.
- Diçka tjetër.

OSE: përgjigja dëshmon se teksti nuk është kuptuar si duhet ose jepet një përgjigje jo bindëse ose e pavend.

- Janë të bolduara. (Nuk është e saktë)
- Me shkronja të vogla (Nuk është e saktë)
- Nga regjisori. (E pa rëndësishme)

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 3/5

A (Menaxheri i pajisjeve teatrale)

Pikë të plota

Kodi 1: Përmend çantën OSE biçikletën. Mund të citojë frazë nga regjia skenike.

- Çanta e saj e vogël.

- Biçikleta.

Asnjë pikë

Kodi 0: Tjetër

- Zhurma e biçikletës
- Obelisku
- Stoli i rrumbullakët

Kodi 9: Pa përgjigje

B (Tekniku i zërit)

Pikë të plota

Kodi 1: Përmend këngën ose zogun OSE zogjtë (e mbrëmjes) OSE cicërimën OSE zhurmën e biçikletës erën OSE qetësinë. Mund të citojë frazë nga regjia skenike.

- Dëgjohet zhurma e një biçiklete në muzg.
- Mund të dëgjohet vetëm era.
- Zogjtë e mbrëmjes.
- Tani zogjtë e mbrëmjes ia marrin këngës.

Asnjë pikë

Kodi 0: Tjetër

Kodi 9: Pa përgjigje

C (Tekniku i ndriçimit)

Pikë të plota

Kodi 1: Përmend hijet OSE mjegullën e zbehtë OSE në terrin (e plotë) OSE në mbrëmjen

- Vendi është i mbushur me hije.
- Hijet e rënda të pemëve.
- Bie mbrëmja.
- Në ajrin e mbrëmjes.

Asnjë pikë






Kodi 0: Tjetër

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 4/5

Pikë të plota





Kodi 1: Shënon A pranë obeliskut dhe D pas OSE pranë drurëve.



Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje tjetër

Kodi 9: Pa përgjigje



Pyetja 5/5

Pikë të plota

Kodi 1: D. Se Princi nuk e vuri re që Amanda i ngjasonte Leokadias.

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje tjetër

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 1/4

Pikë të plota

Kodi 1: B. të prezantojë mendimin e dikujt për mbishkrimet

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje tjetër

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 2/4

Pikë të plota

Kodi 1: Nxënësi identifikon në mënyrë specifike ose me terma të përgjithshme një ose më shumë lloje dëmsh të përmendura nga Helga: zbehja e emrit të të rinjve; dëmtimi i objekteve mbi të cilët është vizatuatur, dëmi i shkaktuar nga shkatërrimi i shtresës së ozonit.

- Ajo përmend dëmet e shkaktuara ndaj mjedisit.
- Ajo pohon se kështu zbehet emri i të rinjve.
- Ajo beson se vepra të tjera arti janë dëmtuar dhe ky është një dëm.
- Kjo dëmton veprat e artit si për shembull ndërtesat.
- Kjo është kohë e humbur kot për artistët që janë autorë të këtyre vizatimeve.
- Ndërtesat dëmtohen nga mbishkrimet dhe vizatimet. Është interpretuar duke u nisur nga kostoja e këtyre gjerave si objekte arti: p.sh. shëmtimi (kjo duhet dalluar nga kostoja që ka fshirja e mbishkrimeve dhe e vizatimeve, gjë që nuk është objekt i kësaj pyetje).²

Asnjë pikë

Kodi 0: Përsëriten llojet e dëmeve të përmendura në pyetje.

- Fshirja e pikturave të bëra mbi mure kushton shumë shtrenjtë.
- Financimi.
OSE: Përmendet një lloj dëmi për të cilën nuk flitet në tekst.
- Për t'u marrë me autorët e këtyre akteve të vandalizmit, duhet kohë dhe para.
- Reklamat.
- Ndihma financiare ndaj artistëve.
- Shpenzimet për ekspozita.
OSE: Përgjigje e pamjaftueshme ose e paqartë.
- Dëm për shoqërinë.
- Dëm për konsumatorin.

Kodi 9: Pa përgjigje

Pikë të plota

Kodi 1: Pranohet se është bërë një krahasim ndërmjet mbishkrimeve dhe vizatimeve nëpër mure dhe reklamave. Përgjigja lidhet me idenë se reklama është një formë e ligjësuar e mbishkrimeve dhe e vizatimeve nëpër mure.

- Për të na treguar që reklamat mund të jenë po aq të përhapura sa edhe mbishkrimet dhe vizatimet nëpër mure.
 - Sepse disa njerëz mendojnë se reklamat janë po aq të shëmtuara sa edhe bojatisjet me spërkatje.
 - Ajo thotë se reklama është vetëm një formë e ligjësuar e mbishkrimeve dhe e vizatimeve nëpër mure.
 - Ajo mendon se reklamat janë të ngjashme me mbishkrimet dhe vizatimet nëpër mure.
 - Sepse ata nuk marrin lejen tuaj përpara se të vendosin afishet. [Krahasimi ndërmjet reklamave dhe mbishkrimeve e vizatimeve nëpër mure është i nënkuptuar.]
 - Sepse reklamat si edhe mbishkrimet e vizatimet nëpër mure zënë vend në shoqëri pa lejen tonë.
 - Sepse reklamat janë si mbishkrimet dhe vizatimet nëpër mure. [Përgjigje minimale. Përmendet ngjashmëria, por pa shpjeguar se ku qëndron kjo ngjashmëri.]
 - Sepse është një formë tjetër reklame.
 - Sepse agjensitë e reklamave ngjisin afishe nëpër mure dhe ajo mendon se kjo gjë është një formë e mbishkrimeve dhe e vizatimeve nëpër mure.
 - Sepse të dyja vendosen nëpër mure.
 - Sepse ato të dyja janë ose të bukura ose të shëmtuara.
 - Ajo i referohet reklamave sepse ndryshe nga mbishkrimet dhe vizatimet nëpër mure, reklamat janë më të pranueshme për njerëzit. [Ngjashmëria e mbishkrimeve dhe e vizatimeve nëpër mure me reklamat nënkuptohet duke ballafaquar qëndrimet që mbahen ndaj atyre të dyjave.]
- OSE: Përmend faktin se reklamat përbëjnë një strategji për të mbrojtur mbishkrimet dhe vizatimet nëpër mure.
- Kështu që, do të kuptojmë se mbishkrimet dhe vizatimet nëpër mure janë diçka e ligjshme pas gjithë kësaj.

Asnjë pikë

Kodi 0: Jepet një përgjigje e pamjaftueshme ose e paqartë.

- Është një mënyrë për të shprehur mendimin e saj.
- Sepse i pëlqen ta bëjë këtë, e përmend atë si shembull.
- Është një lloj strategjie.
- Simbole të ndërmarrjeve dhe emra dyqanesh.
- OSE: Përgjigje që dëshmon se teksti nuk është kuptuar si duhet ose përgjigje jo bindëse ose e

papërshtatshme.

- Ajo përshkruan mbishkrimet dhe vizatimet nëpër mure.
- Sepse njerëzit bëjnë mbishkrime dhe vizatime përmbi afishet e reklamave.
- Mbishkrimet dhe vizatimet nëpër mure janë një lloj reklame.
- Sepse mbishkrimet dhe vizatimet nëpër mure janë një lloj reklame për një person të caktuar ose për një grup. [Krahasimi merr drejtim të gabuar d.m.th. mbishkrimet dhe vizatimet nëpër mure janë një formë reklame.]

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 4/4

A

Pikë të plota

Kodi 1: Argumenton pikëpamjen e vet duke iu referuar përmbajtjes së njërës letër, ose të të dyjave. Përgjigjja i referohet pozicionit të përgjithshëm të autorit të letrës (dmth. është pro apo kundër) ose një detaji të argumentit të tij. Interpretimi i argumentit të autorit duhet të jetë bindës. Shpjegimi mund të marrë formën e perifrimit të një pjese të tekstit, por nuk duhet të jetë një kopje fjalë për fjalë e një pasazhi të plotë pa ndryshime ose shtesa.

- Jam në një mendje me Helgën. Mbishkrimet dhe vizatimet nëpër mure janë të paligjshme dhe kjo i bën ato vandalizëm.
- Me letrën e Helgës, sepse unë jam kundër mbishkrimeve dhe vizatimeve nëpër mure. [Përgjigje minimale]
- Me Sofinë. Unë mendoj se është hipokrizi t'u vësh gjoba autorëve të mbishkrimeve dhe të vizatimeve nëpër mure dhe pastaj të fitosh miliona duke kopjuar krijimet e tyre.
- Në një farë mënyre jam në një mendje me të dyja. Është antiligjore të vizatosh nëpër mure në mjediset publike, por këtyre njerëzve u duhet dhënë mundësia që të shprehen diku tjetër.
- Me letrën e Sofisë, sepse ajo interesohet për artin.
- I miratoj të dyja. Mbishkrimet dhe vizatimet nëpër mure nuk janë diçka e mirë, por edhe reklamat nuk janë më të mira, pra nuk do të doja të isha hipokrit.
- Me Helgën, sepse as mua nuk më pëlqejnë mbishkrimet dhe vizatimet nëpër mure, por e kuptoj edhe këndvështrimin e Sofisë dhe se përse ajo nuk do t'i fajësojë njerëzit që bëjnë atë që u pëlqen.
- Me Helgën, sepse është vërtet për të ardhur keq që të cënohet emri i të rinjve për hiçgjë. [Rast jo shumë i qartë: një ligjeratë e drejtë, por e futur në një tekst tjetër.
- Me letrën e Sofisë. Është e vërtetë se motivet dhe ngjyrat e mbishkrimeve dhe të vizatimeve nëpër mure janë huazuar, i sheh kudo nëpër dyqane dhe janë të pranueshme për njerëzit që i quajnë mbishkrimet dhe vizatimet nëpër mure si diçka të shëmtuar. [Shpjegimi është një kombinim i shprehjeve të nxjerra nga teksti, por riformulimi i tyre tregon se teksti është kuptuar si duhet.]

Asnjë pikë

Kodi 0: Nxënësi justifikon mendimin e vet duke u mjaftuar me një citim të drejtpërdrejtë të tekstit (me ose pa thonjëza).

- Me Helgën, pasi unë jam në një mendje me idenë e saj se njerëzit duhet të gjejnë mënyra të tjera për të shprehur vetveten duke mos i shkaktuar dëme shtesë shoqërisë.
- Me Helgën. Përse duhet të zbehet emri i të rinjve?

Jep përgjigje të jo të plotë ose të paqartë.

- Me letrën e Sofisë, sepse mendoj se letra e Helgës nuk jep argumente për të mbështetur pikëpamjen e saj. (Ndërsa Sofia bën një krahasim me reklamat, etj.) [Përgjigjja lidhet me stilin ose me cilësinë e argumenteve.]
- Me Helgën pasi ajo jep më shumë hollësi. [Përgjigjja lidhet me stilin ose me cilësinë e argumenteve.]
- Jam në një mendje me Helgën. [Nuk jepet asnjë element në mbështetje të këtij mendimi.]
- Me letrën e Helgës, sepse e besoj atë që thotë ajo. [Nuk jepet asnjë element në mbështetje të këtij mendimi.]
- Me të dyja, sepse unë arrij të kuptoj pikëpamjen e Helgës. Por i jap të drejtë edhe Sofisë. [Nuk jepet asnjë element në mbështetje të këtij mendimi.]

OSE: Përgjigje që dëshmon se letrat nuk janë kuptuar si duhet, ose përgjigje jobindëse ose e pavend.

- Jam më tepër në një mendje me Helgën. Sofia nuk duket të jetë e sigurtë në atë që thotë.
- Me letrën e Helgës, sepse ajo mendon se disa njerëz kanë talent. [Keqinterpretim i argumentit të Helgës.]

Kodi 9: Pa përgjigje

B

Pikë të plota

Kodi 1: Kodi 1: Shpjegon mendimin e vet duke iu referuar stilit ose formës së njërës ose të dyja letrave. I referohet kritereve të tilla si stilit të të shkruarit, strukturimit të argumentit, forcës së argumentit, tonit dhe gjuhës së përdorur, strategjive të përdorura për të bindur lexuesin. Shprehje të tilla si "argumentet më të mira" duhet të shpjegohen. (Shëno se terma të tillë si "interesant", "e lehtë për tu lexuar" dhe "e qartë" nuk konsiderohen të jenë të mjaftueshme)

- Letra e Helgës. Ajo propozon të mbahen parasysh pikëpamje të ndryshme dhe përmend dëmet që autorët e mbishkrimeve dhe vizatimeve nëpër mure i sjellin mjedisit, gjë që më duket shumë e rëndësishme.
- Letra e Helgës është efikase, sepse ajo i drejtohet drejtpërsëdrejti autorëve të mbishkrimeve dhe të vizatimeve nëpër mure.
- Mendoj se letra e Helgës ishte më e mira nga të dyja. Mendoj se letra e Sofisë është pak tendencioze.
- Mendoj se Sofia jep një argument shumë të fortë, por letra e Helgës është strukturuar më mirë.
- Sofia, sepse ajo nuk i drejtohet ndonjë personi në veçanti. [Shpjegon zgjedhjen e tij përse i

përket cilësisë së përmbajtjes. Shpjegimi është i kënaqshëm po që se interpretohet "Nuk sulmon askënd".]

- Më pëlqen letra e Helgës. Ajo ishte e sigurt në paraqitjen e mendimit të vet.

Asnjë pikë

Kodi 0: Jep një gjykim që shpreh se është apo nuk është në një mendje me këndvështrimin e autores së letrës, ose mjaftohet duke perifrastuar përmbajtjen.

- Me Helgën. Jam në një mendje me çdo gjë që thotë ajo.
- Letra e Helgës është më e mira. Është tamam ashtu siç thotë ajo, mbishkrimet dhe vizatimet nëpër mure kushtojnë shumë dhe janë të padobishme.
- Sofia. Çdogjë që ajo tha ishte e rëndësishme.

OSE: Jep një gjykim, por pa dhënë një shpjegim të mjaftueshëm.

- Letra e Sofisë ishte më e mira.
- Letra e Sofisë lexohet më kollaj.
- Helga jep argumente më të mira.

OSE: Përgjigje që dëshmon se teksti nuk është kuptuar si duhet ose përgjigje jobindëse ose e pavend.

- Letra e Helgës është shkruar më mirë. Ajo e shtjellon problemin hap pas hapi dhe mbi këtë bazë arrin në një përfundim logjik.
- Letra e Sofisë, sepse nuk e shpreh pikëpamjen e saj deri në fund të letrës.

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 1/5

Pikë të plota:

Kodi 1: A. Rreth dy metra

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje tjetër

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 2/5

Pikë të plota

Kodi 1: 11 000 para ES (OSE përfaqësohet 10 500 dhe 12 000 OSE ndonjë indikacion tjetër që nxënësi e ka tërhequr nga shkalla e grafikut.)

- 11000
- 11000 para ES
- 10500 para ES
- Diçka para 10000 para ES
- Rreth 12000
- Rreth 11000 para ES

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje të tjera, duke përfshirë edhe një shigjetë që tregon pikënisjen e grafikut.

- 10 000 para ES [Nuk ka bërë përlllogaritje mbi bazën e shkallës.]
- 20 000 para ES
- 8 000 para ES [Ka parë figurën e gabuar.]
- 11000 ES 4000 para ES [Mos e merrni parasysh përgjigjen e fshirë me vijë.]
- 0

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 3/5

Pikë të plota

Kodi1: Përmendet rishfaqja e liqenit. Shënim: përgjigjja mund të marrë pikë të plota edhe nëse përgjigjja e mëparshme është e gabuar.

- Liqeni Çad u rishfaq në vitin 11 000 para ES pasi ishte zhdukur plotësisht rreth vitit 20 000 para ES.
- Liqeni u zhduk gjatë periudhës së akullnajave dhe u rishfaq rreth kësaj epoke.
- Ishte pikërisht në atë periudhë që u rishfaq liqeni.
- U rishfaq rreth vitit 11 000 para ES.

- Atëherë liqeni u rishfaq përsëri pasi ishte zhdukur për rreth 9000 vjet.

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje të tjera

- Kjo është koha kur filluan të shfaqen kafshët.
- Viti 11 000 para JK është viti kur njerëzit filluan të zhvillonin artin në shkëmb.
- Viti 11 000 para JK është viti kur u shfaq liqeni (për herë të parë).
- Sepse në atë kohë Liqeni Çad ishte tharë plotësisht.
- Sepse kjo përbën ndryshimin e parë në grafik.

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 4/5

Pikë të plota

Kodi 1: A. kafshët në artin e shpellave ishin prezente në atë rajon që nga koha kur ato ishin vizatuar;

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje tjetër

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 5/5

Pikë të plota

Kodi 1: C. pasi që niveli i liqenit Çad ka filluar të bjerë në periudhë prej më shumë se një mijë vjetësh

Asnjë pikë:

Kodi 0: Përgjigje tjetër

Kodi 9: Pa përgjigje

PERSONELI

Pyetja 1/2

Pikë të plota

Kodi1: Përmendet të paktën NJË nga përgjigjet e mëposhtme:

1. Pranë seksionit të personelit
2. Pranë këshilluesit të personelit

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje të tjera.

Kodi 9: Pa përgjigje.

Pyetja 2/2

Pikë të plota

Kodi1: Përmenden TË DYJA përgjigjet e mëposhtme:

1. Ata veprojnë si ndërmjetësues për punonjësit OSE për ndërmjetësim
2. Ata ndihmojnë për gjetjen e vendeve të reja të punës. [Nuk duhet të pranohet si e saktë: "Banka e të dhënave për punësim", "Orientimi", "Kurset", ose "Projektet për riorientim profesional".]

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje të tjera.

Kodi 9: Pa përgjigje.

Pyetja 1/7

Pikë të plota

Kodi 1: C. Shtëpia e saj është e rrethuar nga uji për shkak të përmbytjes

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje tjetër

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 2/7

Pikë të plota

Kodi 1: C. ka për qëllim të vrasë panterën

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje tjetër

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 3/7

Pikë të plota

Kodi 3: Shkon përtej një interpretimi fjalë për fjalë të tregimit, duke interpretuar në një mënyrë që përputhet me kuptimin e saktë e fjalë për fjalë të tekstit. Vlerëson fjalinë e fundit si penelata finale që i bëhet temës së tregimit, në raport me lidhjet, problemet ose metaforat që janë në qendër të tregimit. Për shembull, përgjigjja mund të përmendë lidhjen midis gruas dhe panterës; temën e mbijetesës; temën e dhuratës ose të një falenderimi. Mendimi mbi karakterin e përshtatshëm të këtij përfundimi mund të jetë i shprehur qartë ose në mënyrë të nënkuptuar.

- Po. Tregimi e vendos gruan në kontakt me atë që është thelbësore në jetë, dhe kocka e pastruar mirë është simboli i saj.
- Po. Mendoj se mbeturinat e proshutës të lëna nga pantera janë gjithashtu një dhuratë, mesazhi i së cilës është «Të jetosh dhe t'i lësh të tjerët të jetojnë».
- Po. Kocka është si një dhuratë, dhe kjo është tema e tregimit.
- Po. Kocka e proshutës na kujton atë që mund t'i kishte ndodhur gruas.
- Është e përshtatshme pasi në një farë mënyre kafsha e falënderon për proshutën.

Pikë të pjesshme

Kodi 2: Shkon përtej një interpretimi që i përmbahet me besnikëri fjalëve të tregimit, duke interpretuar në një mënyrë që përputhet me kuptimin e saktë e fjalë për fjalë të tekstit. E vlerëson fjalinë e fundit përsa i përket stilit dhe tonalitetit, duke e lidhur me stilin ose me tonalitetin që dominon pjesën tjetër të tregimit. Mendimi mbi karakterin e përshtatshëm të këtij përfundimi mund të jetë i shprehur qartë ose në mënyrë të nënkuptuar.

- Po, kjo i përshtatet tonit të drejtpërdrejtë të tregimit.
- Po, kjo zgjat efektin shqetësues.

- Jo, është shumë e vrazhdë, ndërkohë që pjesa më e madhe e tregimit është shumë e detajuar.

Kodi 1: Përgjigjja i përmbahet pikë për pikë fjalëve të tekstit, dhe është në përputhje me një kuptim të saktë e fjalë për fjalë. Ai e vlerëson fjalinë e fundit si një sekuencë tregimtare, duke e vënë shprehimisht në lidhje me ngjarje të veçanta (për shembull, pantera që shijon mishin, vizita e panterës në shtëpi, ulja e nivelit të ujrave). Mendimi mbi karakterin e përshtatshëm të këtij përfundimi është shprehur qartë ose i nënkuptuar.

- Po, ajo na lejon të marrim vesh nëse pantera e hëngri mishin.
- Jo. Pjesa që lidhet me mishin ka mbaruar tashmë.
- Kjo mbaron pasi mishi ka mbaruar sikurse edhe tregimi.
- Po. Tani që niveli i ujërave u ul dhe mishi është ngrënë, pantera nuk ka më nevojë që të qëndrojë.
- Mendoj se është një fund i mirë, sepse është provë që pantera qëndroi në verandë. Interpretim fjalë për fjalë i faktit që ngjarjet e tregimit «kanë ndodhur realisht».
- Jo, nuk është një fund i përshtatshëm. Nuk ishte dhuratë, ishte shumë e rrezikshme [Përgjigjja dëshmon për një kuptim krejtësisht fjalë për fjalë.]
- Kjo është shumë e përshtatshme për të përshkruar se si ishte gjendja pas përmbytjes. [Nxënësi i referohet fundit të përmbytjes.]
- Po. Tani që niveli i ujrave u ul dhe ajo e ka ngrënë mishin.

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje e paqartë ose e pamjaftueshme.

- Është më e efikase. Është vërtet mbresëlënëse.
- Jo, dhurata s'ka fare të bëjë me fundin e historisë.
- Jo. Do të ishte mirë të mbaronte me diçka më nxitëse. [Nuk vendos asnjë lidhje midis fundit dhe pjesës tjetër të tregimit].
- Kjo mbaron me një përshkrim të kockës.

OSE: Përgjigje që dëshmon se teksti nuk është kuptuar si duhet ose përgjigje pak e besueshme ose e pavend.

- Po. Kjo tregon se nuk ishte veçse një ëndërr [Pak e besueshme]
- Jo, sepse lexuesi nuk e di se përse u zhduk pantera. [Tregon se kuptimi i tekstit nga ana e nxënësit lë për të dëshiruar.]

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 4/7

Pikë të plota

Kodi 1: B. Ajo filloi të lundrojë.

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje tjetër

Kodi 9: Pa përgjigje

Pikë të plota

Kodi 3: Dallon se këto përshkrime kanë si qëllim të ngjallin mëshirë. Lidhja që bën me qëllimin e autorit ose me efektin që jep mbi lexuesin mund të jetë e shprehur ose e nënkuptuar. Edhe lidhja që bëhet me episode të tjera të tregimit mund të jetë e shprehur ose e nënkuptuar. Përgjigjja mund të sugjerojë që:

- 1) përshkrimet e cituara vendosin një lidhje midis panterës dhe gruas (ose midis panterës dhe njerëzve në përgjithësi) në kuptimin e vuajtjes; OSE
- 2) përshkrimet e cituara paralajmërojnë sjelljen plot dhembshuri të gruas ndaj panterës në vazhdim të tregimit ; OSE
- 3) Ato e paraqesin panterën si objekt dhembshurie.
 - Klithmat e panterës janë pothuajse njerëzore, pra ajo është si vetë gruaja, dhe ne ndiejmë dhembshuri për të dyja. [I referohet shprehimisht lidhjes midis panterës dhe gruas / njerëzve (1). I referohet shprehimisht efektit që krijohet tek lexuesi.]
 - Kjo ju bën të ndërgjegjshëm se pantera është gjithashtu viktimë e përmbytjes. [I referohet në mënyrë të tërthortë lidhjes midis panterës dhe njerëzve duke përdorur fjalën "gjithashtu" (1). I referohet shprehimisht efektit që krijohet te lexuesi.]
 - Gruaja duket se trishtohet duke dëgjuar këtë, madje ende pa e ditur se për çfarë bëhej fjalë. [Bën lidhjen midis këtyre pasazheve dhe sjelljes së mëpastajme plot dhembshuri të gruas (2), pa bërë një lidhje të qartë me qëllimin e autorit ose me efektin e krijuar te lexuesi.]
 - Na vjen keq për panterën. [Kjo përgjigje nënkupton një kuptim të saktë të nuancave kuptimore të citimeve (3). Lidhje e qartë me efektet e krijuara te lexuesi.]
 - Kjo duket se shpreh brengë dhe hidhërim. [Tregon për një kuptim të saktë të nuancave kuptimore të citimeve (3). Lidhje e nënkuptuar me efektet e krijuara tek lexuesi.]

Pikë të pjesshme

Kodi 2: I referohet qëllimeve ose efekteve të mundshme të përshkrimeve të cituara, që nuk lidhen me ndjenjën e mëshirës. Përgjigjja është në përputhje me përmbajtjen e tekstit. Lidhja me qëllimet e autorit ose me efektet që krijohen te lexuesit mund të jetë e shprehur ose e nënkuptuar. Edhe lidhja me episode të tjera të tregimit mund të jetë e shprehur ose e nënkuptuar. Përgjigjja mund të përmend:

- 1) Qëllimin / efektin për të krijuar një atmosferë pritjeje ose misteri (Shënim: termat si "i frikshëm" apo "plot ankth" tregojnë se pasazhet e cituara nuk janë kuptuar si duhet; termat "interesant", "që lexohet lehtësisht " dhe "i qartë" duhet të konsiderohen si pamjaftueshmërisht specifike).; OSE
- 2) Ideja se pantera është paraqitur nga këndvështrimi i gruas
 - Sepse kjo krijon një atmosferë pritjeje. Nuk e dimë vërtet se kush është duke bërë titur. [1]
 - Kjo e fut në mënyrë progresive personazhin e panterës në tregim [1]
 - Është nxitëse. [1]
 - Sikurse edhe gruaja, ne nuk e dimë se çfarë është. [Kombinim i (1) dhe i (2)]
 - Kjo përshkruan ndjenjat e gruas në lidhje me panterën. [2]

Kodi 1: Nxënësi i referohet informacionit që ndodhet në pasazhet e cituara. Përgjigjja i përshtatet përmbajtjes së tekstit. Lidhja me qëllimin e autorit ose me efektin që krijohet te lexuesi mund të jetë i shprehur apo i nënkuptuar. Edhe lidhja me episodet e tjera të tregimit mund të jetë e shprehur ose e nënkuptuar. Përgjigjja mund të përmend:

- 1) realizmin në përshkrimin e panterës; OSE
- 2) faktin që përshkrimet janë në përputhje me dekorin dhe situatën.
 - Pantera është kafshë e egër, dhe kafshët e egra ulërasin. [1]
 - Pantera është e uritur, dhe këto kafshë ulërasin kur kanë uri. [2]
 - Ajo dallon britmat e panterës, pasi është errësirë dhe nuk mund ta shohë [2]
 - Duke e dëgjuar panterën në atë moment, ajo u kujtua për një herë tjetër kur kish dëgjuar zërin e një pantere tjetër. [2]

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje e paqartë ose e pamjaftueshme.

- Kjo e bën më interesant tregimin.
- Është përdorur një gjuhë veçanërisht përshkruese.

OSE: Përgjigje që tregon se teksti nuk është kuptuar si duhet ose përgjigje pak e besueshme ose e pavend.

- Pantera duket tinzare, sikur po pret ta shtjerë në dorë. [Pak e besueshme]
- Këto përshkrime e paraqesin panterën në një mënyrë që ka si qëllim të frikësojë lexuesin. [E gabuar]
- Ajo e tregon historinë nga këndvështrimi i panterës. [E gabuar]

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 6/7

Pikë të plota

Kodi2: Nxënësi nxjerr si përfundim nga teksti se gjesti i gruas shpjegohet me keqardhjen dhe dhembshurinë e saj në lidhje me panterën. Mund të vërë në dukje gjithashtu se edhe vetë gruaja nuk ishte e ndërgjegjshme për motivimin që ka.

- I erdhi keq për të.
- Sepse ajo e di se ç'do të thotë të kesh uri.
- Sepse ajo është një personazh i dhembshur.

Pikë të pjesshme

Kodi 1: Tregon se tregimi nuk e thotë shprehimisht se cilat ishin motivet e gruas dhe / ose që edhe ajo vetë nuk është e ndërgjegjshme.

- Ajo ka vepruar pa u menduar.
- Ka vepruar duke u rrëmbyer.

- Pa vetëdije.
- Ajo nuk e di.
- Tregimi nuk thotë gjë.

OSE: Përgjigjet duke përmendur faktin se pantera ka uri ose ka nevojë për ndihmë, pa përmendur motivet e gruas.

- Sepse ajo kishte uri.
- Sepse ajo po ulërinte.
- Për ta ndihmuar që të jetonte.

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje që dëshmon se teksti nuk është kuptuar si duhet ose përgjigje pak e besueshme ose e pavend. Ai mund të përshkruajë motivet e gruas në kuptimin e frikës ose dëshirës për t'u mbrojtur.

- Ajo mendonte se pantera do të largohej po që se do t'i jepte për të ngrënë.
- Sepse ajo kishte frikë prej saj.
- Ajo donte ta bënte panterën kafshën e vet të shoqërimit [Pak e besueshme].
- Për ta bërë si shok [Pak e besueshme].
- Sepse ajo e donte. [Pak e besueshme].

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 7/7

A

Pikë të plota

Kodi 1: Paraqet disa elemente të tekstit që mbështesin idenë se gruaja është pa ndjenja dhe shpirtzezë. Mund t'i referohet synimit të saj për të vrrarë panterën, ose faktit që, ajo qëllloi mbi të. Nxënësi mund të përdorë citime ose perifrazime.

- Ajo u përpoq ta vriste panterën.
- Ajo është shpirtzezë, sepse gjëja e parë që mendoi të bënte ishte të vriste panterën.
- Ajo qesh ndërkohë që mendon se do të vrasë macen e egër.
- Ndërkohë që është duke ngrënë, ajo qesh tek dëgjon rënkimet e panterës.
- Ajo kapi pushkën dhe qëllloi nga dritarja [Citim].

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje e paqartë ose e pamjaftueshme.

- Ajo nuk është e dashur me panterën.

OSE: Përgjigje që tregon se teksti nuk është kuptuar si duhet ose përgjigje pak e besueshme ose e pavend.

- Ajo është shpirtzezë, sepse e lë panterën përjashtë. [Është pothuaj e pamundur që ajo të

veprojë ndryshe, duke ditur rrezikun që paraqet pantera në tregim].

- Ai mendon se gruaja duhet të tregohej më e mëshirshme. [E pavend: shpjegon atë që thotë djaloshi i dialogut, në vend që të mbështetet tek tregimi.].

Kodi 9: Pa përgjigje

B

Pikë të plota

Kodi1: Paraqet disa elemente të tekstit që mbështesin idenë se gruaja është e dhembshur. Ai mund të përmendë mendimin që ajo pati për t'i dhënë panterës për të ngrënë, ose flet për aftësinë që ajo ka për të ndierë dhembshuri për panterën ose më gjerë. Mund të përdorë citime ose perifrazime.

- Ajo është bujare meqë e ndau ushqimin e saj me panterën.
- Ajo i dha proshutë.
- Ajo mori atë që kishte mbetur nga proshuta, e hodhi mishin nga xhami i thyer [Citim].
- Kur e dëgjoi për herë të parë panterën, ajo mendoi se zëri i saj ishte i trishtuar dhe jo i frikshëm. [Shenjë që tregon se gruaja është e aftë të provojë dhembshuri për panterën].
- Në tekst thuhet « Ajo pati dëshirë të qante, për veten e saj, për të gjithë njerëzit, për gjithçka që ishte prekur nga përmytja ». [Citon një pasazh që paraqet një ndjenjë më të përgjithshme dhembshurie

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje e paqartë ose e pamjaftueshme.

- I erdhi keq për të.
- Ajo është një personazh i dhembshur.

OSE: Përgjigje që dëshmon se teksti nuk është kuptuar si duhet ose përgjigje pak e besueshme ose e pavend.

- Ajo mendon se gruaja është person që dashuron. (E pa rëndësishme: sqaron se çfarë thotë vajza në dialog, në vend që të orientojë nga tregimi.)

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 1/4

Pikë të plota

Kodi 1: B. Renditja e perlave është e ndryshme.

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje tjetër

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 2/4

Pikë të plota

Kodi 1: C. se si analizohen qelizat që të zbulohet skema e ADN-së.

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje tjetër

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 3/4

Pikë të plota

Kodi 1: C. Të informojë.

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje tjetër

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 4/4

Pikë të plota

Kodi 1: B. kryerjen e analizës gjenetike.

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje tjetër

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 1/4

Pikë të plota

Kodi 1: Përgjigje që i referohet darkës OSE pirjes së shampanjës.

Sapo darkuan dhe pinë shampanjë.

“Sapo mbërritëm nga dhoma e bukës, ku patëm një darkë të shkëlqyer.”[citat i drejtpërdrejtë]

“Darkë e shkëlqyer dhe pine dy shishe shampanjë.”[citat i drejtpërdrejtë]

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje që dëshmon se teksti nuk është kuptuar si duhet ose përgjigje pak e besueshme ose e pavend.

Kodi 9: Pa përgjigje.

Pyetja 2/4

Pikë të plota

Kodi 1: B. Siç po duket duhet përgjithmonë mbi situatën të sqarohet në fillim të shfaqjes.

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje të tjera.

Kodi 9: Pa përgjigje.

Pyetja 3/4

Pikë të plota

Kodi 1: Tregon kontrastin mes Adamit dhe dy protagonistëve të tjerë me atë që po sillet në një ose më shumë nga këto që vijojnë: statusi i Adamit si më i varfër ose më i ri nga të tre protagonistët: papërvoja e tij (si person i famshëm).

- Adami është i varfër, ai duhet të jetë i emocionuar që qëndron në kështjellë.
- Ai duhet të jetë i lumtur që është me dy djem të cilët mund ta bëjnë të popullarizuar.
- Ai shkruan muzikë me dy me të vërtetë persona të njohur.
- Ai është i ri, dhe njerëzit e rinj thjesht emocionohen më shumë për punët, kjo është fakt!
- Ai është i ri që të qëndrojë në kështjellë. [minimalisht]
- Ai ka më së paku përvojë. [minimalisht]

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje e pamjaftueshme ose përgjigje boshe.

- Ai është i emocionuar. [Përsëritet baza.]

Përgjigjja dëshmon se teksti nuk është kuptuar si duhet ose jepet një përgjigje jo bindëse ose e pavend.

- Ai është artist.

- Ai është dashuruar. [nuk është sqaruar se përse është i emocionuar që qëndron në kështjellë]
- Adami duhet të jetë i entuziazmuar; me siguri solisti do të paraqitet. [nuk ka argumente në tekst]
- I është dhënë smoking. [detaj sqarues, jo vetë shkakun]

Kodi 9: Pa përgjigje.

Pyetja 4/4

Pikë të plota

Kodi 1: D. Ai i përdorën personazhet për të realizuar një nga problemet e tij kreative.

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje të tjera.

Kodi 9: Pa përgjigje.

Pyetja 1/5

Pikë të plota

Kodi 1: B. Imunizimi do të realizohet gjatë kohës së pnës

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje tjetër

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 2/5

Pikë të plota

Kodi 2: Pasqyrohet teksti ashtu si duhet; midis stilit dhe qëllimit të tekstit vendoset një lidhje që është në përputhje të plotë me termat «miqësor dhe nxitës». Përgjigja duhet të përmbajë TE PAKTEN NJE prej elementeve në vazhdim:

- 1) i referohet në mënyrë të veçantë njërit prej aspekteve të tekstit (d.m.th. një elementi ose një cilësie të veçantë të paraqitjes, të stilit, të ilustrimeve ose të elementeve të tjerë grafikë) DHE/OSE
- 2) në vlerësimin e tij përdoren terma të ndryshëm nga termat «miqësor» dhe «nxitës» . (Shënim: termat shumë të rëndomta si «interesant», «i lehtë për t'u lexuar» ose «i qartë» duhet të quhen si të papërshtatshëm).

Opinionin e nxënësit mbi faktin nëse Besa ka patur ose jo sukses mund të shprehet në mënyrë të qartë ose të nënkuptuar.

- Jo, nuk është ide e mirë që të vendosësh figurën e shiringës qysh në fillim të lajmërimit. Është e frikshme. [I referohet një elementi të veçantë në konceptimin e lajmërimit: njërit prej ilustrimeve (1). Përdor një term personal në vlerësimin që bën: «e frikshme».(2).]
- Po, ilustrimet e bëjnë tekstin, më të lehtë për t'u lexuar. [Përshkruan një aspekt të veçantë që lidhet me faqosjen. (1).]
- Imazhi i virusit, që i ngjan një personazhi të filmave me kartona, duket shumë miqësor. [I referohet një aspekti të veçantë të njërit prej ilustrimeve: « i ngjan një personazhi të filmave me kartona»(1).]
- Jo, ilustrimet janë naive dhe pa vend. [Nxënësi përdor termat e veta («foshnjarake dhe pa vend») për të vlerësuar aspektet e përmendura në fillim (2).]
- Po, stili i këtij shkrimi është i lirshëm dhe familjar. [Nxënësi përdor termat e veta (“i lirshëm”, “familjar”) për të vlerësuar një nga aspektet e përmendura në pyetjen (2).]
- Po, stili është i ngrohtë dhe tërheqës. [Përdor termat e veta për të vlerësuar stilin.(2).]
- Teksti është shumë i gjatë. Njerëzit nuk do të marrin mundimin ta lexojnë. [I referohet një aspekti të veçantë të tekstit: Volumit të tekstit (1). Nxënësi përdor termat e veta për të bërë vlerësimin. (2)]
- Ajo nuk u bën njerëzve presion për të bërë gjilpërën dhe kjo i inkurajon punonjësit. [I referohet në mënyrë jo të drejtpërdrejtë mënyrës së të shprehurit ose njërit prej aspekteve të stilit. (1).]

- Jo, stili është shumë zyrtar. [Përgjigjja është e diskutueshme, por kemi një zbatim të mirë të kriterëve personale të vlerësimit (« zyrtar »)(2).]

Pikë të pjesshme

Kodi 1: I referohet tekstit në mënyrë korrekte; dhe lidh qëllimin e lajmërimit me informacionin dhe përmbajtjen (më shumë sesa me stilin), në lidhje të ngushtë me termat «miqësor» dhe «nxitës». Opinioni i nxënësit mbi faktin nëse Besa ia ka arritur apo jo qëllimit mund të shprehet në mënyrë të qartë ose të jetë i nënkuptuar.

- Jo, nuk është e mundur që ideja e injeksionit të jepet në mënyrë miqësore dhe nxitëse.
- Po, ajo ia arrin qëllimit. Ajo paraqet disa mundësi të ndryshme dhe parashikon datat për vaksinimin. Ajo jep edhe këshilla për shëndetin.

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje e paqartë ose e pamjaftueshme

- Po, lajmërimi arrin të japë përshtypjen se do të ishte një ide e mirë.
- Po, ai është miqësor dhe nxitës. [Këto terma nuk zbatohen për aspekte të veçanta.]
- Jo, nuk ia arrin qëllimit.
- Jo, pasi disa informacione nuk janë të sakta. [I referohet përmbajtjes pa bërë lidhjen me faktin se lajmërimi është formuluar në mënyrë të tillë që të jetë «miqësor dhe nxitës».]
- Po, ilustrimet janë nxitëse dhe stili i lajmërimit është gjithashtu i pranueshëm. [« Ilustrimet janë nxitëse » nuk i kalon caqet e termave të përdorura në formulimin e pyetjes. «Stili i lajmërimit është i pranueshëm» është shumë e paqartë].
- Po, ajo ia arrin qëllimit, lajmërimi është i kuptueshëm dhe i qartë. [Termet e përdorura janë të rëndomta.]
- Besoj se ajo ia arrin mjaft mirë qëllimit. Ajo ka zgjedhur imazhet e duhura dhe ka shkruar një tekst interesant. [Imazhet nuk janë objekt i asnjë vlerësimi dhe « tekst interesant » është shumë i paqartë.]

OSE: Jepet një përgjigje që dëshmon se dokumenti nuk është kuptuar si duhet, ose një përgjigje e papërshtatshme ose e pavend.

- Po, të gjithë duhet të vaksinohen. [Përgjigje e pavend dhe e gabuar]
- Jo, ilustrimet nuk kanë fare të bëjnë me mesazhin. [E gabuar]
- Po, sepse ajo kërkon të shqetësojë njerëzit me idenë se mund t'i zerë gripi. [Në kundërshtim me idenë që mesazhi është « miqësor dhe nxitës».]
- Është mirë, por është vetëm një mendim. [E pavend]
- Po, ky lajmërim jep informacione të shkurtëra mbi atë se çfarë duhet bërë për të ndaluar gripin të përhapet. [E pavend: i referohet përmbajtjes në mënyrë jo specifike.]
- Po, ajo s'bën tjetër gjë veçse jep fakte [E pavend]
- Po, sepse duhet të vaksinohen më shumë njerëz. [Jepet një mendim të përgjithshëm mbi vaksinimin, pa iu referuar stilit ose elementeve të përmbajtjes.]
- Po, pasi askush nuk dëshiron të sëmuret. Të gjithë duan të gëzojnë shëndet të mirë. [E pavend]

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 3/5

Pikë të plota

Kodi 1: B. është ide e mirë, por ajo nuk është zëvendësim i ushtrimit dhe dietës së shëndetshme.

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje tjetër

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 4/5

Pikë të plota

Kodi 2: Vlerëson pasazhin e tekstit të cilit i referohet shprehja «mund të sjellin çorientim» duke treguar se mund të krijohet një lloj kontradikte (midis «Kush duhet të vaksinohet ? Të gjithë personat...» dhe «Kush nuk duhet të vaksinohet»). Nxënësi mundet të shpjegojë ose jo se ku qëndron kontradikta. Kjo kontradiktë mund të formulohet në mënyrë të qartë ose të nënkuptuar.

- Po, sepse për disa persona mund të jetë e rrezikshme të vaksinohen. (p.sh. gratë shtatzëna). [E përshkruan kontradiktën.]
- Jo, sepse po të lexosh disa rreshta më poshtë kupton se disa persona janë mirë të mos vaksinohen; mirëpo Besa dëshiron që të vaksinohen të gjithë.
- Po, sepse ajo thotë që «të gjithë» duhet të vaksinohen dhe më poshtë ajo thotë se cilët persona nuk duhet të vaksinohen. [Identifikon kontradiktën].
- Kjo frazë sugjeron se të gjithë duhet të vaksinohen, gjë që nuk është e vërtetë. [përshkruhet shkurtimisht kontradikta.]
- Po, në një farë mënyre! Ndoshta duhej thënë: «Të gjithë personat që duan të mbrohen nga gripi dhe që nuk vuajnë nga ndonjë sëmundje ose kanë simptomat e mëposhtme». [Riformulimi i propozuar nënkupton se nxënësi e ka kuptuar se ku qëndron kontradikta.]

OSE: Vlerëson atë pasazh me të cilin lidhet shprehja «mund të sjellë çorientim» duke thënë se ajo është e ekzagjeruar (Psh: Jo të gjithë kanë nevojë të vaksinohen, ose vaksina nuk të mbron plotësisht). Nxënësi mund të shpjegojë ose jo se ku qëndron ky egzagerim. Kontradikta mund të formulohet në mënyrë të qartë ose të nënkuptuar.

- Kjo frazë duhet hequr, sepse vaksinimi nuk të garanton nga gripi.
- Nuk jam dakord të hiqet, megjithëse ajo të jep përshtypjen se pa u vaksinuar është e sigurt se do ta zerë gripi.
- Vaksina nuk të siguron një mbrojtje absolute.
- Kjo frazë duhet hequr, sepse nuk sëmuren të gjithë nga gripi, sidomos ata që janë mirë me shëndet.
- Po, jam dakord, sepse kjo frazë të jep përshtypjen se vaksina është më e efektshme nga sa është në të vërtetë. [Jepet ideja e njëfarë egzagerimi, edhe pse ky nuk përcaktohet qartë.]

Pikë të pjesshme

Kodi 1: Vlerësohet pasazhi pa u interesuar për shprehjen «mund të sjellë çorientim»:

- 1) Tregon që teksti është i fuqishëm, efikas, nxitës, pa përmendur kontradiktën potenciale ose elementin që çon në çorientim OSE
- 2) Tregon që shprehja «Të gjithë personat që duan të mbrohen nga virusi» është e tepërt, sepse ajo shpreh një gjë që duket sheshit.
 - Është mirë që është shkruar kjo frazë sepse kjo do t'i inkurajojë njerëzit. [1]
 - Kjo frazë duhet mbajtur pasi ajo e vë më shumë në dukje pasazhin. [1]
 - Mendoj se mund ta hiqim këtë frazë, sepse dihet që të gjithë duan të mbrohen nga virusi, edhe sikur të mos vaksinohen. [2]

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje e paqartë ose e pamjaftueshme, ose përgjigje ku përsëritet “sjell çorientim” pa dhënë shpjegime të tjera.

- Është mirë të lihet fraza. [Pa shpjegim.]
- Në vend të këtij titulli, duhej të ishte vënë një ilustrim tjetër. [Pa shpjegim.]
- Po, kjo frazë sjell çorientim dhe mund të nxjerrë probleme. [Pa shpjegim.]

OSE: Përgjigje që dëshmon se materiali nuk është kuptuar si duhet ose përgjigje e papërshtatshme ose e pavend.

- Nuk duhej të vihej, sepse secili ka të drejtë të vendosë vetë. [Keqinterpretohet gjuha e përdorur në tekst: nuk jepet urdhër.]
- Mendoj se pas fjalës «VIRUS» duhet të vendoseshin fjalët «I GRIPIT», sepse ata që nuk do ta lexojnë me vëmendje mund të kujtojnë se është fjala për ndonjë virus tjetër. [Jepet një shpjegim jo i pëlqyeshëm për «sjell çorientim».]
- Po, njerëzit mund të jenë të interesuar, por ndoshta kanë frikë nga gjilpërat. [Përgjigje e pavend.]

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 5/5

Pikë të plota

Kodi 1: D. Miri, i sektorit të llogarisë, i cili do të jetë i imunizuar, por do të jetë në pushim atë javë në të cilën bie 17 maji.

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje tjetër

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 1/2

Pikë të plota

Kodi 1: B. Niveli i aktiviteteve në Etiopi ka qenë krahasimisht i ulët.

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje tjetër

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 2/2

Pikë të plota

Kodi 3: Nxënësi i është përgjigjur saktë Pyetjes 4A (Pika B). Ai shpjegon nivelin e veprimtarisë të PLAN-it duke u mbështetur në GJITHË informacionin e dhënë, duke iu referuar shprehimisht ose në mënyrë të nënkuptuar llojit të veprimtarisë së kryer në Etiopi nga PLAN-i. Përgjigja duhet të jetë në përputhje edhe me (megjithëse nuk është e nevojshme t'i përmendë) DY pikat e mëposhtme:

- 1) Niveli i ulët i veprimtarisë së PLAN-it në Etiopi (informacioni i dhënë në tabelë); DHE
 - 2) Varfëria e Etiopisë (informacion i dhënë në njërin nga pyetjet).
- Organizatat humanitare shpesh e nisin punën e tyre në një vend me kualifikimin e njerëzve vendas, kështu që unë do të thosha se PLAN-i e ka filluar punën në Etiopi më 1996.
 - Kualifikimi i punonjësve të komunitetit mund të jetë e vetmja ndihmë që ata mund të japin atje. Ndoshta nuk ka shkollë apo spitale në të cilat ata të mund të bazojnë llojet e tjera të punës së tyre humanitare.
 - Grupe të tjera humanitare të huaja mund të jenë duke ndihmuar me barna etj. dhe PLAN sheh se ata kanë nevojë të mësojnë se si ta drejtojnë vendin. [Nxënësi flet në mënyrë të tërthortë për kualifikimin e udhëheqësve të komunitetit.]

Pikë të pjesshme

Kodi 2: Nxënësi i është përgjigjur saktë Pyetjes 4A (Pika B). Ai shpjegon nivelin e punës së PLAN-it duke u bazuar KRYESISHT në informacionin e dhënë. Përgjigja duhet të jetë në përputhje me (megjithëse nuk është e nevojshme t'i përmendë) DY pikat e mëposhtme:

- 1) Niveli i ulët i veprimtarisë së PLAN-it në Etiopi (informacioni i dhënë në tabelë); DHE
 - 2) Varfëria e Etiopisë (informacion i dhënë në njërin nga pyetjet).
- Mund të jetë e vështirë të shpërndahet ndihma atje sepse gjërat janë rrëmuje.
 - Ndoshta ka luftë dhe kështu do të ishte e vështirë të jepej ndihmë.
 - Ata nuk dinë si ta japin ndihmën atje.
 - Në qoftë se ka organizata të tjera që po ndihmojnë Etiopinë, PLAN-it nuk i mbetet shumë për të bërë.
 - Mund të mendohej se vendet e tjera ishin të parat që morën ndihmë dhe Etiopia do të ndihmohet në një të ardhme të afërt.
 - Njerëzit në Etiopi mund të kenë një kulturë të tillë që t'ua bëjë të vështirë komunikimin me të

huajt.

- Mendoj se ata po japin më shumë ndihmë në vendet e tjera dhe Etiopia po mbetet mënjanë. Plan ndërkombëtar mund të mos ketë fonde dhe para të mjaftueshme për të gjitha vendet që kanë nevojë.

Kodi 1: Nxënësi i është përgjigjur saktë Pyetjes 4A (Pika B). Ai shpjegon nivelin e punës së PLAN-it duke u mbështetur PJESËRISHT në informacionin e dhënë. Përgjigjja duhet të jetë në përputhje me (megjithëse nuk është e nevojshme t'i përmendë) nivelin e ulët të veprimtarisë së PLAN-it në Etiopi (informacioni i dhënë në tabelë).

- Etiopia nuk ka nevojë për ndihmën e PLAN-it aq sa vendet e tjera. [Nxënësi mbështetet në informacionin e dhënë në tabelë, por nuk merr parasysh informacionin e dhënë mbi varfërinë relative në Etiopi.]
- Etiopia nuk është aq e varfër sa vendet e tjera, kështu që nuk ka aq nevojë sa ato për ndihmën e PLAN-it. [Nxënësi bazohet në informacionin e tabelës dhe jo në informacionin e dhënë mbi varfërinë relative të Etiopisë.]
- Etiopia mund të ketë nevojë për më shumë ndihmë se sa vendet e tjera vetëm në drejtim të udhëheqësve të komunitetit. [Nxënësi bazohet me hollësi në informacionin e dhënë në tabelë, por nuk merr parasysh informacionin e dhënë mbi varfërinë relative të Etiopisë.]

OSE: Nxënësi i është përgjigjur saktë Pyetjes 4A (Pika B). Ai shpjegon nivelin e punës së PLAN-it duke u mbështetur PJESËRISHT në informacionin e dhënë. Përgjigjja duhet të jetë në përputhje me (megjithëse nuk është e nevojshme t'i përmendë) nivelin e ulët të veprimtarisë së PLAN-it në Etiopi (informacioni i dhënë në tabelë):

- 1) niveli i veprimtarisë në Etiopi, që nxënësi ka treguar në Pyetjen 2A (vetë shpjegimi nuk është e nevojshme të jetë i vërtetë); DHE
 - 2) Varfëria e Etiopisë (informacioni i dhënë në njërin nga pyetjet).
- [I përgjigjet Pyetjes 4A: Niveli i veprimtarisë është krahasimisht më i lartë në Etiopi.] Etiopia është më e varfër se vendet e tjera në rajon dhe ndaj ka nevojë për më shumë ndihmë.
 - [I përgjigjet Pyetjes 4A: Është pothuajse e njëjtë me vendet e tjera në rajon.] Ndihma shpërndahet në mënyrë të barabartë me qëllim që të mos ketë rivalitet midis vendeve.

Asnjë pikë

Kodi 0: Nxënësi jep përgjigje të pamjaftueshme ose të paqartë.

- Ata nuk punojnë aq shumë në Etiopi. [Nxënësi rimerr informacionin e Pikës 4A pa u përpjekur ta shpjegojë atë.]
- PLAN-i nuk bën pothuajse asgjë në Etiopi.

OSE: Nxënësi tregon se nuk e ka kuptuar si duhet materialin ose jep një përgjigje jo bindëse ose të pa vend.

- Ata duhet t'i japin më shumë ndihmë Etiopisë. [Nxënësi shpreh një mendim më shumë se sa jep një shpjegim.]
- Ata po bëjnë vetëm kualifikime të punonjësve të komunitetit. Nuk duket të jenë duke bërë diçka për shëndetin ose për të mësuar njerëzit. [Nuk shpjegon nivelin e veprimtarisë.]
- Niveli i veprimtarive të PLAN Ndërkombëtar në Etiopi i krahasuar me veprimtaritë e tij në

vendet e tjera është më i lartë. [Nxënësi rithekson disainformacione që nuk i përmbahen pikës 4A pa u përpjekur t'i shpjegojë ato.]

- PLAN-i jep të njëjtën sasi ndihme në çdo vend. [Nxënësi rithekson disa informacione që nuk i përmbahen pikës 4A pa u përpjekur t'i shpjegojë ato.]

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 1/4

Pikë të plota

Kodi 1: D. Personat që janë në tregun e punës dhe personat që nuk janë në tregun e punës.

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje tjetër

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 2/4

Pikë të plota

Kodi 2: Tregon se nxënësi ka integruar së bashku shifrën e dhënë në diagramë DHE shënimin “x 1000” që ndodhet në titull dhe shënimin në fund të faqes (përgjigja : 949.900. Pranohen shifrat e përafërta 949.000 dhe 950.000 ose të shprehura me fjalë. Përgjigjet e tipit 900.000 ose një milion (me fjalë ose me shifra) mund të pranohen si të sakta, nëse ato shoqërohen nga një tregues mbi karakterin e tyre të përafërt.

- 949.900
- pak më pak se nëntë qind e pesëdhjetë mijë
- 950.000
- 949,9 mijë
- afro një million
- rreth 900 mijë
- 949,9 X 1000
- 949(000)

Pikë të pjesshme

Kodi 1: Tregon se shifra e dhënë në diagramë është gjetur, por që shënimi “x 1000” që del në titull dhe në shënimin në fund të faqes nuk janë përdorur. (përgjigja 949,9 ose një shifër e përafërt). Në përgjigje mund të përdoren si shifra edhe fjalë. Përgjigjet e përafërta të tipit të ilustruar në kodin 2 mund të pranohen si të sakta.

- 949,9
- 94.900
- pothuajse një mijë
- pak më pak se 950
- rreth 900
- pak më pak se 1000

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje të tjera

- 35,8%
- 7,50%

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 3/4

	“forcë pune: punësuar”	“forcë i papunësuar”	pune “nuk paraqet forcë pune”	nuk përfshihet në asnjë kategori
Kamarier me orar të shkurtër pune, në moshë prej 35 vjeç	☒	☐	☐	☐
Grua afariste, në moshë prej 43 vjeç, e cila punon 60 orë në javë	☒	☐	☐	☐
Nxënës me orar të plotë pune, në moshë prej 21 vjeç	☐	☐	☒	☐
Burrë, në moshë prej 28 vjeç, i cili kohë më parë e ka shitur shitoren e tij dhe kërkon punë.	☐	☒	☐	☐
Grua, në moshë prej 55 vjeç, e cila kurrë nuk ka punuar ose nuk ka dashur të punojë jashtë shtëpisë	☐	☐	☒	☐
Gjyshe, në moshë prej 80 vjeç, e cila akoma punon nga disa orë në ditë në tezgën e familjes në treg	☐	☐	☐	☒

Pikë të plota

Kodi 2: 5 përgjigje të sakta

Pikë të pjesshme

Kodi 1: 3 OSE 4 të sakta

Asnjë pikë

Kodi 0: 2 OSE më pak të sakta

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 4/4

Karakteristikat e diagramit të degëzuar “druri”	Përgjigje
Shenjat në secilin kuadër të diagramit (p.sh. “forcë pune”)	ndryshojnë / nuk ndryshojnë
përqindjet (p.sh. „64,2%”)	ndryshojnë / nuk ndryshojnë
numrat (p.sh. „2 656,5”)	ndryshojnë / nuk ndryshojnë
fusnotat nën diagramin “druri”	ndryshojnë / nuk ndryshojnë

Pikë të plota

Kodi 1: 3 të sakta

Asnjë pikë

Kodi 0: 2 OSE më pak të sakta

Kodi 9: Pa përgjigje

TË NDIHESH MIRË ME KËPUCËT E TUA TË SPORTIT

Pyetja 1/4

Pikë të plota

Kodi 1: D. Se është shumë e rëndësishme që sportistët e rinj të mbajnë këpucë sporti të mira

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje tjetër

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 2/4

Pikë të plota

Kodi 1: Nxënësi i referohet faktit që ato pengojnë lëvizjet.

- Ato pengojnë lëvizjet.
- Ato të pengojnë të vraposh/ të lëvizësh lirshëm.

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje që dëshmon se dokumenti nuk është kuptuar si duhet ose përgjigje jo bindëse ose e pavend.

- Për të mos patur plagë.
- Ato nuk mund ta mbajnë mirë këmbën.
- Sepse duhet ta mbrojmë këmbën dhe kavaljen.

OSE: Përgjigje e paqartë ose e pamjaftueshme.

- Sepse përndryshe ato nuk janë të përshtatshme.

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 3/4

Pikë të plota

Kodi 1: Nxënësi i referohet katër kriterëve të përmendura në tekst me shkronja italiane. Çdo përgjigje mund të jetë një citim i drejtpërdrejtë, një perifrazim ose një riformulim i kriterit. Nxënësi mund t'i rendisë kriteret si të dojë. Katër kriteret janë:

- 1) Të mbrojnë nga mjedisi i jashtëm
- 2) Të mbajnë mirë këmbën
- 3) Të sigurojnë stabilitet
- 4) Të zbusë goditjet

1. Mbrojtja nga jashtë
2. Të mbajnë mirë këmbën
3. Stabiliteti i duhur

4. Të pengojë goditjet

- Ajo duhet të mbrojë nga mjedisi i jashtëm, të mbajë mirë këmbën, t'i sigurojë lojtarit stabilitetin e duhur dhe të pengojë goditjet.
- Të mbrojë, të mbajë mirë, të japë stabilitet, të amortizojë goditjet. [Nxënësi citon nëntitujt e pjesës së tekstit në fjalë].

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje të tjera

1. Të mbrojë nga goditjet e topit dhe të këmbës.
2. Të rezistojë ndaj terreneve të deformuara.
3. Të mbajë këmbën ngrohtë dhe thatë.
4. Të mbajë mirë këmbën.

[Në këtë përgjigje tre pikët e para i përkasin kriterit 1 (mbrojtjes nga mjedisi i jashtëm).]

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 4/4

Pikë të plota

Kodi 1: Ç. e jep zgjidhjen e problemit të përshkruar në pjesën e parë

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje tjetër

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 1/3

Pikë të plota

Kodi 1: D. Ata shprehin pikëpamje të kundërta për temën e njëjtë.

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje të tjera.

Kodi 9: Pa përgjigje.

Pyetja 2/3

Pikë të plota

Kodi 1: Përgjigje të cilat identifikojnë një lloj pune dhe japin arsyetim të argumentuar pse personi i cili bën punë të atij lloji nuk mund të telekomunikojë. Përgjigjet DUHET të tregojnë (në mënyrë eksplicite ose implicite) që patjetër duhet qenë fizikisht prezent për një punë të caktuar.

- Ndërtësë. Vështirë është të punosh me dru dhe tulla nga kudo qoftë.
- Person sportiv. Duhet me të vërtetë të jeni atje që ta luani sportin.
- Hidraulik. Ju nuk mund të riparoni ndonjë lavaman tjetër nga shtëpia juaj!
- Gërmim gropash sepse duhet të jeni atje.
- Infermiere - vështirë është të kontrollohet se a janë pacientët në rregull përmes Internetit.

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigjet të cilat identifikojnë një lloj pune, mirëpo nuk përmbajnë sqarim ose japin sqarim që nuk i referoht telekomunikimeve.

- Gërmim gropash.
- Zjarrfikës.
- Nxënës.
- Gërmim gropash sepse kjo do të ishte punë e mundimshme. [Sqarimi nuk tregon pse kjo do të vështirësonte telekomunikimet.]
- Jep përgjigje jo të plotë ose të paqartë.
- Duhet të jesh atje.

Përgjigje që dëshmon se materiali nuk është kuptuar si duhet ose përgjigje jo bindëse ose e parëndësishme.

- Menaxher. Askush nuk ju vëren sidoqoftë. [sqarim i parëndësishëm]

Kodi 9: Pa përgjigje.

Pyetja 3/3

Pikë të plota

Kodi 1: B. Nuk është e mirë ideja që njerëzit të kalojnë shumë kohë duke udhëtuar deri në punë.

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje të tjera.

Kodi 9: Pa përgjigje.

Pyetja 1/4

Pikë të plota

Kodi2: Përmend avionët dhe fluturaket kosmike (sipas cilësdo radhitje) [mund t'i shënojë të dyja përgjigjet në një vijë]:

1. Avion
2. Fluturake

1. Avionë
2. Anije kosmike

1. Transport ajror
2. Transport kosmik

1. Xhambo-avion
2. Raketa kosmike

1. Avionë
2. Raketa

Pikë të plota

Kodi 1: I referohet VETËM avionëve ose fluturakeve kosmike:

- fluturake kosmike
- transport kosmik
- raketa kosmike
- raketa
- avionë
- avionë udhëtarësh
- transport ajror
- avionë reaktivë

Asnjë pikë

Kodi 0: Jep përgjigje të pamjaftueshme ose të paqartë.:

- Anije kosmike
- Përgjigjja dëshmon se teksti nuk është kuptuar si duhet ose jepet një përgjigje jo bindëse ose e pavend:

Veshje kosmike [nuk është mënyrë transporti]

- Xhambo xhet [ky detaj nuk mbështetet nga teksti – referimi në avionin xhambo xhet nuk është i rëndësishëm në këtë pyetje]

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 2/4

Pikë të plota

Kodi 1: Përmend lartësinë. Mund të orientojë në krahasimin mes avionit me trup të gjerë dhe balonës:

- Të tregojë se sa lartë ka shkuar balona
- Ta theksojë faktin që balona ka shkuar me të vërtetë lartë
- Të tregojë se sa impresiv është rekordi i tij – ai ka qenë në lartësi mbidetare më të madhe se avioni!
- Si pikë referimi për lartësinë

Asnjë pikë

Kodi 0: Jep përgjigje të pamjaftueshme ose të paqartë.:

- Të tregojë se sa impresiv është shkrimi i tij [shumë i paqartë]
- Të shërbejë për krahasim

Përgjigjja dëshmon se teksti nuk është kuptuar si duhet ose jepet një përgjigje jo bindëse ose e pavend:

- Fluturojnë balona dhe avionë.
- Të duket bukur.

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 3/4

Pikë të plota

Kodi 1: B. Të krahasohet madhësia e balonit të Singanit me madhësinë e balonave të tjerë me ajër të ngrohtë

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje të tjera

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 4/4

Pikë të plota

Kodi 1: B. Singani vendosi rekord të ri botëror.

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje të tjera

Kodi 9: Pa përgjigje

NDËRTESTAT MË TË LARTA

Pyetja 1/4

Pikë të plota

Kodi 1: Kulla CN

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje të tjera

- Kulla Burxh

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 2/4

Pikë të plota

Kodi 1: C. Numri i ndërtesave mbi lartësinë e caktuar në qytete të ndryshme

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje të tjera

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 3/4

Pikë të plota

Kodi 2: Tregon që artikulli vjen nga revista norvegjeze ose që lexuesit ndoshta janë norvegjez:

- Vjen nga një revistë norvegjeze.
- Është shkruar për njerëz nga Norvegjia, kështu që qëllimi i tij është të japë ndjesi për perspektivë.
- T'ju tregojmë njerëzve që nuk kanë shumë ndërtesa të larta!

Pikë të pjesshme

Kodi 1: Dëshmon që SAS Plaza është pikë referimi ose pikë krahasimtare pa e përmendur Norvegjinë:

- për shkak të krahasimit
- të fitohet një pikë referimi
- të kuptohet rëndësia e shkallës

Asnjë pikë

Kodi 0: Jep përgjigje të pamjaftueshme ose të paqartë:

- 117 është akoma mjaft i lartë.
- Sepse është një nga ndërtesat më të larta në botë.
- Ka 30 OSE shumë kate.

- Kjo është ndërtesa më e lartë në Norvegji [shumë e paqartë – nuk ndërlidhet me publikun qëllimor të tekstit].
- Sepse norvegjishtja [shumë e paqartë – nuk ndërlidhet me publikun qëllimor të tekstit].

Përgjigjja dëshmon se teksti nuk është kuptuar si duhet ose jepet një përgjigje jo bindëse ose e pavend:

- Ai është hoteli i vetëm [saktë, por nuk është përfshirë në këtë tekst].
- Vetëm ajo nuk ka kërcim [saktë, por nuk është përfshirë në këtë tekst].

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 4/4

Pikë të plota

Kodi 1: Që të trija të sakta 3: po, jo, po – sipas kësaj radhitje

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje të tjera

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 1/5

Pikë të plota

Kodi 1: Që të katra të sakta: 1, 3, 2, 4 – sipas kësaj radhitje

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje të tjera

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 2/5

Pikë të plota

Kodi 1: C. Të mos e përdorni atë që e keni është njësoj sikur të mos e keni.

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje të tjera

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 3/5

Pikë të plota

Kodi 1: Ai dallon që mesazhi i anekdotës bazohet në shkëmbimin e arit me diçka të padobishme dhe të pavlerë:

- Duhet të shkëmbehet me diçka të pavlerë që të theksohet ideja.
- Guri luan një rol të rëndësishëm në tregim sepse ideja kryesore është që ka mundur po ashtu ta groposë edhe gurin duke pasur parasysh se çfarë dobie ka pasur nga ari.
- Sikur të zëvendësohej me diçka më të mirë sesa guri, do të dërgohet mesazhi i gabuar sepse duhet të groposet diçka që është me të vërtetë e padobishme.
- Guri është i padobishëm, mirëpo për koprracin, ari po ashtu ishte i padobishëm!
- Diçka më e mirë do të thotë diçka nga e cila mund të ketë dobi. Ari nuk i shërbente, këtë ka dashur ta thotë njeriu.

Asnjë pikë

Kodi 0: Jep përgjigje të pamjaftueshme ose të paqartë:

- Guri luan një rol të rëndësishëm në tregim [e përsërit atë që është përmendur në pyetje].
- Duhet të jetë gur [mungon sqarimi].
- Nuk do të ishte e njëjtë [shumë e paqartë].

Përgjigje që dëshmon se materiali nuk është kuptuar si duhet ose përgjigje jo bindëse ose e pavend:

- Duhet të jetë gur sepse guri është i rëndë.

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 4/5

Pikë të plota

Kodi 1: Sqaron që koprraci ka dashur ta ruajë arin në vend të sigurt OSE që po frikësohet:

- Që ta fshehë.
- Mendonte se në qoftë se e fsheh, askush nuk do të mund ta merr.
- Ai dëshironte të jetë në vend të sigurt.
- Ai siç duket ishte pak i çmendur, e konsideronte që do të ishte më i sigurt i groposur sesa në bankë! [Injoroheni supozimin e pasaktë që bankat kanë ekzistuar në kohën kur është shkruar kjo anekdotë]

Asnjë pikë

Kodi 0: Jep përgjigje të pamjaftueshme ose të paqartë.:

- Ai ishte i çmendur.

Përgjigjja dëshmon se teksti nuk është kuptuar si duhet ose jepet një përgjigje jo bindëse ose e pavend:

- Ai donte ta vjedhë.

Kodi 9: Asnjë pikë

Pyetja 5/5

Pikë të plota

Kodi 1: Ai përmend se ka shitur gjithçka që ka pasur. Mund të ritregojë OSE direkt të citojë tekstin:

- Shiti gjithçka që kishte.
- Ai i shiti të gjitha gjësendet e tija.

Asnjë pikë

Kodi 0: Jep përgjigje të pamjaftueshme ose të paqartë..

- Ajo ishte e tija.
- Ai e fitoi këtë.

Përgjigjja dëshmon se teksti nuk është kuptuar si duhet ose jepet një përgjigje jo bindëse ose e pavend:

- Ai e vodhi.

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 1/ 4

Pikë të plota

Kodi 1: Përgjigjet 8000 (hapa) pra. 2440 (metër).

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje të tjera:

- 8000 metër, 2440 hapa
- 6000 metër, 1830 hapa

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 2/ 4

Pikë të plota

Kodi 1: C. Në shpellën Ruvanka.

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje të tjera

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 3/ 4

Pikë të plota

Kodi1: I referohet ditës 1, ditës 2, ditës 3, ditës 4 OSE ditës 5 d.m.th. e përmend sqarimin që është bindës dhe në përputhje me tekstin. Duhet të referohet (direkt OSE indirekt) në tekst:

- ditë. Tërë kohën po shkohet përpjetë.
- ditë. Për mua, të ecurit përpjetë, e pastaj tatëpjetë, e përsëri përpjetë, e tatëpjetë, është më keq se sa të ec tërë kohën nëpër përpjetë OSE tatëpjetë.
- ditë. Ka një maje të tmerrshme.
- ditë. Ajo maje duket mesatarisht përpjetë.
- ditë. Tërë kohë po lëshoheni tatëpjetë.

Asnjë pikë

Kodi 0: Cakton përgjigje që nuk ka të bëjë me tekstin:

- ditë, akoma nuk do të ishin mësuar [nuk ka të bëjë me tekstin].
- Dita 5. Deri atëherë do të ishim tërësisht të rraskapitur! [nuk ka të bëjë me tekstin]
- ditë, kjo është në mes, prandaj do të ishte vështirë [nuk ka të bëjë me tekstin].

Jep përgjigje pa arsytim:

- Dita 2 [pa arsytim].

Jep përgjigje të pamjaftueshme ose të paqartë.

- ditë sepse do të ishte vështirë [paqartë].

Demonstron se materiali është kuptuar gabimisht OSE jep përgjigje joadekuate ose të pa rëndësishme.

Kodi 9: Nuk ka përgjigje

Pyetja 4/ 4

Pikë të plota

Kodi 1: D. dita 4

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje të tjera

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 1/ 4

Pikë të plota

Kodi 1: Direkt i referohet Stacionit qendror. Mund të përmendet linja:

- Në stacionin qendror
- Qendrore
- Qendrore (Porta lindore)
- Qendrore (linja 1)

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje të tjera:

- Në stacion
- Kalaja
- Linja 1

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 2/ 4

Pikë të plota

Kodi 1: D. Limani i vjetër

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje të tjera

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 3/ 4

Pikë të plota

Kodi 1: Përmend që këto dy stacione janë në fund të linjës:

- Përfundimi i linjës
- Stacioni i fundit

Asnjë pikë

Kodi 0: Jep përgjigje të pamjaftueshme ose të paqartë..


Përgjigje që dëshmon se materiali nuk është kuptuar si duhet ose përgjigje jo bindëse ose e pavend:

- Atje mund të hipni në autobus [e mundur, mirëpo rrathët gri nuk e tregojnë këtë].
- Këto janë stacionet më frekuentuese.
- Këto janë stacionet më të mëdha.

Kodi 9: Pa përgjigje


Pikë të plota

Kodi 2: E vizaton shtegun e paraqitur në fotografinë më poshtë:



Pikë të pjesshme

Kodi 1: E vizaton shtegun e paraqitur në fotografinë më poshtë:



Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje të tjera

Kodi 9: Pa përgjigje

PUNA NË DISTANCË

Pyetja 1/ 3

Pikë të plota

Kodi 1: D. Ata prezantojnë qëndrime të kundërta për të njëjtën temë.

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje të tjera

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 2/ 3

Pikë të plota

Kodi1: Në të jepet lloji i punës dhe jepet sqarim i argumentuar pse një person nuk do të mund të kryejë një lloj pune duke punuar nga distanca. Përgjigjja DUHET të përmend saktë pse duhet qenë fizikisht prezent në një vend të caktuar pune:

- Ndërtimtarët. Është vështirë të punosh me dru dhe tulla nga kudo qoftë.
- Sportist. Ai duhet me të vërtetë të jetë atje që të bëj sport.
- Hidraulik. Nuk mund të riparoni lavamanin e dikujt nga shtëpia!
- Gërmim gropash sepse duhet të jeni në atë vend.
- Infermiere – vështirë është të kontrollohen se a janë mirë pacientët përmes Internetit.

Asnjë pikë

Kodi 0: Tregon për llojin e punës pa sqarim ose jep sqarim që nuk është i lidhur me punën në distancë:

- Gërmim gropash
- Zjarrfikës
- Student
- Gërmim gropash sepse kjo është punë e mundimshme [sqarimi nuk thotë përse do të ishte vështirë të punohet nga distanca].

Jep përgjigje të pamjaftueshme ose të paqartë.:

- Duhet të jeni atje.

Përgjigjja dëshmon se teksti nuk është kuptuar si duhet ose jepet një përgjigje jo bindëse ose e pavend.:

- Menaxher. Ndonëse këtë askush nuk e vëren [sqarim i parëndësishëm].

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 3/3

Pikë të plota

Kodi 1: C. Puna nga distanca nuk do të ishte adekuate për secilin.

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje të tjera

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 1/5

Pikë të plota

Kodi 1: A. Ai nuk ia doli që t'u sjellë fitoren Athinasve tek Amfipolisi.

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje të tjera

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 2/5

Pikë të plota

Kodi2: Jep përgjigje që është bindëse dhe në përputhje me tekstin. Përgjigjet mund të përmendin një ose më shumë motive për atë fjalim, duke përfshirë: bindjen e ushtarëve për të vazhduar luftën, ngushëllimi familjeve të të rënëve, zgjimi i krenarisë tek qytetarët e Athinës OSE theksimi i virtyeteve të Athinës në krahasim me Spartën OSE qytetet e tjera:

- Bëjini njerëzit krenar me Athinën
- Promovimi i demokracisë
- Sqaroni përfitimet nga demokracia e Athinës
- Bindini njerëzit që Athina ende është e mirë edhe përkaj faktit që në këtë çast është në telash
- Inkurajoni optimizmin dhe qëndrimet positive
- Zgjojeni interesin e njerëzve
- Promovoni patriotizmin
- Fitore në zgjedhjet e radhës
- Bëhuni i popullarizuar
- Të zgjohet tek populli armiqësia ndaj Spartanëve

Përmend që qëllimi i Tukididit është të kuptojë motivet OSE mënyrën e të menduarit të Periklit:

- Sqaroni motivet / psikologjinë e Periklit
- Sqaroni pse e ka bërë atë që kishte bërë

Pikë të pjesshme

Kodi 1: Përgjigjja përmend vetëm sqarimin mbi atë se si funksionon demokracia:

- Drejtohuni në temën e demokracisë
- Sqarojuni njerëzve se çfarë është demokracia.

Asnjë pikë

Kodi 0: Jep përgjigje të pamjaftueshme ose të paqartë.:

- Bëjini homazh ushtarëve të rënë [e përsërit atë që tanimë ka thënë]
- Përgjigje që dëshmon se materiali nuk është kuptuar si duhet ose përgjigje jo bindëse ose e pavend:
- Temë e fjalimit ishte Athina [nuk ka caktuar qëllim]

- Detyroni njerëzit të buzëqeshin [e pasaktë]

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 3/5

Pikë të plota

Kodi2: Përmendja (direkt ose indirekt) e Tukididit si autor të fjalimit tregon që Tukididit ia përshkruan atë fjalim të Periklit. Mund të ritregohet OSE direkt të citohet teksti:

- Tukididi. Në të shkruan “Tukididi ia përshkruan Periklit”.
- Tukididi. “Nganjëherë inkuadron fjalime të trilluara – ata e ndihmojnë të sqarojë motivet e personaliteteve historike”.
- Përmendet që Tukididi trillon fjalime për njerëzit për të cilët po shkruan.

Pikë të pjesshme

Kodi 1: Ai e përmend Tukididin si autor të fjalimit pa arsyetim:

- Tukididi.
- Historian dhe ushtar [indirekt i referohet Tukididit]

Asnjë pikë

Kodi 0: Jep përgjigje të pamjaftueshme ose të paqartë.:

- Dikush tjetër [tepër i paqartë]

Përgjigje që dëshmon se materiali nuk është kuptuar si duhet ose përgjigje jo bindëse ose e pavend:

- Perikli
- Shkruante në temën Lufta e Peloponezit.

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 4/5

Pikë të plota

Kodi 1: D. Ai ishte i fokusuar në shkaqet që i çuan njerëzit të silleshin në atë mënyrë siç kishin vepruar.

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje të tjera

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 5/5

Pikë të plota

Kodi 1: B. Pushimi dhe bukuria janë pjesë përbërëse e jetës luksoze që mund të bëhet në Athinë.

Asnjë pikë

Kodi 0: Përgjigje të tjera

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 1/5

Pikë të plota

Kodi2: Në të përmendet se fluturimet zhvillohen gjatë natës ose në mbrëmje (por jo në mesnatë OSE pas mesnate) d.m.th. jep sqarim duke cituar saktë të dhëna nga teksti. Mund të ritregojë OSE direkt të citojë tekstin:

- Natën, shkruan që ata janë “të humbur gjatë natës”.
- Në mbrëmje. Pret të vijë që të mund avioni i evropës të shkojë në mesnatë.
- Ishte natën sepse “nata tanimë e dorëzonte një nga to”.
- Para mesnatës, sepse atëherë shkon avioni i evropës.
- Ndërmjet orës 20 dhe mesnatës. E dimë që është errët, por nuk është mesnatë. Pastaj shkon një avion tjetër

Pikë të pjesshme

Kodi1: Ai përmend që fluturimet zhvillohen gjatë natës OSE në mbrëmje (por jo në mesnatë OSE pas mesnate), mirëpo nuk i përmend provat nga teksti që ta konfirmojë përgjigjen e tij:

Asnjë pikë

Kodi 0: Në të përmendet se fluturimet zhvillohen në mesnatë OSE pas mesnate:

- “Mund të fluturojë rreth mesnatës” [citat i parëndësishëm nga teksti]
- “rreth mesnatës” [citat i parëndësishëm nga teksti]
- Pas mesnate

Jep përgjigje të pamjaftueshme ose të paqartë..

Përgjigje që dëshmon se materiali nuk është kuptuar si duhet ose përgjigje jo bindëse ose e pavend.:

- Mëngjes
- Mesditë
- Gjatë ditës
- Në ora 21 [OSE në cilën do kohë tjetër të caktuar]

Kodi 9: Pa përgjigje

Pyetja 2/5

Pikë të plota

Kodi2: Përshkruan se si ndjehet Rivera në punë, duke iu referuar stresit, vendosmërisë, vëllimit të punës OSE ndjenjës së obligimit që t’i kryejë detyrat e tij, d.m.th. jep sqarim në lidhje me pjesën e rëndësishme të tekstit. Mund t’i referohet tekstit në përgjithësi OSE mund direkt ta ritregojë OSE citojë tekstin. Citati duhet të jetë në përputhje me emocionin e përmendur:

- Ai është krejtësisht i fiksuar, kjo shihet nga rreshti i fundit, sepse ai kurrë nuk pushon.
- Ai është nën stres. Dita e tij ishte “e mbushur me ndjenjë të tmerrshme”.

- Ai është i ngarkuar, tërë ditën është i brengosur për ato tre avionë, e pastaj ende duhet të kujdeset edhe për avionin nga Evropa!
